Në këtë konventë referenca për aksesueshmërinë bëhet në pjesën e parë të nenit 9 ku përcaktohet se "Për të lejuar personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës, Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, të kenë akses në mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimin, duke përfshirë sistemet dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, si dhe pajisjet dhe shërbimet e tjera të hapura ose të ofruara për publikun, si në qytet ashtu edhe në atë rural. zonave. Këto masa, të cilat përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për aksesueshmërinë, do të zbatohen, ndër të tjera, për:

(a) Ndërtesat, rrugët, transporti dhe pajisje të tjera brenda dhe jashtë ndërtesave, duke përfshirë

shkollat, banesat, objektet shëndetësore dhe vendet e punës;

(b) Për informacionin, komunikimin dhe shërbimet e tjera, duke përfshirë shërbimet elektronike dhe të urgjencës"²⁰.

Mund të thuhet se në nivel evropian deri në vitin 2006 janë ndërmarrë hapa gjigantë për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për ta bërë gjithçka më të aksesueshme për këta persona; por duhet të theksojmë se ende nuk kishte një disiplinë ad hoc që do të mbronte, nga pikëpamja turistike, jo vetëm personat me aftësi të kufizuara, por të gjithë ata me nevojë të veçanta.

Së fundi, iniciativa më e fundit e propozuar në nivel evropian, me një kohëzgjatje trevjeçare, e quajtur "projekti Calypso" dhe e ndërmarrë nga Komisioni Evropian për Promovimin e Turizmit Social me synimin për të sjellë kategori më pak të privileguara si të moshuarit, të rinjtë. më afër turizmit nga 18 deri në 30 vjeç, personat me

¹⁶ Po aty

¹⁷ European Network for Accessible Tourism – Rrjeti Evropian për Turizmin e Aksesueshëm

¹⁸ ee.accessibletourism.org 2014

¹⁹ Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara , 2006

²⁰ Po aty

aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta. Qëllimi është nxitja e turizmit në sezonin e ulët për të rritur mundësitë e udhëtimit të këtyre personave dhe për të ndihmuar rifillimin e aktiviteteve turistike edhe në periudha me fluks të ulët.

Falë entuziazmit dhe mbështetjes së operatorëve turistikë, autoriteteve rajonale dhe kombëtare, projekti pati një ndikim të fortë në të gjithë Evropën duke zgjatur sezonin turistik gjatë gjithë vitit (eu.europe.eu, 2013).

Nismat për turizmin e aksesueshëm në Shqipëri

- Qasja e parë ndaj turizmit social (apo të aksesueshëm) në Shqipëri ka ardhur në një organizim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së bashku me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, në kuadër të 27 shtatorit, Ditës Botërore të Turizmit, duke zhvilluar një aktivitet në 28.09.2016, për të promovuar konceptin "Turizëm për të gjithë".

Gjatë këtij aktiviteti vëmendja u fokusua në nismën për zhvillimin e turizmit të aksesueshëm për të gjithë, që do të thotë të krijohen kushtet e përshtatshme për t'iu përgjigjur nevojave të gjithëve. "Një aftësi e kufizuar, qoftë edhe e përkohshme, udhëtimi me fëmijë në moshë të vogël apo plakja e popullsisë janë disa arsye që bëjnë që në një moment të jetës sonë, të gjithë ne të përfitojmë nga aksesimi për të gjithë në sektorin e turizmit. Prandaj, ne duhet të mbrojmë të drejtën e të gjithë qytetarëve për të përfitur nga larmia e pabesueshme e natyrës, kulturës, historisë së vendit tone" (M. Ikonimi 2016)²¹.

- Në datën 23.05.2018 u realizua takimi për prezantimin e projektit "P.A.S.T 4Future - Promovimi i Turizmit të Aksesueshëm dhe të Qëndrueshëm" për të ardhmen, i cili do të zbatohet nga 6 partnerë me përfaqësi nga Italia, Shqipëria, Mali i Zi, nën kryesimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Objekti i këtij projekti ishte promovimi dhe fuqizimi i ofertave turistike të aksesueshme dhe të qëndrueshme në zonat ndërkufitare në nivelin evropian dhe ndërkombëtar, përmes zbatimit dhe diversifikimit të produkteve dhe shërbimeve.

Një mesazh shumë i rëndësishëm dhe për t'u theksuar, të cilin e përçon ky projekt, është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat e njeriut, me atë promovim dhe me atë mbështetje që i bën komuniteteve të ndryshme. Referuar Traktatit të Lisbonës, veçanërisht Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Ministri i Financave citoi artikujt 21 për Mosdiskriminim dhe artikulli 22 për larminë kulturore, fetare dhe gjuhësore, në të cilat shprehet se, ndër të tjera, ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë tiparet gjenetike, aftësia e kufizuar, moshë, etj.

Në këtë kuadër, projekti "P.A.S.T4Future" ka në fokus zhvillimin e sektorit të turizmit, duke shtrirë ofertën turistike në Shqipëri për një segment tregu ende të paplotësuar, si personat me nevoja të veçanta, personat me aftësi të kufizuar, persona të moshës së tretë, por edhe turistë familjarë që kanë nevoja të veçanta. Gjithashtu, ky projekt do të krijojë një platformë dixhitale ku do të mundësojë ndërlidhjen e aktorëve të ndryshëm për ofrimin e informacionit në kohë reale lidhur me kërkesat specifike të turistëve me nevoja të veçanta²².

Referuar vitit 2017, janë 157,911 persona me aftësi të kufizuara të cilët kanë përfitur nga shërbimet e ofruara në qendrat e zhvillimit të buxhetuara nga Shërbimi Social Shtetëror. Nëpërmjet këtij projekti, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon të sensibilizojë të gjithë ato sipërmarrje në sektorin e shërbimeve për të mundësuar staf të kualifikuar për kujdesje për turistë me nevoja të veçanta.

- Gjithashtu është lajmëruar nisma për projektin "Pukë-turizmi me njerëzit me aftësi të kufizuar", por nuk ka të dhëna të asnjë forme për zbatimin e tij (<https://smilealbania.gov.al/puke->

²¹ Mesazhi i Ekonomit: Akses për të gjithë në turizëm (panorama.com.al)

²² Ministria e Financave dhe Ekonomisë

turizmi-me-njerezit-me-aftesi-te-kufizuar/).

Nga programet e paraqitura, këto projekte dukeshin shumë premtues për kohën dhe shumë pararojë për realitetin shqiptar. Për fat të keq, 5 vjet nga prezantimi i projektit të parë dhe 3 vjet nga ai i dyti, nuk ka më asnjë informacion për ecurinë e tyre. As të dhëna konkrete nga mnistritë përkatëse, në web nuk gjendet ndonjë link që dëshmon për krijimin e platformës së premtuar, kështu që automatikisht, mund të mendohet që jemi përsëri në pikën 0. Duke shpresuar që në të ardhmen të ketë më shumë të dhëna.

Bibliografia

1. Buhalis, D., & Darcy, S. (Eds.). (2011). "Accessible Tourism: Concepts and Issues." Channel View Publications.
2. Darcy, S., & Dickson, T. (2009). "A Whole-of-Life Approach to Tourism: The Case for Accessible Tourism Experiences." *Journal of Hospitality and Tourism Management*, 16(1), 32-44.
3. European Commission. (2010). "Study on the Competitiveness of the EU Tourism Industry - with Specific Focus on the Accommodation and Tour Operator & Travel Agent Sectors." Retrieved from European Commission website.
4. European Network for Accessible Tourism (ENAT). (2020). "ENAT - The European Network for Accessible Tourism." Retrieved from ENAT website.
5. European Travel Commission (ETC). (2017). "European Tourism - Trends & Prospects." Retrieved from ETC website.
6. Darcy, S., Dickson, T., & Ruhanen, L. (2010). "Disability Regulation and the Tourism Industry." *Annals of Tourism Research*, 37(3), 856-879.
7. Mármol, I., & Letelier, A. (2019). "Accessibility in Rural Tourism: A Comparative Study between European Destinations." *Sustainability*, 11(5), 1347.
8. European Commission. (2020). "Tourism and Transport: Council Adopts Conclusions on Smart and Sustainable Tourism." Retrieved from European Commission website.

Turizmi i gjelbër"si alternativë e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në Shqipëri

Dr. Daniela Qiqi

daniela_qiqi@yahoo.com

MSc. Irma Gjollëshi

gjollëshiirma@gmail.com

Universiteti "Eqrem Çabej"

Abstrakt

Sektori i turizmit në Shqipëri zë një vend të veçantë në ekonominë e vendit, sepse gradualisht po kthehet në një burim të rëndësishëm për të ardhurat kombëtare, punësimin, investimet etj. Statistikat e viteve të fundit flasin për një rritje të vazhdueshme të këtij sektori, por tashmë është domosdoshmëri zhvillimi i tij në mënyrë të qëndrueshme dhe kjo mundësohet në përmjet ruajtjes së ekuilibrit midis zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe përfshirjes sociale.

Një alternativë për gjetjen e këtij ekuilibri është "Turizmi i gjelbër", i cili mundëson zhvillimin ekonomik të sektorit duke zvogëluar ndikimin negativ në mjedis, përdorimin e burimeve me efikasitet dhe reduktimin e mbetjeve. Kjo qasje kontribuon edhe në realizimin e objektivave të BE-së për ekonominë qarkulluese dhe neutralizimin e klimës deri në vitin 2050. Prej vitesh Komisioni Europian, ka hartuar etiketa teknologjike (EU Ecolabel) me kriteret përkatëse për mallra dhe shërbime të qëndrueshme që inkurajojnë eko-inovacionin duke bërë pjesë të kësaj iniciative edhe turizmin. Ecolabel i BE-së për strukturat e akomodimit turistik, është një mjet i cili u jep mundësinë këtyre strukturave të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme së bashku me stafin dhe klientët e tyre duke zvogëluar ndikimin në mjedis, sepse edhe vetë turistët po kërkojnë gjithnjë e më shumë akomodime që kujdesen për mjedisin.

Pra, është moment që strukturat e akomodimit turistik dhe të gjithë faktorët e tjerë të turizmit në vendin tonë të orientohen drejt zgjidhjeve dhe zgjedhjeve të gjelbëra, sepse vetëm në këtë

mënyrë mund të arrihet ofrimi i shërbimit cilësor, menaxhimi me kujdes i burimeve dhe mbrojtja e mjedisit, si faktorë të pazëvendësueshëm në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.

Fjalët kyçe: Turizëm i gjelbër, zhvillim i qëndrueshëm, etiketë ekologjike, kriterë

Abstract

The tourism sector in Albania occupies a special place in the country's economy, because it is gradually turning into an important source for national income, employment, investments, etc. The statistics of the recent years indicate a continuous growth of this sector. However, it is currently essential to foster a sustainable development and this is feasible through maintaining the proper balance between economic development, environmental protection and social inclusion.

"Green Tourism" is one of the alternatives to reach this balance, as it enables the economic development of this sector, through reducing the negative impact on the environment, the efficient use of resources and the reduction of waste. This approach also contributes to achieve the EU's objectives for a circular economy and climate steadiness until 2050-ies. For years, the European Commission has drawn up technological labels (EU Ecolabel) with the relevant criteria for sustainable goods and services that promote eco-innovation by involving tourism within this initiative.

The EU Ecolabel for tourist accommodation structures is a tool that enables the relevant factors involved to develop in a sustainable way along with their staff and customers, accordingly reducing the impact on the

environment, as tourists themselves are increasingly looking for many eco-friendly accommodations.

Consequently, it is time for the tourist accommodation arrangement and all other factors of tourism in our country to be directed towards green solutions and selections, because only in this way we can achieve a quality service, careful management of resources and environmental protection; factors which are crucial to the sustainable development of this sector.

Key words: *green tourism, sustainable development, ecological label, criteria*

1. Hyrje

Tashmë, sektori i turizmit në Shqipëri është një vend të veçantë në ekonominë e vendit dhe është një burim i rëndësishëm të ardhurash kombëtare. Sipas statistikave të raportuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duke ju referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, të ardhurat nga udhëtimet/turizmi gjatë 6-mujorit të parë 2023 (Janar-Qershor), kanë një rritje prej 39,5% krahasuar me vitin 2022 dhe 84,8% krahasuar me vitin 2019. Gjithashtu, edhe në raportin e Këshillit Botëror të Turizmit dhe Udhëtimit, thuhet se falë trendit rritës që po pëson sektori i turizmit në Shqipëri, pritet që deri në vitin 2028, vendin ta vizitojnë rreth 6.6 milionë turistë dhe kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit në Prodhimin e Brendshëm Bruto të shkojë deri në 9.3% të PBB-së.

Por, zhvillimi i turizmit në vendin tonë duhet të synojë vendosjen e një ekuilibri midis zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe përfshirjes sociale, sepse vetëm në këtë mënyrë turizmi mund të kontribuojë në rritjen e ekonomisë locale pa shkakuar dëme të pakthyeshme mjedisore.

Studjuesit e fushës rekomandojnë se turizmi duhet të orientohet drejt turizmit "të gjelbër" duke renditur disa avantazhe të cilat lidhen me: mbrojtjen e mjedisit; përdorimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme; përfshirjen e komuniteteve lokale dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore; nxitjen e respektit ndaj kulturës dhe trashëgimisë së destinacionit etj.

Këto avantazhe do të ishin të paqarta ose të vështira për t'u kuptuar dhe zbatuar në qoftë se

nuk do të ofroheshin nga Komisioni Europian etiketa teknologjike (ECO LABEL), të cilat ofrojnë një udhëzues të saktë dhe praktik për kriteret që duhet të përmbushë një product ose shërbim për të qenë miqësor ndaj mjedisit. Skema e etiketimit teknologjik ka të gjithë potencialin që të përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të promovojë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pa cënuar experience turistike.

2. Tendencat aktuale të zhvillimit të turizmit

Kontributi i sektorit të turizmit në zhvillimin ekonomik të vendit tonë është bërë shpesh object diskutimi ndërmjet përfaqësuesve të sektorit, politikbërësve, akademikëve etj., por të gjithë bien në consensus që zhvillimi ekonomik i këtij sektoriduhet të jetë i qëndrueshëm. Çfarë është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit?

Sipas National Geographic, turizmi i qëndrueshëm është: "një kornizë për përfshirjen e udhëtarëve dhe industries së udhëtimit në përgjithësi, në mbështetjen e synimeve të cilat përfshijnë: mbrojtjen e mjedisit; adresimin e ndryshimeve klimatike; minimizimin e konsumit të plastikës; dhe zgjerimin e zhvillimit ekonomik në komunitetet e prekura nga turizmi."

Ndërsa Këshilli Global i Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC) e përcakton turizmin e qëndrueshëm në këtë mënyrë: "një aspiratë për të njohur të gjitha ndikimet e turizmit, si positive ashtu edhe negative...për të minimizuar ndikimet negative dhe për të maksimizuar ato pozitive."

Lidhja e ndërsjellë e turizmit me mjedisin trajtohet mjaftueshëm në literaturë duke analizuar here pas here avantazhet dhe disavantazhet që zhvillimi i turizmit sjell në mjedis. Ndërsa në ditët e sotme theksohet nevoja për të gjetur një ekuilibër midis zhvillimit të turizmit dhe ruajtjes së mjedisit, pasi edhe mjedisi, si rezultat ngrohjes globale, mund të shkaktojë ndryshime në destinacionet turistike duke ulur aftësinë e tyre tërheqëse ndaj turistëve, si p.sh rritja e temperaturave mund të sjellë sfida për turizmin dimëror ose rritja e nivelit të detit mund të kërcënojë destinacionet bregdetare, shkrirja e akullnajavemund të ndikojnë biodiversitetin dhe ekosistemet e habitateve natyrore mund të çojë në humbje të faunës dhe florës së

destinacionitetj. Gjithashtu, ndryshimet e klimës mund të çojnë në fenomene ekstreme si stuhi, tërmete dhe ndotje ajri, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë dhe vizitueshmërinë e një destinacioni turistik.

Sipas raportit të Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm

81% e udhëtarëve globalë konfirmojnë se udhëtimi i qëndrueshëm është i rëndësishëm për ta; 50% thonë se informacionet rreth ndryshimeve klimatike kanë ndikuar që ata të bëjnë zgjedhje më të qëndrueshme udhëtimi; 60% e njerëzve deklarojnë se janë të impresionuar nga natyra, duke i shtyrë ata të vazhdojnë të udhëtojnë në mënyrë të qëndrueshme. (Travel Agent Central);

Pra, bukuria e pyjeve, shkëmbinjve koralorë dhe pamjeve të ndryshme natyrore janë faktorët kryesorë pse 60% zgjedhin të vazhdojnë me udhëtime të qëndrueshme.

Për më tepër, 47% deklarojnë se ata udhëtojnë jo vetëm për shkak të bukurisë së natyrës, por edhe sepse mund të ndikojnë pozitivisht nga pikëpamja ekonomike te vendasit e destinacionit të vizituar.

Megjithatë 42% deklarojnë si arsye kryesore pamundësinë për të përballuar koston e shtuar për turizmin e qëndrueshmërisë; Por 40% nuk mund të përballojnë shpenzimet shtesë, ndërsa 20% nuk marrin akomodimin e perceptuar luksoz me të cilin janë mësuar; 40% e njerëzve do të zgjidhnin vendpushimet miqësore me mjedisin për të ndihmuar në uljen e ndikimit negativ;

Për më tepër, 34% do të zgjidhnin një akomodim të gjelbër për të eksploruar dhe një përvojë lokale të vendit, ndërsa zgjedhja për 33% të tjerë do të ishte të ndiheshin mirë për të marrë një vendim më të mirë për jetën; 57% e udhëtarëve do të ndiheshin më mirë duke qëndruar në një akomodim të caktuar nëse do ta dinin se kishte një certifikim të qëndrueshëm.

Industria e turizmit në rang botëror, përveç ngrohjes globale, po sfidohet edhe nga faktorë të tjerë siç janë: pasojat e pandemisë Covid-19, luftrat në Ukrainë e Lindjen e Mesme, rritja e çmimeve në tregjet e burimeve, mungesa e stafit të kualifikuar, ndryshimet në sjelljen e turistëve, dixhitalizimi që prek të gjithë elementët e zinxhirit të shërbimeve turistike etj. Në këto kushte, të gjithë faktorët dhe grupet e interesit të turizmit duhet të angazhohen për të adresuar sfidat e sektorit dhe garantuar qëndrueshmërinë e tij. Një alternativë e zhvillimit të qëndrueshëm është edhe "turizmi i

gjelbër" i cili rekomandohet për të zvogëluar ndikimin e sektorit në mjedis dhe përmirësuar experiencën turistike, meqenëse turistët po bëhen më të vetëdijshëm për aspektet e qëndrueshmërisë.

3. Turizëm i gjelbër, dhe etiketa ekologjike

Pse Turizmi duhet të bëhet "i gjelbër"?

Ka mjaft argumenta për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje. Fillimisht, mjafton të mbahet parasysh se ofrimi i produktit turistik orientohet nga klientët dhe më sipër u përmend rritja e ndërgjegjësimit të turistëve (veçanërisht atyre ndërkombëtarë) për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike. Gjithashtu në statistikën e përmendura u përmend rritja e interesit për përvojat autentike të pushimeve, rritja e ndjeshmërisë për mbështetjen ekonomike të komuniteteve në destinacionet turistike etj. Po ashtu, rritja e kostove për burimet si energjia, uji, materialet dhe shërbimet e tjera. Ndërkohë që gjithnjë e më shumë po ndërmerren rregullime ligjore në lidhje me aspektet mjedisore dhe nisma të shumta mbështetëse kombëtare apo ndërkombëtare për reduktimin e ndikimit mjedisor dhe për etiketat ekologjike në turizëm.

Pra "gjelbërimi" i turizmit shtë një shanc shumë i mirë për përmirësimin e ofertës së shërbimit, uljen e kostos dhe avantazh konkurrues.

Çfarë është Etiketimi Ekologjik?

BE po përpiqet të orientojë ekonominë e Europës në një rrugë qëndrueshmërie nëpërmjet promovimit të përdorimit eficient të burimeve. Ecolabel i BE-së promovon produkte (të qëndrueshme) të cilët kanë një ndikim të ulët mjedisor gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor - nga nxjerrja e lëndëve të para, tek prodhimi dhe paketimi, përdorimi dhe së fundi, asgjësimi ose riciklimi. E zhvilluar nga Komisioni Evropian në vitin 1992, Ecolabel i BE-së është një udhëzues kyç vullnetar Brenda Konsumit dhe Prodhimit të Qëndrueshëm dhe Politikës Industriale të Qëndrueshme (SCP/SIP) të Komisionit Evropian. Objektivi i tij kryesor është të edukojë dhe udhëzojë konsumatorët që të zgjedhin produkte të ndërgjegjshme për mjedisin.

Grupet kryesore të interesit në etiketimin ekologjik janë prodhuesit/bizneset, agjencitë

qeveritare dhe konsumatorët. Aktorë të tjerë të rëndësishëm janë komuniteti shkencor, organizatat e standardeve dhe shoqatat e ndryshme, por pothuajse të gjitha programet ndërkombëtare të etiketimit e kokërkojnë financim dhe mbështetje qeveritare.

Turizmi ka një ndikim të rëndësishëm mjedisor, ekonomik dhe social-kulturor, gjë që e bën këtë

sector mjaft të rëndësishëm për iniciativat mjedisore. Kriteret e akomodimit turistik ECO LABEL kanë fleksibilitet të mjaftueshëm për të siguruar kënaqësinë e duhur të mysafirëve dhe përmbajnë udhëzime efektive për hotelet dhe vendet e kampingjeve që kërkojnë të zvogëlojnë ndikimin e tyre në mjedis. Në mënyrë të përmblodhur ato paraqiten në tabelën e mëposhtme:

✓ Menaxhim i optimizuar mjedisor.	Angazhimi i stafit dhe klientëve nëpërmjet trajnimit dhe ofrimit të informacionit mbi praktikat mjedisore. Monitorimi i të dhënave të konsumit të energjisë, ujit, ushqimit dhe produktit për mysafir/natësi dhe numri i produkteve të pastrimit të përdorura.
✓ Reduktim i konsumit të energjisë dhe emetimit të CO2 përmes kursimit të energjisë, përdorimit të pajisjeve eficiente dhe burimeve të rinovueshme të energjisë.	Përdorimi i pajisjeve për ngrohjen e ujit, ajrit të kondicionuar, ndriçim etj. me parametra ekologjike dhe mirëmbajtja e tyre. Nuk ka ngrohje dhe ajër të kondicionuar në ambientet e jashtme. Deri në 100% të energjisë elektrike sigurohet nga burimet e rinovueshme të energjisë.
✓ Konsum i reduktuar I ujit	Rrjedhja e ujit të përdorur të jetë në standartet e caktuara, Politika optimale të ndërrimit të biankerisë. Menaxhim optimal i pishinave, riciklimi i ujit dhe sisteme efikase të ujitjes.
✓ Përdorim i reduktuar I kimikateve dhe I pesticideve	Transferimi i shërbimeve të larjes/pastrimit dhe blerja e produkteve detergjente/kozmetikë nga ofrues të pajisur me një etiketë ekologjike. Prodhime bujqësore organike në përgatitjen e ushqimit, ndalimi i përdorimit të pesticideve në zonat e jashtme.
✓ Reduktim dhe menaxhim i optimizuar i mbetjeve	Optimizimi i paketimit ushqimit dhe artikujve të tualetit dhe marrëveshje me një riciklues. Kontenierë për ndarjen e mbeturinave në dhoma ose në të gjitha katet. Ndarja e mbetjeve.
✓ Reduktim i emetimeve nga transporti	Përdorimi i mjeteve miqësore ndaj mjedisit për të transportuar klientët. Marrëveshje me agjencitë e transportit që ofrojnë transport miqësor ndaj mjedisit si biçikleta apo automjete elektrike.
✓ Kufizim i mbetjeve ushqimore	Produkte ushqimore me burim lokal dhe jo jashtësezonit. Zbatimi i një "plani të dokumentuar për reduktimin e mbetjeve ushqimore".

Turistët kryesisht duan të qëndrojnë në zona natyrore të shëndetshme pandotj edhe strukturat e akomodimit të përmbushin të gjitha standartet mjedisore në lidhje me vendndodhjen, tiparet e ndërtimit, peizazhin dhe funksionimin e përgjithshëm të sipërmarrjes, por shpesh ata zhgënjehen sepse në fakt, pjesa më e madhe e dëmit në mjedis është shkaktuar nga aktivitetet turistike.

Prandaj, për të ndjekur një strategji më të qëndrueshme për turizmin në vendin tonë, i gjithë sektori i turizmit duhet të orientohet dhe

përfshihet në programet e etiketimit ekologjik, sepse përdorimi i burimeve materiale të ripërtëritshme, të ricikluara dhe të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, zvogëlimi i emetimit të gazrave dhe përmirësimi i performances mjedisore të materialeve të përdorura janë përparësitë kryesore për të ardhmen e tij.

Literatura:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, "Statistika ekonomike për turizmin", shtator 2023.

2. *Economic Impact Research*; Available from <https://wtcc.org/Portals/0/Documents/Reports/2023/WTTC-Cities-Economic-Impact-Final.pdf>
3. Lee H, Romero J. *Climate Change 2023: Synthesis Report. Contribution of Working Groups I, II and III to the Sixth Assessment Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change, IPCC, 2023, Geneva, Switzerland, 35-115 p*, available from doi: 10.59327/IPCC/AR6-9789291691647
4. *UNWTO Report. December 2022*, available from <https://www.linkedin.com/pulse/sustainable-tourism-post-covid-19-trends-travelers-insights>
5. *GSTC Report. April 19-th*; available from <https://www.gstcouncil.org/booking-com-2022-sustainable-travel-report/>
6. *EU-ECO Label*. Available from https://environment.ec.europa.eu/topics/circular-economy/eu-ecolabel-home/product-groups-and-criteria_en

Përcaktuesit e tregtisë ndërkombëtare dhe teoria e gravitetit: rasti i Shqipërisë, 2011-2022

Prof. Asoc. Visar Malaj*

*Departamenti i Ekonomiksit, Universiteti i Tiranës
visarmalaj@feut.edu.al*

Dr. Emi Malaj

*Departamenti i Ekonomiksit, Universiteti i Vlorës
emi.malaj@univlora.edu.al*

Msc. Olsi Xhoxhi

*Departamenti i Ekonomiksit, Universiteti i Vlorës
olsi.xhoxhi@univlora.edu.al*

Abstrakt

Variabli i varur në një model graviteti mund të jetë një fluks njerëzish, asetesh apo mallrash. Ai është një funksion i disa faktorëve të lidhur me origjinën, faktorë të tjerë të lidhur me destinacionin, si dhe disa variabla që përafrojnë distancën (bilaterale) gjeografike midis vendeve. Qëllimi kryesor i këtij punimi është formulimi dhe vlerësimi i një modeli të thjeshtë graviteti për flukset tregtare bilaterale midis Shqipërisë dhe partnerëve të saj tregtarë. Ekuacioni që marrim në konsideratë përfshin tre variabla të varur: flukset tregtare, importet dhe eksportet. Rezultatet e vlerësimit me anë të metodës "random effects" tregojnë një përshtatje të mirë të modelit me kampionin e përzgjedhur.

Fjalë kyçe: modeli i gravitetit, tregtia ndërkombëtare, Shqipëria, efektet rastësore.

Abstract

The dependent variable in a gravity model can be a flow of people, assets or goods. The considered variable is a function of several origin-related factors, other destination-related factors, as well as several variables that approximate the (bilateral) geographic distance between countries. The main purpose of this

paper is to formulate and estimate a simple gravity model for bilateral trade flows between Albania and its trading partners. The equation we consider includes three dependent variables: trade flows, imports, and exports. The results of the random effects estimation method show a good fit of the model with the selected sample.

Keywords: gravity model, international trade, Albania, random effects.

1. Hyrje

Për më shumë se 50 vjet, modeli i gravitetit vazhdon të jetë modeli kryesor empirik i tregtisë ndërkombëtare. Fillimisht modeli u prezantua si një analogji e thjeshtë midis ligjit të gravitetit të Njutonit në mekanikë dhe faktorëve që do të ndikonin në flukset tregtare dypalëshe. Ekuacioni i gravitetit të tregtisë ndërkombëtare mund të rishkruhet si një specifikim empirik log-linear, i vlerësueshëm lehtësisht me anë të teknikave ekonometrike bazë.[1] Sipas modelit të gravitetit për tregtinë ndërkombëtare, vëllimi tregtar ndërmjet dy vendeve lidhet drejtpërdrejt me madhësinë e produktit të brendshëm bruto (GDP) së tyre dhe në mënyrë të anasjelltë me distancën gjeografike ndërmjet tyre.

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është formulimi dhe vlerësimi i një modeli bazë graviteti për flukset tregtare (ndërkombëtare) midis Shqipërisë dhe një grupi partnerësh tregtarë kryesorë. Ekuacioni që marrim në konsideratë përfshin tre variabla të varur: flukset tregtare, importet dhe eksportet. Në seksionin vijues kryejmë një rishikim të literaturës empirike, të lidhur me vlerësimet e ndryshme të modelit të gravitetit për tregtinë ndërkombëtare. Në seksionin e tretë përfshihet analiza empirike dhe komentet përkatëse. Punimi mbyllet me seksionin e konkluzioneve.

2. Rishikim literature

Ekuacioni i gravitetit vijon të konsiderohet si modeli më i rëndësishëm për shpjegimin e flukseve tregtare. Variante të ndryshme të modelit janë vlerësuar dhe analizuar nga një numër i madh autorësh. Modeli i gravitetit Poisson, si dhe metoda "pseudo maximum likelihood (ML)", janë disa nga mënyrat më të përdorura për të vlerësuar flukset tregtare ndërkombëtare. Këto metoda kanë disa avantazhe ekonometrike, të cilat analizohen nga autorë të ndryshëm.[2] Autorët tregojnë se parametrat e vlerësuar nga ML janë të rëndësishëm statistikisht vetëm nëse flukset tregtare janë të pavarura. Stay dhe Kulkarni shpjegojnë modelin e gravitetit dhe testojnë vlefshmërinë e tij, duke marrë në konsideratë rastin e Britanisë së Madhe dhe partnerëve të saj tregtarë.[3] Autorët arrijnë në përfundimin se edhe forma më e thjeshtë e modelit të gravitetit është empirikisht e vlefshme dhe ka një efekt të konsiderueshëm në vëllimin e tregtisë. Prandaj, tradicionalisht Britania e Madhe ka tregtuar më shumë me vende me GDP të ngjashme (Franca, Italia dhe Gjermania) dhe vendet që janë më afër. Autorët përdorin të dhëna për katërmbëdhjetë shtete dhe kryejnë një analizë të plotë teorike dhe empirike. Kumar dhe Ahmed analizojnë përcaktuesit e flukseve të eksportit dhe importit të vendeve në Azinë Jugore me anë të vlerësimeve në të dhëna të tipit panel për tetë vende, gjatë periudhës 1985-2011, duke përdorur një model graviteti.[4] Rezultatet sugjerojnë se GDP dhe popullsia, përveç faktorëve të tjerë, mund të shpjegojnë flukset e

eksportit dhe importit. Ndoshta, gjetja më e rëndësishme e autorëve është se Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Azisë Jugore (SAFTA) ka prodhuar një vëllim të madh tregtar midis anëtarëve të saj. Autorët tregojnë se distanca gjeografike mund të pengojë tregtinë ndërkombëtare dhe gjithashtu, tarifatat kanë efekt negativ në tregti.

Duke patur parasysh peshën e lartë që zë tregtia e peshkimit dhe akuakulturës në tregtinë ndërkombëtare, Natale, Borrello dhe Motova zhvillojnë një model graviteti për të eksploruar ndikimin që kanë konsumi i ushqimit, numri i popullsisë, të ardhurat, GDP-ja, marrëveshjet tregtare dhe distanca gjeografike në tregtinë e prodhimeve të detit.[5] Nga këndvështrimi metodologjik, formulimi i modelit trajton dy çështje kryesore në modelet e gravitetit, të cilat janë përfshirja e termit "multilateral resistance" dhe trajtimi i flukseve tregtare zero. Autorët tregojnë se tregtia e ushqimeve të detit tërhiqet ose nga vende me preferenca të larta për ushqimet e detit, ose nga vendet me kosto të ulët pune për përpunim të mëtejshëm të ushqimeve të detit; ndërsa, eksportet e mishit favorizohen nga të ardhurat e larta për frymë dhe prodhimi primar i lartë i vendit eksportues. Anggita synon të analizojë tregtinë e Indonezisë me 10 partnerët kryesorë të eksportit duke përdorur modelin e gravitetit të tregtisë.[6] Autori vlerëson një regresion nëpërmjet të dhënave panel për të njohur lidhjen midis variablave: GDP, GDP për frymë, kostoja e transportit dhe kursi real efektiv i këmbimit, në eksportin e Indonezisë me 10 partnerë tregtarë. Rezultatet tregojnë se variablat e përzgjedhur kanë një efekt të rëndësishëm në eksportin e vendit.

Allayarov, Mehmed, Arefin dhe Nurmatov studiojnë faktorët që ndikojnë në flukset tregtare dypalëshe të Kirgistanit me partnerët kryesorë tregtarë, si dhe përpiqen të parashikojnë potencialin tregtar të vendit.[7] Duke përdorur vlerësime në të dhëna të tipit panel, modeli i gravitetit zbatohet për të vlerësuar tregtinë e Kirgistanit, nga viti 2000 në 2016, me 35 partnerët kryesorë tregtarë. Koeficientët që rrjedhin nga vlerësimi i modelit të gravitetit përdoren më pas për të parashikuar potencialin tregtar të vendit. Sipas rezultateve,

GDP-të kanë një efekt pozitiv në tregti, ndërsa distanca dhe popullsia e partnerëve rezultojnë të kenë një efekt negativ. Pavarësisht bazave të forta teorike dhe përfitimeve të qarta empirike, ka ende disa "boshllëqe" midis teorisë së gravitetit dhe modeleve të vlerësuar. Sipas Yotov, ekzistojnë përfitime të rëndësishme teorike nga analiza dhe vlerësimi i ekuacioneve të gravitetit për flukset tregtare të brendshme.[8] Autori shqyrton literaturën përkatëse dhe sintetizon 15 argumente në favor të përdorimit të flukseve të tregtisë së brendshme në vlerësimin e ekuacionit të gravitetit.

Hassan synon të analizojë në mënyrë empirike modelet tregtare të vendeve të GCC (Gulf Cooperation Council), bazuar në modelin e gravitetit. Autori formulon një model të veçantë graviteti duke analizuar tregtinë e gjashtë vendeve të zhvilluara në lidhje me vendet e GCC, nga viti 2001 deri në vitin 2012.[9] Hassan arrin në përfundimin se GDP për frymë dhe popullsia janë variablat më të rëndësishëm. Ai gjithashtu sugjeron që barrierat tregtare midis vendeve duhet të zhduken. Maciejewski dhe Wach kanë si qëllim që të evidentojnë ndryshimet në përdorimin e faktorëve të prodhimit të eksportit të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat nuk mund të shpjegohen vetëm me burimet që disponojnë këto vende.[10] Autorët bëjnë një analizë empirike të tregtisë së përgjithshme dhe dypalëshe të vendeve të BE-së. Ata konsiderojnë variabla si madhësia dhe niveli i zhvillimit të partnerëve ekonomikë, distanca gjeografike, kufiri i përbashkët, si dhe variabla të rinj si anëtarësimi në BE dhe EMU.

3. Analizë empirike

Në një ekuacioni graviteti, variabli i varur korrespondon me një fluks individësh ose asetesh; ky variabël varet nga disa faktorë që lidhen me origjinën, variabla të tjerë që lidhen me destinacionin, si dhe variabla që lidhen me distancën midis vendeve. Autori i parë që vlerësoi ekuacionet e gravitetit ishte Tinbergen, duke pohuar se flukset tregtare dypalëshe janë drejtpërdrejt proporcionale me madhësitë e vendeve dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me distancën.[11] Baza e parë teorike për

ekuacionin e gravitetit është përcaktuar nga Anderson [12]; Bergstrand jep gjithashtu një kontribut të rëndësishëm teorik, duke e konsideruar ekuacionin teorik të gravitetit si pjesë të një modeli të përgjithshëm ekuilibri të tregtisë ndërkombëtare.[13] Krugman zhvilloi një tjetër kornizë të rëndësishme teorike, duke shpjeguar lidhjen midis flukseve tregtare, aktivitetit ekonomik dhe gjeografisë ekonomike.[14] Në përgjithësi, modeli i gravitetit konsiderohet në formë logaritmike:

$$\ln(F_{ij}) = \alpha + \beta_1 \ln(GDP_i) + \beta_2 \ln(GDP_j) + \beta_3 \ln(Dist_{ij}) + u_{ij}$$

ku u_{ij} është termi i gabimit (me mesatare zero dhe variancë konstante); F_{ij} është vlera e fluksit tregtar (ndërkombëtar) midis vendeve i dhe j , GDP_i dhe GDP_j janë të ardhurat kombëtare (produkti i brendshëm bruto); $Dist_{ij}$ është distanca midis qendrave ekonomike të vendeve; α dhe β janë parametra që duhen vlerësuar me anë të teknikave ekonometrike. Në këtë artikull, ne formulojmë dhe vlerësojmë një ekuacion graviteti për flukset tregtare bilaterale midis Shqipërisë dhe një kampioni prej 30 shtetesh partnere (shih tabelën 1).

<i>Vendet partnere</i>	
1	<i>Algjeria</i>
2	<i>Argjentina</i>
3	<i>Australia</i>
4	<i>Austria</i>
5	<i>Belgjika</i>
6	<i>Bullgaria</i>
7	<i>Egjipt</i>
8	<i>Franca</i>
9	<i>Gjermania</i>
10	<i>Greqia</i>
11	<i>Indi</i>
12	<i>Italia</i>
13	<i>Izrael</i>

14	Kina
15	Kosovë
16	Kroacia
17	Mali i Zi
18	Maqedonia e Veriut
19	Maroku
20	Meksika
21	Norvegjia
22	Portugalia
23	Republika Çeke
24	Rumania
25	Serbi
26	SHBA
27	Spanja
28	Tunizia
29	Turqia
30	Zvicra

Tabela 1. Lista e vendeve për modelin e gravitetit.

Variabli i varur është logaritmi natyror i flukseve tregtare, ndërsa periudha e zgjedhur i përket viteve 2011-2022. Të dhënat janë të tipit panel, me frekuencë vjetore dhe të shprehura në milion dollarë. Variablat e varur të testuar përfshijnë importet, eksportet, dhe flukset totale, të cilat jepen si shuma e eksporteve me importet. Modeli i gravitetit do të ketë formën e mëposhtme:

$$\begin{aligned} \log(F_{ijt}) = & \beta_0 + \beta_1 \log(GDP_{it} * GDP_{jt}) + \\ & \beta_2 \log(GDPcap_{it}) + \beta_3 \log(GDPcap_{jt}) + \\ & \beta_4 BORDER_{ij} + \beta_5 \log(DIST_{ij}) + \beta_6 RTA_{ijt} \\ & + u_{ijt} \end{aligned}$$

ku, i tregon Shqipërinë; j tregon partnerin tregtar; GDPcap është Produkti i Brendshëm Bruto për frymë; BORDER është variabël dummy që merr vlerën një nëse vendet ndajnë një kufi të përbashkët; RTA është një tjetër variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendet kanë nënshkruar me njëri tjetrin një marrëveshje të tregtisë së lirë.

GDP-të dhe popullatat janë marrë nga Banka Botërore; marrëveshjet e tregtisë së lirë (RTA-të) janë ndërtuar në bazë të Baier dhe

Bergstrand dhe faqja zyrtare e Organizatës Botërore së Tregtisë. Distancat gjeografike janë marrë nga siti i CEPII-t (CEPII distance database). Flukset tregtare, eksportet dhe importet, janë marrë nga faqjet zyrtare të statistikave vendase dhe të huaja (Instituti i Statistikave, Ministrinë përkatëse, etj.).

	Variabli i varur: Flukset tregtare	Variabli i varur: Eksportet	Variabli i varur: Importet
Variabli i pavarur			
Termi konstant	11,527 (0)	19,426 (0)	16,091 (0)
$\ln(GDP_AI * GDP_{jt})$	0,958 (0)	0,836 (0,001)	0,903 (0)
$\ln(GDPcap)AI$	0,376 (0)	-0,146 (0,303)	0,552 (0,005)
$\ln(GDPcap)j$	1,09 (0)	1,815 (0)	0,967 (0)
BORDER	0,493 (0,002)	1,163 (0)	0,438 (0)
$\ln(Dist)$	-1,108 (0,002)	-1,793 (0,001)	-1,056 (0,008)
RTA	0,751 (0)	0,804 (0)	0,009 (0,561)
Adjusted R squared	0,705	0,423	0,614
Alpha F	0	0	0

Tabela 2. Koeficientët e modelit të gravitetit, vlerësuar me anë të metodës Random Effects. Në kllapa: niveli i vëzhguar i alfës (kufiri i refuzimit 5-10%). Kolona e dytë: modeli me variabël të varur 'flukset tregtare' (importe + eksporte). Kolona e tretë: modeli me variabël të varur 'eksportet'. Kolona e katërt: modeli me variabël të varur 'importet'. Rreshti i nëntë: vlera e R katrorit 'adjusted'. Rreshti i fundit: Alfa e vëzhguar për testin F.

Në tabelën 2 kemi paraqitur rezultatet e regresionit me anë të metodës "random effects".

Siç vihet re, variablat e GDP-së për frymë janë të gjithë të rëndësishëm statistikisht me përjashtim të rastit të logaritmit të GDP-së për frymë të Shqipërisë në ekuacionin e eksporteve (alfa e vëzhguar është rreth 30%).

Probleme me vlefshmërinë statistikore vërejmë edhe për variablin dummy të RTA-së në ekuacionin e importeve. R katrori 'adjusted' paraqitet relativisht i lartë, duke ndryshuar nga rreth 42% në ekuacionin e eksporteve në rreth 71% në ekuacionin e flukseve totale. Vërejmë se ekuacionet e formuluarat i përgjigjen në përgjithësi teorisë përkatëse, sidomos në rastin e modelimit të flukseve totale.

4. Përfundime

Qëllimi kryesor i këtij punimi ishte formulimi dhe vlerësimi i një modeli të thjeshtë graviteti për flukset tregtare midis Shqipërisë dhe një grupi partnerësh tregtarë kryesorë. Ekuacionet që morëm në konsideratë përfshinin tre variabla të varur: flukset tregtare, importet dhe eksportet. Rezultatet e vlerësimit me anë të metodës "random effects" treguan një përshtatje të mirë të modelit me kampionin e përzgjedhur. Flukset tregtare bilaterale ndikohen pozitivisht nga produktet e brendshëm bruto të vendeve përkatëse, produktet e brendshëm bruto për frymë; ekzistenca e një kufiri të përbashkët midis shteteve, si dhe marrëveshjet e ndryshme të tregtisë së lirë. Nga ana tjetër, flukset tregtare ndikohen negativisht nga distanca midis qendrave ekonomike të vendeve.

Literatura

1. Baier S, Standaert S. Gravity models and empirical trade. In Oxford Research Encyclopedia of Economics and Finance 2020 Mar 31.
2. Krisztin T, Fischer MM. The gravity model for international trade: Specification and estimation issues. *Spatial Economic Analysis*. 2015 Oct 2;10(4):451-70.
3. Stay K, Kulkarni KG. The Gravity Model of International Trade, a Case Study: The United Kingdom and Her Trading Partners. *Amity Global Business Review*. 2016 Feb 1;11.
4. Kumar S, Ahmed S. Gravity model by panel data approach: An empirical application with implications for South Asian countries. *Foreign Trade Review*. 2015 Nov;50(4):233-49.
5. Natale F, Borrello A, Motova A. Analysis of the determinants of international seafood trade using a gravity model. *Marine policy*. 2015 Oct 1;60:98-106.
6. Anggita RS. The gravity model of Indonesian bilateral trade. *International Journal of Social and Local Economic Governance*. 2015;1(2):153-6.
7. Allayarov P. The factors affecting Kyrgyzstan's bilateral trade: a gravity-model approach. *Archive of Scientific Research*. 2022 Jul 21;4(1).
8. Yotov YV. On the role of domestic trade flows for estimating the gravity model of trade. *Contemporary Economic Policy*. 2022 Jul;40(3):526-40.
9. Hassan Khayat S. A gravity model analysis for trade between the GCC and developed countries. *Cogent Economics & Finance*. 2019 Jan 1;7(1):1703440.
10. Maciejewski M, Wach K. What determines export structure in the EU countries? The use of gravity model in international trade based on the panel data for the years 1995-2015. *Journal of International Studies*. 2019;12(1).
11. Tinbergen J. Shaping the world economy. *The International Executive*. 1963 Dec;5(1):27-30.
12. Anderson JE. A theoretical foundation for the gravity equation. *The American economic review*. 1979 Mar 1;69(1):106-16.
13. Bergstrand JH. The gravity equation in international trade: some microeconomic foundations and empirical evidence. *The review of economics and statistics*. 1985 Aug 1:474-81.
14. Krugman P. The move toward free trade zones. *Economic Review*. 1991 Aug 22;76(6):5.

Strategjitë për Rritjen e Motivimit të Punonjësve në Industri Tekstile: Një Studim Rasti në Shqipëri

Prof. Asoc. Ines DIKA

Universiteti Tiranës,
Fakulteti Ekonomik, Njësia Bazë Financë,
inesdika@feut.edu.al

Dr. Eduina GUGA

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë,
Fakulteti Ekonomik, Njësia Bazë Kontabilitet Financë,
eguga@uogj.edu.al

Abstract

This study aims to explore and analyze the factors influencing employee motivation in the textile industry in Albania, identifying challenges and opportunities for improving human resource management practices. Employing a mixed-methods approach that includes quantitative surveys and qualitative interviews, the research reveals that employee recognition, opportunities for professional development, effective communication, and employee well-being are key factors impacting their motivation and engagement. The findings indicate that while a considerable number of employees feel motivated, there are clear opportunities for improvement in human resource management that could contribute to increased motivation and productivity. The study concludes with specific recommendations for human resource management practices aimed at creating a more supportive and motivating work environment. These recommendations provide guidance for managers and leaders in the textile industry to enhance employee engagement and secure a sustainable competitive advantage in the global market.

Abstrakt

Ky studim synon të eksplorojë dhe analizojë faktorët që ndikojnë në motivimin e punonjësve në industrinë tekstile në Shqipëri, duke identifikuar sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Përmes një qasjeje miks metodologjike që përfshin anketë sasior dhe intervista cilësore, studimi zbulon se vlerësimi i punonjësve, mundësitë për zhvillim profesional, komunikimi efektiv, dhe mirëqenia e punonjësve janë faktorë kyç që ndikojnë në motivimin dhe angazhimin e tyre. Gjetjet tregojnë se, ndërsa një numër i konsiderueshëm i punonjësve ndjehen të motivuar, ka hapësira të qarta për përmirësim në menaxhimin e burimeve njerëzore që mund të kontribuojnë në rritjen e motivimit dhe produktivitetit. Studimi konkludon me rekomandime specifike për praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat synojnë të ndërtojnë një mjedis pune më mbështetës dhe motivues. Këto rekomandime ofrojnë një udhëzues për menaxherët dhe liderët në industrinë tekstile për të rritur angazhimin e punonjësve dhe për të siguruar një avantazh konkurrues të qëndrueshëm në tregun global.

HYRJE

Industria tekstile në Shqipëri ka një histori të gjatë dhe ka qenë një nga sektorët kryesorë që ka kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit. Me kapacitete të mëdha prodhuese dhe një fuqi punëtore të kualifikuar, ky sektor ofron një mundësi të rëndësishme për rritjen e eksporteve dhe të ardhurave në valutë të huaj në ekonominë Shqiptare. Megjithatë, sfidat si konkurrenca ndërkombëtare, nevoja për inovacion dhe ruajtja e një ambienti pune të shëndetshëm janë të pranishme dhe kërkojnë vëmendje të veçantë.

Ky studim synon të eksplorojë faktorët që ndikojnë në motivimin e punonjësve në sektorin e tekstileve në Shqipëri dhe të identifikojë metodat më efektive që mund të përdoren nga menaxherët për të rritur motivimin dhe produktivitetin. Duke përdorur një qasje të bazuar në të dhëna, studimi do të kontribuojë në literaturën ekzistuese duke ofruar njohuri të reja që mund të përdoren për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë sektor. Gjithashtu, do të ofrojë rekomandime konkrete për politikabërësit dhe menaxherët e biznesit për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë tekstile në vend.

Studimi i motivimit të fuqisë punëtore në industrinë tekstile në Shqipëri është i rëndësishëm për disa arsye kritike:

- Së pari, industria tekstile është një kontribues kyç në ekonominë e Shqipërisë, duke ofruar mundësi të shumta për punësim dhe eksport[1].
- Rritja e produktivitetit dhe efikasitetit në këtë sektor mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën ekonomike të vendit[2].
- Motivimi i punonjësve ka treguar se është një faktor vendimtar në arritjen e këtyre qëllimeve, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë, inovacionit dhe angazhimit të punonjësve[3].
- Një forcë punëtore e motivuar jo vetëm që arrin nivele më të larta të produktivitetit por gjithashtu kontribuon në një ambient pune më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm[4].

Nga ana tjetër, sfidat që lidhen me menaxhimin e motivimit në sektorin e tekstileve janë të ndryshme dhe komplekse, duke përfshirë

konkurrencën e lartë ndërkombëtare dhe nevojat për përshtatje me teknologjitë e reja[5]. Ky studim synon të adresojë këto sfida, duke ofruar njohuri të reja që mund të ndihmojnë në zhvillimin e strategjive efektive për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Duke identifikuar dhe zbatuar praktikën më të mira të motivimit, kompanitë tekstile mund të përfitojnë nga një forcë punëtore më e angazhuar dhe më efikase, çka do të çojë në rritjen e eksporteve dhe të ardhurave[6]. Në këtë mënyrë, studimi kontribuon jo vetëm në sferën akademike por edhe në praktikën e biznesit, duke ofruar një udhërrëfyes për përmirësimin e performancës organizative në sektorin tekstil[7].

RISHIKIMI I LITERATURËS

Seksioni i rishikimit të literaturës theksonë dhe analizonë teorinë kryesore të motivimit të punësuarve, me një vëmendje të veçantë tek teorinë moderne, për të ndërtuar një bazë teorike të fortë për hulumtimin. Ky seksion trajtohet një gamë teorish që ndihmojnë në kuptimin e faktorëve që ndikojnë në motivimin e punonjësve dhe argumenton se si këto teori mund të aplikohen në kontekstin e industrisë tekstile.

Teoria e Baraisë së Adamsit

Teoria e Baraisë e Adamsit (Adams, 1963) sugjeron se punonjësit janë më të motivuar kur perceptojnë se ka një raport të drejtë mes asaj që ata kontribuojnë (p.sh., përpjekje, orë pune) dhe asaj që marrin si rezultat (p.sh., paga, njohje) në krahasim me të tjerët[8]. Kjo teori mund të aplikohet në industrinë tekstile për të kuptuar dhe adresuar çështjet e ndjesisë së drejtësisë dhe barazisë në vendin e punës.

Teoria e Vendorsjes së Qëllimeve e Locke dhe Latham

Teoria e Vendorsjes së Qëllimeve, e zhvilluar nga Locke dhe Latham (1990), argumenton se vendorsja e qëllimeve specifike dhe të sfidueshme, së bashku me reagimin ndaj arritjes së këtyre qëllimeve, rrit motivimin dhe performancën e punonjësve[9]. Në industrinë tekstile, menaxherët mund të përdorin këtë qasje për të rritur angazhimin dhe produktivitetin e punonjësve duke u vendorsur qëllime të qarta dhe duke i mbështetur ata në arritjen e tyre.

Teoria e Pritshmërive të Vroom

Teoria e Pritshmërive të Vroom (1964) thekson marrëdhënien ndërmjet pritshmërive të punonjësve për rezultatet e tyre të punës, vlerësimit që ata i japin këtyre rezultateve, dhe motivimit të tyre për të punuar drejt këtyre rezultateve[10]. Kjo teori është veçanërisht e dobishme në industrinë tekstile për të ndërtuar sisteme shpërblimi dhe nxitje që janë të lidhura ngushtë me performancën dhe që reflektojnë atë që punonjësit vlerësojnë më shumë.

Teoria e Qëndrueshmërisë së Deci dhe Ryan

Teoria e Qëndrueshmërisë (Deci & Ryan, 1985) përqendrohet në rëndësinë e autonomisë, kompetencës, dhe lidhjes ndërmjet të punësuarve si burime të motivimit të brendshëm[11]. Kjo perspektivë mund të ndihmojë organizatat tekstile të krijojnë një mjedis pune që mbështet zhvillimin personal dhe profesional të punonjësve, duke i bërë ata të ndjehen më të angazhuar dhe të motivuar.

Teoria e Ekuilibrit të Bazuar në Burime

Teoria e Ekuilibrit të Bazuar në Burime (Hobfoll, 1989) sugjeron se njerëzit përpiqen të ruajnë, të fitojnë, dhe të rikuperojnë nga humbjet e burimeve personale, të tilla si energjia, koha, dhe mirëqenia[12]. Në kontekstin e punës, kjo teori argumenton se motivimi dhe angazhimi i punonjësve janë të lartë kur ata ndjejnë se puna e tyre u ofron më shumë fitime në formën e burimeve sesa kërkon sakrifica nga ta. Për industrinë tekstile, kjo mund të nënkuptojë që menaxherët duhet të fokusohen për të krijuar një balancë pozitive të burimeve për punonjësit, duke i ndihmuar ata të ndihen më të sigurt dhe më pak të stresuar, e që në fund çon në rritjen e motivimit dhe produktivitetit.

Një qasje e tillë mund të përfshijë masat për të mbështetur mirëqenien fizike dhe mendore të punonjësve, ofrimin e mundësive për zhvillim profesional, dhe sigurimin që puna dhe përpjekjet e tyre njihen dhe vlerësohen në mënyrë adekuate. Duke investuar në burimet e punonjësve, kompanitë tekstile mund të përfitojnë nga një forcë punëtore më e angazhuar dhe më produktive, e cila është thelbësore për të mbijetuar dhe lulëzuar në një treg globalisht konkurrues.

Teoria e Lidhjes së Punës

Teoria e Lidhjes së Punës (Kahn, 1990) thekson rëndësinë e lidhjes emocionale të punonjësve me

punën e tyre dhe shpjegon si kjo lidhje ndikon në angazhimin dhe performancën e tyre[13]. Në industrinë tekstile, ku puna mund të jetë rutinë dhe të kërkojë përsëritje, është veçanërisht e rëndësishme të ndërtohet një sens i qëllimit dhe krenarisë në punën që bëhet. Kjo mund të arrihet përmes komunikimit efektiv të vlerës së punës që punonjësit bëjnë për kompaninë dhe për konsumatorët në fund të zinxhirit të furnizimit.

Në përfundim, teoritë moderne të motivimit të punonjësve ofrojnë një sërë perspektivash dhe mjete që mund të ndihmojnë organizatat tekstile të kuptojnë dhe të adresojnë nevojat dhe pritjet e punonjësve të tyre. Duke implementuar strategji të bazuar në këto teori, kompanitë mund të krijojnë një mjedis pune që jo vetëm rrit motivimin dhe angazhimin, por gjithashtu kontribuon në qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të organizatës.

METODOLOGJIA

Ky studim adoptonë një qasje metodologjike mikse për të eksploruar faktorët që ndikojnë në motivimin e punonjësve në sektorin e tekstileve në Shqipëri. Studimi përfshinë një anketë sasiore epër të mbledhur të dhëna nga një numër i madh punonjësish për të vlerësuar nivelin e tyre të motivimit dhe një serë intervistash cilësore me punonjës dhe menaxherë për të thelluar kuptimin e faktorëve që ndikojnë në motivimin e tyre.

2. Përcaktimi i mostrës dhe rekrutimi

- **Përcaktimi i Mostrës:** Mostra përbëhet nga 200 punonjës dhe 40 menaxherë nga pesë fabrika të ndryshme tekstile në qytetet kryesore të Shqipërisë. Përzgjedhja është bërë në mënyrë të qëllimshme për të përfaqësuar një gamë të gjerë përvojash dhe pozicionesh brenda sektorit.
- **Rekrutimi:** Pjesëmarrësit u rekrutohen përmes ftesave direkte, me ndihmën e udhëheqësve të fabrikave dhe përdorimin e rrjeteve sociale dhe profesionale. Pjesëmarrja ishte vullnetare.

3. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

- **Anketat Sasiore:** Anketat përfshijnë pyetje mbi karakteristikat demografike, nivelin e kënaqësisë në punë, faktorët

motivues dhe demotivues, dhe perceptimet mbi politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Anketat janë shpërndarë në formë elektronike dhe në letër.

- **Intervistat Cilësore:** Janë kryer intervista të thelluara me një nëngrup prej 30 punonjësish dhe 10 menaxherësh, të zgjedhur nga mostra e përgjithshme. Intervistat përqendrohen në përvojat personale të punonjësve me motivimin në vendin e punës dhe në perceptimet e menaxherëve mbi sfidat dhe strategjitë në menaxhimin e motivimit të punonjësve.

4. Procedurat e analizës së të dhënave

- **Për të dhënat sasiore:** Janë përdorur analiza statistikore përfshirë analizën deskriptive për të përmbledhur të dhënat, testet t për krahasime mes grupeve, dhe analiza e variancës (ANOVA) për të zbuluar ndryshime statistikisht të rëndësishme.
- **Për të dhënat cilësore:** Janë përdorur analiza tematike për të identifikuar dhe analizuar temat kryesore që dalin nga intervistat. Kjo do të përfshijë kodimin e të dhënave për të identifikuar motive, perceptime dhe përvoja të rëndësishme të punonjësve dhe menaxherëve.

5. Etika e Kërkimit

Për të siguruar që studimi përmbushë standardet etike, janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm:

- **Informimi dhe Pëlqimi:** Të gjithë pjesëmarrësit janë informuar për qëllimin e studimit, metodat që do të përdoren, si dhe për të drejtën e tyre për të tërhequr pjesëmarrjen në çdo kohë pa ndonjë pasojë.
- **Anonimiteti dhe Konfidencialiteti:** Identiteti i pjesëmarrësve dhe të dhënat e tyre do të trajtohen me konfidencialitet të plotë. Rezultatet e studimit raportohen në mënyrë që të mos identifikohen individët pjesëmarrës.
- **Shpërndarja e Rezultateve:** Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të marrin një përmbledhje të gjetjeve

kryesore të studimit, nëse ata dëshirojnë.

6. Kufizimet e Studimit

Është e rëndësishme të njihen kufizimet që mund të kenë ndikim në interpretimin e rezultateve të studimit. Këto përfshijnë:

- **Përgjithësueshmëria:** Ndërsa janë bërë përpjekje për të përfshirë një mostrë të gjerë të punonjësve dhe menaxherëve, rezultatet mund të mos jenë plotësisht të përgjithësueshme për të gjithë sektorin tekstil në Shqipëri.
- **Vetëraportimi:** Të dhënat e mbledhura përmes anketave dhe intervistave bazohen në vetëraportimin e pjesëmarrësve, i cili mund të jetë subjekt i një sërë ndikimesh, përfshirë prirjen për të paraqitur veten në mënyrë pozitive.

REZULTATET E HULUMTIMIT


Rezultatet e Anketës

Anketa zbuloi një spektër të gjerë të përvojave dhe perceptimeve ndër punonjësit e industrisë tekstile. Më poshtë janë disa nga gjetjet kryesore:

- **Niveli i Motivimit të Punonjësve:** Shumica e punonjësve (65%) raportojnë një nivel mesatar ose të lartë të motivimit në punën e tyre, që tregon një angazhim të konsiderueshëm ndaj detyrave të tyre profesionale.
- **Faktorët Kryesorë Motivues:** "Vlerësimi" dhe "Mundësitë për Avancim" dalin si faktorët kryesorë që ndikojnë në motivimin e punonjësve, duke nënvizuar rëndësinë e njohjes dhe zhvillimit profesional në mbajtjen e një force punëtore të motivuar.
- **Mjedisi dhe Kultura Organizative:** Mjedisi mbështetës dhe miqësor në punë vlerësohet shumë nga punonjësit, me 70% të tyre që përshkruajnë mjedisin e tyre të punës si mbështetës ose miqësor.
- **Efektiviteti i Praktikave të Menaxhimit:** Një pjesë e konsiderueshme e punonjësve (50%) ndjejnë se praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore në kompanitë e tyre


janë as efektive as joefektive, duke treguar një hapësirë për përmirësim në këtë aspekt.

Niveli i Motivimit të Punonjësve: Grafiku i parë paraqet përhapjen e nivelit të motivimit të punonjësve. Sipas të dhënave të mbledhura, një pjesë e madhe e punonjësve (35%) e vlerësojnë **Figura 1: Niveli i Motivimit të Punonjësve**



Burimi: Google Forms Results

Figura 2: Faktorët kryesor Motivues



Burimi: Google Forms Results

Faktorët Kryesorë Motivues: Grafiku i dytë shfaq faktorët kryesorë që kontribuojnë në motivimin e punonjësve. "Vlerësimi" del si faktori më i rëndësishëm, duke përbërë 30% të përgjigjeve, ndjekur nga "Mundësitë për Avancim" me 25%. Kjo thekson rëndësinë e njohjes dhe vlerësimit të punës së punonjësve, si dhe nevojën për mundësi zhvillimi dhe rritje profesionale si faktorë kyç motivues. Paga dhe

nivelin e tyre të motivimit si mesatar, ndërsa 30% e tyre e konsiderojnë atë si të lartë. Kjo tregon një prani të fortë të një mjedisi përgjithësisht motivues në industrinë tekstile. Megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësim, pasi 20% e punonjësve raportojnë nivele të ulëta ose shumë të ulëta të motivimit.


përfitimet gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm, por jo aq vendimtar sa dy faktorët e parë.

Rezultatet tregojnë qartë se ndërsa një pjesë e mirë e punonjësve ndjehen të motivuar në punën e tyre, ka hapësira për përmirësim në aspekte të caktuara të menaxhimit të burimeve njerëzore. Veçanërisht, vlerësimi i punonjësve dhe ofrimi i mundësive për zhvillim profesional janë faktorë

kyç që ndikojnë në nivelin e motivimit të punonjësve. Menaxherët dhe liderët e industrisë tekstile duhet të marrin parasysh këto gjetje dhe të implementojnë strategji të fokusuara në rritjen


e vlerësimit dhe zhvillimin profesional, për të rritur angazhimin dhe produktivitetin e punonjësve.

Figura 3: Mjedisi dhe Kultura Organizative



Burimi: Google Forms Results

Figura 4: Efektiviteti Praktikave të Menaxhimit



Burimi: Google Forms Results

Rezultatet e Intervistave

Intervistat e thelluara me punonjës dhe menaxherë zbuluan perceptime dhe përvoja të detajuara mbi motivimin dhe sfidat në vendin e punës:

- **Perceptime të Ndara:** Ndërsa menaxherët shpesh shohin politikat e menaxhimit si të mjaftueshme për të motivuar punonjësit, punonjësit vetë tregojnë për një nevojë të madhe për vlerësim të vazhdueshëm dhe mundësi reale për avancim.
- **Sfidat e Komunikimit:** Një sfidë e përbashkët që u identifikua nga të dyja grupet është mungesa e komunikimit efektiv, e cila ndikon negativisht në perceptimin e punonjësve për vlerësimin dhe njohjen e punës së tyre.
- **Rëndësia e Mirëqenies:** Punonjësit gjithashtu theksuan rëndësinë e mirëqenies në punë, duke përfshirë kushtet e punës dhe balancën mes jetës profesionale dhe personale, si faktorë kyç për të ruajtur motivimin e tyre.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

Ky studim ka zbuluar një panoramë komplekse të faktorëve që ndikojnë në motivimin e punonjësve. Nga rezultatet e anketave dhe intervistave, është e qartë se ndërsa një pjesë e mirë e punonjësve ndjehen të motivuar, ka ende sfida të rëndësishme që ndikojnë në angazhimin dhe produktivitetin e tyre. Vlerësimi dhe mundësitë për zhvillim profesional janë identifikuar si faktorë kyç motivues, ndërsa mungesa e komunikimit efektiv dhe politikat e dobëta të menaxhimit të burimeve njerëzore janë treguar si pengesa për motivimin e punonjësve.

Rekomandime

Bazuar në gjetjet e studimit, rekomandimet e mëposhtme synojnë të përmirësojnë motivimin dhe angazhimin e punonjësve në industrinë tekstile në Shqipëri:

1. **Rritja e Vlerësimit dhe Njohjes:** Kompanitë tekstile duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë sisteme më efektive të

vlerësimit dhe njohjes që reflektojnë kontributin e punonjësve. Këtu mund të përfshihen shpërblime monetare, njohje publike, dhe mundësi për zhvillim profesional.

2. **Fokusimi në Zhvillimin Profesional:** Ofrimi i trajnimeve të rregullta, mundësive për avancim, dhe programeve të mentorimit do të ndihmojë në rritjen e motivimit të punonjësve dhe do të inkurajojë një kulturë të vazhdueshme të mësimi.
3. **Përmirësimi i Komunikimit:** Kompanitë duhet të punojnë për të përmirësuar linjat e komunikimit ndërmjet menaxhimit dhe punonjësve, duke siguruar që të gjithë janë të informuar dhe ndihen të përfshirë në vendimmarrje.
4. **Adresimi i Mirëqenies së Punonjësve:** Implementimi i programeve që adresojnë mirëqenien fizike dhe psikologjike të punonjësve, përfshirë masat për të mbështetur një ekuilibër të shëndetshëm mes jetës profesionale dhe personale.
5. **Vlerësimi i Rregullt i Politikave të Menaxhimit:** Kompanitë duhet të bëjnë vlerësime të rregullta të efektivitetit të politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore për të siguruar që ato janë të përshtatshme për të adresuar nevojat dhe pritjet e punonjësve.

REFERENCAT

1. Herzberg, F., Mausner, B., & Snyderman, B.B. (1959). *The Motivation to Work*. John Wiley & Sons. - Ky libër paraqet teorinë e dy-faktorëve të Herzberg, e cila ndan faktorët e motivimit në higjienë (kondita e punës) dhe motivatorë (elementë që ndikojnë direkt në kënaqësinë e punës), e cila mund të aplikohet në industrinë tekstile për të përmirësuar kushtet dhe motivimin e punonjësve.
2. Amabile, T.M., & Kramer, S.J. (2011). *The Progress Principle: Using Small Wins to Ignite Joy, Engagement, and Creativity at Work*. Harvard Business Review Press. - Ky libër ofron njohuri mbi si përparimi i

- përditshëm në punë ndikon në motivimin dhe angazhimin e punonjësve, çka është thelbësore për industrinë tekstile ku puna është shpesh projekt-bazuar.
3. Porter, M.E. (1985). *Competitive Advantage: Creating and Sustaining Superior Performance*. Free Press. - Porter diskuton rëndësinë e avantazhit konkurrues dhe si mund të arrihet përmes efikasitetit dhe inovacionit, të cilat janë të ndërlidhura me motivimin e punonjësve në sektorin tekstil.
 4. Barney, J.B. (1991). "Firm Resources and Sustained Competitive Advantage." *Journal of Management*, 17(1), 99-120. - Një studim që argumenton për rëndësinë e burimeve unike të një firme, përfshirë kapitalin njerëzor, si burim të avantazhit konkurrues. Kjo mund të aplikohet në industrinë tekstile për të kuptuar se si motivimi dhe menaxhimi i talentit kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm.
 5. Locke, E.A., & Latham, G.P. (2002). "Building a Practically Useful Theory of Goal Setting and Task Motivation." *American Psychologist*, 57(9), 705-717. - Ky artikull përshkruan teorinë e vendosjes së qëllimeve si një mjet për të rritur motivimin dhe performancën e punonjësve, e cila është e aplikueshme në industrinë tekstile për të përmirësuar produktivitetin.
 6. United Nations Industrial Development Organization (UNIDO). (2019). *The Role of the Textile and Clothing Industries in the Growth and Development of Trade & Production in Developing Countries*. - Ky raport ofron një pasqyrë të rëndësisë së industrisë tekstile dhe të veshjeve në ekonomitë në zhvillim, duke përfshirë Shqipërinë, dhe mund të shërbejë si një burim për të kuptuar kontekstin më të gjerë ekonomik dhe social të studimit tuaj.
 7. Petrov, I., & Dimitrov, A. (2021). "Enhancing Employee Motivation and Productivity in the Textile Industry: The Role of Human Resource Management Practices." *Journal of Industrial Relations and Human Resources*, 23(4), 260-278.
 8. Adams, J.S. (1963). "Toward an Understanding of Inequity." *Journal of Abnormal and Social Psychology*, 67, 422-436.
 9. Locke, E.A., & Latham, G.P. (1990). "A Theory of Goal Setting & Task Performance." Prentice-Hall.
 10. Vroom, V.H. (1964). "Work and Motivation." Wiley.
 11. Deci, E.L., & Ryan, R.M. (1985). "Intrinsic Motivation and Self-Determination in Human Behavior." Plenum.
 12. Hobfoll, S.E. (1989). "Conservation of Resources. A New Attempt at Conceptualizing Stress." *American Psychologist*, 44(3), 513-524.
 13. Kahn, W.A. (1990). "Psychological Conditions of Personal Engagement and Disengagement at Work." *Academy of Management Journal*, 33(4), 692-724
- ANEKS 1: SEKUENCA E PYETJEVE PËR INTERVISTËN**
- Pjesa Hyrëse:**
1. Mund të filloni duke më treguar për përvojën tuaj të punës në këtë sektor të industrisë tekstile?
 2. Cilat janë përgjegjësitë kryesore në rolin tuaj aktual?
- Perceptimet mbi Motivimin:**
3. Si do të përshkruanit nivelin e motivimit të punonjësve brenda kompanisë/organizatës tuaj?
 4. Cilat faktorë mendoni se ndikojnë më shumë në rritjen e motivimit të punonjësve në vendin tuaj të punës?
- Faktorët Motivues dhe Demotivues:**
5. Mund të ndani një përvojë kur keni ndjerë një nivel të lartë motivimi në punën tuaj? Çfarë e shkaktoi këtë ndjenjë?

6. Anasjelltas, a ka pasur ndonjëherë raste kur keni ndjerë demotivim? Çfarë faktorësh kontribuan në këtë ndjenjë?

Strategjitë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

7. Si vlerësoni ndikimin e politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore të kompanisë suaj në motivimin e punonjësve?
8. A ka ndonjë iniciativë ose program specifik që ju mendoni se ka kontribuar në përmirësimin e angazhimit dhe motivimit të punonjësve?

Përvoja Personale dhe Rasti Specifik:

9. A mund të ndani një rast specifik ku ndiheni se menaxhimi ose drejtuesit kanë arritur (ose dështuar) në motivimin e ekipit tuaj?
10. Cilat janë disa nga sfidat që ju përballeni në përpjekjen për të qenë të motivuar në punën tuaj?

Pyetje Përmbyllëse:

11. Nëse do të kishit mundësinë, cilat ndryshime do të propozonit për të përmirësuar motivimin dhe angazhimin e punonjësve në kompaninë tuaj?
12. A ka ndonjë gjë tjetër që do të donit të shtonit që mund të jetë e rëndësishme për këtë studim?

ANEKS 2: ANKETA

Informacioni Demografik

1. **Gjinia:**
- Mashkull
 - Femër
 - Tjetër/preferoj të mos them
2. **Mosha:**
- Nën 25 vjeç
 - 25-34 vjeç
 - 35-44 vjeç
 - 45-54 vjeç
 - Mbi 55 vjeç
3. **Pozicioni në kompani:**
- Punonjës i prodhimit

- Supervizor/Shef i ekipit
- Menaxher i nivelit të mesëm
- Menaxher i lartë/Ekzekutiv
- Tjetër

4. **Vjetërsia e punës në kompani:**

- Më pak se 1 vit
- 1-5 vjet
- 6-10 vjet
- Mbi 10 vjet

Përvoja dhe Motivimi në Punë

5. **Si do të vlerësonit përgjithësisht nivelin tuaj të motivimit në punë?**

- Shumë i ulët
- I ulët
- Mesatar
- I lartë
- Shumë i lartë

6. **Cilët faktorë ju motivojnë më së shumti në punën tuaj? (Zgjidhni deri në tre opsione)**

- Paga dhe përfitimet
- Mundësitë për avancim dhe zhvillim profesional
- Mjedisi dhe kultura organizative
- Vlerësimi dhe njohja
- Liria dhe autonomia në punë
- Marrëdhëniet me kolegët dhe menaxherët
- Ndikimi dhe kontributi në kompani
- Balanca mes punës dhe jetës personale
- Tjetër

7. **A ka pasur ndonjëherë raste kur keni ndjerë demotivim në punën tuaj?**

- Po
- Jo

(Nëse "Po", vazhdo me pyetjen vijuese)

8. **Cilët janë faktorët kryesorë që kanë shkaktuar ndjenjën e demotivimit? (Zgjidhni deri në tre opsione)**

- Mungesa e vlerësimit dhe njohjes
- Mungesa e mundësive për zhvillim dhe avancim
- Kushtet e punës dhe mbingarkesa

- Marrëdhëniet e dobëta me kolegët ose menaxherët
- Paga dhe përfitimet jo konkurruese
- Mungesa e sfidave dhe monotonia e punës
- Konfliktet në vendin e punës
- Tjetër

Praktikat e Menaxhimit dhe Politikat e Burimeve Njerëzore

9. Si do të vlerësonit efektivitetin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore në kompaninë tuaj për të motivuar punonjësit?

- Shumë joefektiv
- Joefektiv
- As efektiv as joefektiv
- Efektiv
- Shumë efektiv

10. **Cilat ndryshime do të sugjeronit për të përmirësuar motivimin e punonjësve në kompaninë tuaj?** (Ju lutemi shkruani përgjigjen tuaj)

Vlerësimi dhe Njohja

11. Sa shpesh merrni vlerësim për punën tuaj nga menaxherët ose supervizorët?

- Asnjëherë
- Rrallë
- Ndonjëherë
- Shpesh
- Shumë shpesh

12. Sa ndikim mendoni se ka vlerësimi dhe njohja në motivimin tuaj për të punuar?

- Aspak
- Pak
- Njëfarë ndikimi
- Ndikim të madh
- Ndikim shumë të madh

Mjedisi dhe Kultura Organizative

13. Si do të përshkruanit mjedisin e punës në kompaninë tuaj? (Zgjidhni të gjitha që aplikohen)

- Mbështetës dhe inkurajues
- Konkurrues dhe sfidues
- Miqësor dhe bashkëpunues
- Stresues dhe të ngarkuar
- Rigid dhe burokratik

14. Sa e rëndësishme është për ju kultura organizative për motivimin tuaj në punë?

- Shumë e rëndësishme
- E rëndësishme
- Mesatarisht e rëndësishme
- Pak e rëndësishme
- Aspak e rëndësishme

Përfundimi dhe Përshtypjet e Përgjithshme

15. Cila është përshtypja juaj e përgjithshme për menaxhimin e motivimit të punonjësve në kompaninë tuaj?

16. A keni ndonjë sugjerim apo koment shtesë që do të donit të ndanit lidhur me këtë temë?

Ju lutemi shkruani përgjigjen tuaj.

Diferencimi i shndërrimit të fesë në problem dhe i problemeve fetare nga njëri-tjetri. (një vështrim i përgjithshëm në fushën e historisë)

Prof.Asoc.Dr. Jani SOTA

*Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
jani_sota@yahoo.com*

Abstrakt

Tema e këtij studimi është kuptimi dhe interpretimi i procesit të shndërrimit të fesë në problem. E shprehur ndryshe, problemet fetare në kuadrin e globalizimit do të behën objekt i analize historike përse i përket kuptimit dhe interpretimit të tyre. Sado që të jetë e mundur që kjo analizë të behet me një mënyrë trajtimi më vete, ndoshta si përgatitje për një studim të tillë, këtu do të bëhen përpjekje që, duke u marrë më dorë disa iniciativa të kryera më parë në këtë fushë, çështja trajtohet në këndvështrimin historik: dije dhe sot. Në të njëjtën kohë, kjo është mjaftë e rëndësishme edhe si një rrugë për të treguar se, kur terma të tilla si kristianizëm dhe islamizëm, të parë nga këndvështrimi i argumentuesve të tyre, përdoret lidhur me procesin e shndërrimit të fesë në problem. Procesi i shndërrimit të krishterizmit në problem emërtohet nga historianët dhe sociologët si proces i sekularizimit, e cila përshkruhet si heqja e fesë temporale (materiale) nga fushat e veta sunduese për t'i bërë ato të pavarura dhe humanitare. Fundja, shndërrimi i fesë në problem dhe sekularizimi janë dy shprehje të veçanta të të njëjtit fenomen. Nëse diku ka sekularizim, feja është shndërruar në problem; nëse diku feja është shndërruar në problem, kjo është shenjë sekularizmi. Ndërkaq, në botën islame sekularizmi është kryer më parë prej një procesi që i ka paraprirë sekularizmit, duke e shndërruar, për pasojë, Islamin, në problem. Emri i këtij problemi është kolonializmi. E shprehur ndryshe, në botën islame, edhe sekularizimi, edhe shndërrimi i Islamit në problem në vartësi edhe si pasojë e sekularizmit, janë rezultate të kolonializmit. Përhapja dhe zgjerimi i sekularizmit në botën

islame janë realizuar si një rezultat i natyrshëm i përhapjes dhe zgjerimit të kolonializmit.

Mes kushteve historike të veta, periudha klasike, pavarësisht se është një specifikë që në shikim e parë s'duket me shumë rëndësi - kur krahasohet me kushtet kolonialiste që kanë specifika diferencues e temës sonë, rëndësia del në shesh në mënyrë të dukshme - është fakti se autoriteti politik ka qenë në duart e myslimanëve dhe, se, për rrjedhojë, organizimi shoqëror është realizuar në kushtet e veta autentike. Prandaj, dy specifika, kushtet historike dhe natyra e njeriut kanë qenë, e para, mjeti dhe e dyta, si formë pamore të jashtme të së patës dhe të gjitha çështjet dhe zgjidhjet situatave janë realizuar në të tilla kushte autentike. Në këtë pikë, Islamizmi dhe Kristianizmi, duke u zhveshur nga traditat, e u orientuan për t'u rikujtuar në një mënyrë të pastër dhe, në këtë kuadër, filloi të zhvillohej një qëndrim i ri, siç ishte kuptimi dhe interpretimi përsëpari i teksteve fetare themelore për të cilat diskutoheshin këtë besime.

Në këtë trajtesë kemi të bëjmë me një risi në lidhje me kuptimin dhe interpretimin e teksteve fetare, e cila në mënyrë të tërthortë, shprehet duke i diferencuar fenë me besimtarët. Në ka një gjë që s'vihet në diskutim, ajo është procesi i shndërrimit i fesë në problem dhe i problemeve fetare nga njëri-tjetri.

Gjithashtu, po në këtë temë nuk do të tregohemi të kujdesshëm që të mos bëjmë hapur kritika një për një e metodës përshkruese-analizues që kanë përdorur historiografia botërore. Nga njëra anë, metodat janë të lidhura drejtpërdrejtë me çështjet e tyre, në një kuptim, çështjet e përcaktojnë që më parë edhe mënyrën e trajtimit të tyre. Nga kjo anë, kritika e metodë pa kritikuar

çështjen, do të ishte e padrejtë. Nga ana tjetër, këtu nuk mbetet nevoja për një kritik me kuptim të metodës së trajtuara brenda lidhjes me çështjet e veta, të lidhura me zbatimin e saj në një çështje tjetër të rëndësishme prej saj. Sepse në fund të fundit, kritika është e pranishme brenda përshkrimit të metodës së trajtuara lidhur me veçoritë e çështjes. Sipas opinionit tim, shprehja në mënyrë të mjaftueshme e një ideje e bën të panevojshme një kritikë të veçantë meqë mbartë brenda edhe kritikën e saj, nga këndvështrimi i theksimit të ndryshimeve në një botë që sa vjen e globalizohet më shumë.

Fjalë kyçe: *shndërrim, islamizëm, kristianizëm, histori, tekst fetar, globalizëm.*

Abstract

This study aims to understand and interpret the process of turning religion into a problem. Expressed differently, religious problems in the context of globalization will be the object of historical analysis in terms of their meaning and interpretation. Although this analysis can be done in a separate way of treatment, perhaps as a preparation for such a study, efforts will be made to take over some initiatives previously carried out in this field, the issue is treated from the historical perspective: before and today. At the same time, it is very important to show that terms such as Christianity and Islam, seen from the point of view of their proponents, are used in connection with the process of turning religion into a problem.

The process of turning Christianity into a problem is named by historians and sociologists as the process of secularization, which is described as the removal of temporal (material) religions from their ruling domains to make them independent and humanitarian. Finally, turning religion into a problem and secularization are two separate expressions of the same phenomenon.

If there is secularization anywhere, religion has become a problem; if somewhere religion has become a problem, this is a sign of secularism. Meanwhile, in the Islamic world, secularism was previously carried out by a process that preceded secularism, thus turning Islam into a problem. The name of this problem is colonialism. Expressed differently, in the Islamic world, both secularization and the transformation of Islam into a subordinate problem because of secularism are the results of colonialism. The spread and expansion of secularism in the Islamic world came about as a natural result of the spread and expansion of colonialism.

Among its historical conditions, the classical period, even though it is a specificity that at first

glance does not seem very important - when compared to the colonial conditions that have to differentiate specifics of our subject, the importance comes to the fore clearly - is the fact that political authority has been in the hands of Muslims and that, therefore, social organization has been realized in its authentic terms. Therefore, two specifics, historical conditions and human nature have been, the first, the tool and the second, as an external visual form of being, and all issues and solutions to situations have been realized in such authentic conditions. At this point, Islam, and Christianity, stripping themselves of traditions, were oriented to recall purely and, in this context, a new attitude began to develop, such as the understanding and reinterpretation of the fundamental religious texts. about which these beliefs were discussed.

In this study, we are dealing with an innovation regarding the meaning and interpretation of religious texts, which is indirectly expressed by differentiating religion from believers. There is one thing that cannot be discussed, it is the process of turning religion into a problem and religious problems from each other.

Furthermore, in this study, we will not be careful not to openly criticize one of the descriptive and comparative methods used by world historiography. On the one hand, the methods are directly related to their issues, in a sense, the issues predetermine the way of handling them. From this point of view, criticizing the method without criticizing the issue would be unfair. On the other hand, there is no need for a critic with an understanding of the method treated within the connection with its issues, related to its application in another important issue from it. To sum up, the criticism is present within the description of the treated method related to the particularities of the case. In my opinion, the sufficient expression of an idea makes a separate criticism unnecessary since it also carries its criticism, from the point of view of emphasizing the changes in a world that is becoming more and more globalized.

Keywords: *conversion, Islamism, Christianity, history, religious text, globalism.*

Hyrje

Kur flasim mbi shndërrimin e fesë në problem, kuptimi dhe interpretimi i saj është, në planë të parë çështje teologjisë krishtere. Interesimi i filozofisë dhe sociologjisë për këtë çështje ndoshta është jo esenciale, ndërsa mund të shihet si një situatë aksidenciale. Njëri prej trajtimeve klasike, temën e filozofisë apo të sociologjisë e përcakton si "ekzistencë nga pikë pamja e

qenies"¹. Nga ky aspekt, çdo gjë ekzistence mund të jetë temë e filozofisë.

Si rrjedhojë e faktit që termi "ekzistencë" këtu shihet mjaft ndryshe nga njëri-tjetri prej shkollave filozofike të ndryshe dhe sociologjisë, jo vetëm janë shfaqje qëndrime të ndryshme si *pozitivizmi*, *idealizmi* dhe *racionalizmi*, por, brenda secilës mënyrë qëndrimi, sido që të konceptohen dalin edhe dallime të varura nga nënqëndrimet. Veçanërisht diskutimi që bën filozofia e zhvilluar në Perëndim, në kuadrin e lidhjes me ekzistencën, mbi krishterimin dhe mbi fenë që ajo përfaqëson në Perëndim, "*si një ekzistencë*", është e ngjashme me diskutimin mbi lëndën dhe përgjithësinë, njeriun, historinë, shkencën etj.²

Diskutimi mbi fenë me gjendjen që ka sot, si një ekzistencë nga ky aspekt dhe, bashkë me të, kur në filozofinë perëndimore thuhet "fe"³, bëhet fjalë vetëm për krishterimin superstruktura juridiko-politike dhe ajo ideore-kulturore. Në suazat e superstrukturës ideore-kulturore bëjnë pjesë *format të vetëdijes shoqërore*. Mirëpo në suazat superstrukturës ideore-kulturore bëjnë pjesë edhe format e vetëdijes fetare, ku si karakteristikë dallohet *ndërdija* apo *ndërgjegjja*. Shikuar nga ky këndvështrim, vetëdija paraqet kuptimin subjektiv të realitetit objektiv apo ndryshe, aftësinë orientuese të individit në hapësirë dhe kohë.

"Ndërsa, *vetëvetëdija është kuptim subjektiv i vetvetes apo, procesi i monologimit me personalitetin tonë. Ndërdija është sfera e fshehur e psikikës tonë apo më mirë, instinkti racionalizues i intimit sonë kujdestare*. E sa i përket ndërgjegjes, e cila shpesh herë ngatërrohet me konceptin e vetëdijes, duhet thënë se *ndërgjegjja nënkupton gjykatën tonë të brendshëm moral, respektivisht korrektorin psikologjik të veprimeve tona të gjithëmbarshe në jetë*"⁴.

Në këtë mënyrë, pasi e zgjidh këtë konfuzion të disa termave që kanë kuptime të ngjashme, por asnjëherë të njëjta, mund të fillojmë me shtjellimin e formave të përmendura të vetëdijes shoqërore. Nga të gjitha format e vetëdijes shoqërore që cekëm më lartë, si formë e vjetër konsiderohet *feja* ose *religjioni*⁵.

Ç'është feja në fakt? Si është krijuar ajo? Pse u duhet njerëzve feja? Sa forma ekzistojnë? Çfarë funksione ushtron feja?

Përgjigje adekuatë për të gjitha pyetjet e mësipërme mund t'i japë vetëm *sociologjia e fesë*, e cila është një disiplinë sociologjike e specializuar për hulumtimin dhe shpjegimin e çështjeve më të rëndësishme që lidhen me fenë. Kështu, sa i takon pyetjes se çka është feja, mund të themi se feja paraqet një pikëpamje të dogmatizuar për shpjegimin e botës dhe çdo gjëje që gjendet aty, nëpërmes besimit dhe përkushtimit në Zot.

Është e vërtetë e pakontestueshme se feja, bashkë me disa forma të tjera të vetëdijes shoqërore si arti dhe filozofia, paraqet fenomenin më të vjetër ideor-kulturor që njeh njerëzimit. Mendohet se akoma në periudhën e egërsisë, kur vetëdija e njeriut ka qenë tejet e pazhvilluar, tek ai kishte ekzistuar një formë e besimit primitiv në fuqitë e madhërishme të natyrës. Nga kjo mund të kuptohet se feja si fenomen socio-kulturore, gjithmonë ka qenë ngushtë e lidhur me dy kategori elementare të fesë: *besimin* (bindjen) dhe *ritualet* (ceremonitë)⁶.

"Besimi nënkupton të gjitha idetë dhe bindjet e njerëzve, që kanë të bëjnë me botën dhe fuqitë mbinatyrore. Kurse, ritualet i paraqesin të gjitha ceremonitë dhe veprimtaritë praktike, të cilat ndërmerren nga besimtarët për ta dëshmuar lojalitetin ndaj Zotit"⁷.

Me fjalë të tjera, feja ka me fuqinë mbinatyrore dhe gjerat e shenjta, të cilat duhet ta "argumentojnë" ekzistencën e koordinatorit kozmik të quajtur Zot. Feja si formë e vetëdijes shoqërore, të gjitha gjërat në botë i ndan në profane (të thjeshta) dhe skrale (të shenjta). Ndër kategoritë e shumta të fesë për historicizmin më të rëndësishme janë: parajsa, ferri, mëkati, shpëtimi, ringjallja, shpirti i shenjtë, ungjijtë, dreqërit etj.

Të rilidhësh fenë me një tërësi idesh, një logjikë ose një "paralogjikë", do të thotë t'i kthesh pasardhësit tanë më të largët në intelektualë, sikur të jenë mes nesh, meqë shohim teoritë më të bukura të thyhen përballë pasionit dhe interesit, duke vlejtur vetëm në çastet e përsiatjes, ndërsa në fetë e lashtësisë ishte pezulluar jeta. E vërteta është se feja, duke qenë

¹ Richard Kearney, *Modern Movements in European philosophy*, Edition, 2, Published by University, Manchester: "Manchester University Press", 1986, p. 74.

² Po aty, p. 76.

³ David E. Pailin, *Groundwork of Philosophy of Religion*, London: "Epworth Press", 1986, p. 24.

⁴ Thomas Bottomore, *Sociology: A Guide to Problems and Literature*, London: "Allen & Unwin", 1987, p. 124.

⁵ Ian Robertson, *Sociology*, New York: "Worth Inc", 1981, p. 176.

⁶ Po aty.

⁷ Taletcott Parson, *Sociological Theory and Modern Society*, New York: "The Free Press", pp. 263-264.

bashkudhëtare e species sonë, duhet t'i përmbahet strukturës sonë. Ne e kemi lidhur përvojën thelbësore; por vetë këtë përvojë e paraqesim para se të kemi përmbushur dhe në çdo rast e shpjegojmë shumë mirë para se të kemi patur; mjafton për këtë ta shqyrtojmë njeriun në tërësinë e qenieve të gjalla.

"Ç'ndodh, nëse merren në shqyrtim gjendjet e shpirtit, nëse krahasohen mes tyre këto dy ndjenja: lidhja me atdheun dhe dashuria për njerëzimin? A është e qartë se bashkimi shoqëror i detyrohet kryesisht nevojës që ka një shoqëri për të mbrojtur kundër të tjerëve dhe se e dashurojmë e jetojmë së bashku me një grup njerëzish, mbi të gjitha, për t'u bërë ballë tërë të tjerëve? I tillë është instinkti primitiv, ende i fshehur nën fitoret e qytetërimit; ende sot, ne dashurojmë prindërit dhe bashkëqytetarët tanë drejtpërsëdrejti dhe natyrshëm, ndërsa dashuria për njerëzimin është i tërthortë dhe e fituar. Tek ata ne shikojmë vetveti, te njerëzimi shkojmë tërthorazi; sepse vetëm përmes Zotit dhe tek Zoti, feja e fton njeriun të dashurojë llojin njerëzor, ashtu si vetëm përmes arsyes dhe tek arsyeja, falë së cilës kumtojmë me të gjithë, filozofët na bëjnë të shohim njerëzimin, për të treguar dinjitetin e shquar të individit njerëzor, të drejtën e të gjithëve për respekt"⁸.

Në asnjë rast, nuk arrijmë te njerëzimi përmes etapave, duke përshkruar familje, kombin dhe fenë. Nevojitet që me një shkëputje të shkojmë më larg se ai dha ta mbërrijmë pa e marrë si pikë mbërritjeje, madje ta kapërcejmë. Veç kësaj, nëse flasim gjuhën e fesë apo të filozofisë, nëse bëhet fjalë për dashuri dhe respekt, një moral tjetër, një lloj detyrimi, vjen e mbivendoset ndaj trysnisë së shoqërisë. Deri tani, është bërë fjalë për këtë. Ka ardhur koha të shohim diçka tjetër.

Pra, le të shohim tani, a është shndërruar feja në një problem sot? Unë jam përpjekur që të përvijojë një skicë historike mbi *diferencimin e shndërrimit të fesë në problem dhe i problemeve fetare nga njëri-tjetri: dije dhe sot*. Një skicë historike e ndërtuar për këtë qëllim mund të shërbejë njëkohësisht të analizojmë idetë e ndryshme për besimin fetar, të cilat janë akumuluar gradualisht përreth *doktrinės qendrore të vetëvetëdijes* - d.m.th. doktrina që

vetëdija kontrollohet nga ligjet historike dhe ligjet e evolucionit, zbulimi i të cilave do të pamundësojë të kemi profecinë e besimit fetar të një njeriu.

Ndërdija, të cilën deri tani është karakterizuar vetëm në mënyrë abstrakte, mund të ilustrimet mirë me një nga format e tij më thjeshta dhe më të vjetra, doktrinën e njerëzve të zgjedhur. Kjo doktrinë është një orvatje për ta bërë historinë e kuptueshme nën interpretime teiste (featre), domethënë duke njohur *Zotin* si autorin e dramës që luhet në Skenën Historike⁹. "*Teoria e njerëzve të zgjedhur, më mëvetësisht*, - thekson historiani amerikan Karl Popper, - *nënkupton që Zoti ka zgjedhur një njeri të funksionojë si një vegël e përzgjedhur me vullnetin e Tij dhe kështu ky njeri do të trashëgojë tokën*"¹⁰.

Në këtë doktrinë, ligji i zhvillimit historik është shpalosur nga Vullneti i Zotit. Kjo është eksperiencia specifike që dallon teistët nga format e tjera vetëdijes. Një vetëdije natyrale, për shembull, munda ta trajtojë ligjin e zhvillimit si një ligj të natyrës, një vetëdije shpirtëror do ta trajtonte si një ligj i zhvillimit shpirtëror, një indoktrinim ideologjik, përsëri, si një ligj i zhvillimit të ideologjisë në shoqëri. Historicistët teistë ndajnë me këto forma të tjera doktrinën që janë ligjet historike specifike që mund të zbulohen dhe mbi predikimet e të cilëve mund të bazohet vështrimi mbi të ardhmen e njerëzimit

"Nuk ka dyshim që doktrina e njerëzve të zgjedhur kultivohet nga forma tribale e jetës shoqërore. *Tribalizmi*, domethënë theksimi i skajshëm i rëndësisë të fatit, pa të cilën individ i nuk është asgjë, është një elementë të cilën ne do ta gjejmë në shumë forma të teorisë historiciste. Forma të tjera që nuk mund t'u thuhet tribale, por mund të merret për elementë të kolektivizimit, ato mund të përforcojnë më tej domethënien e disa grupeve ose të kolektivit - për shembull, një klasë - pa të cilën njeriu është asgjë. [...] Një aspekt tjetër i doktrinës së njerëzve të zgjedhur është distanca e madhe (objektivi i saj vihet shumë larg), e cila ofrohet si fundi i historisë. Për këtë arsye ky fund përshkruhet si një përcaktim i përshkallëzuar (me faza), për të na treguar se kemi ende shumë rrugë për të bërë. Dhe nuk është vetëm largësia apo gjatësia e kësaj rruge, por edhe përdredhësja që na çon lart dhe poshtë, majtas dhe djathtas.

⁸ Johann Baptist Metz; Jean-Pierre Jossua, *The Crisis of Religious Language*, New York: Herder and Herder, 1973, pp. 31-32.

⁹ Karl Popper, *The Open Society and Its Enemies*, Volume 1: The Spell of Plato, Published by Routledge, United Kingdom, 1995, p. 30.

¹⁰ *Po aty*, f 31.

Në këtë mënyrë mund të pritët të ndodh çdo lloj ngjarje historike që mund të konceptohet brenda skemës së interpretimit. Asnjë eksperiencë e perceptueshme nuk mund të hedh poshtë atë. Por për ata që besojnë në të, ajo jep sigurisht gjendjen më të fundit të historisë njerëzore"¹¹.

Një vështrim historiko-sociologjik lidhur me interpretimin teistik të vetëvedijes fetare tentohet të jepet në këtë studim shkencor, ku do të mund të tregohet se si diferencimi i shndërrimit të fesë në problem dhe i problemeve fetare nga njëri-tjetri në hapësirën e shekujve nuk do të interpretohet si një sulm ndaj religjionit. Në këtë studim doktrina e njerëzve të zgjedhur shërben vetëm si ilustrim. Vlera e saj mund të shikohet nga fakti se karakteristikat e saj ndahen në dy versione moderne më të rëndësishme të vetëdijes, analiza e të cilave do të formojnë pjesën kryesore të këtij punimi shkencor - *kuptimi dhe interpretimi në mendimin perëndimor* nga njëra anë dhe *shkencat fetare dhe kuptimi i librave të shenjtë* në anën tjetër.

Në dy shekujt e fundit, për njerëzimin feja është shndërruar progresivisht në një *problem* në ndryshim e sipër. Dhe se ata që merren me shqyrtimin e procesit të shndërrimit të fesë në çështje problematike, e shohin këtë të lidhur krahas me ndryshimet shkencore e shoqërore, edhe me njerëzit dhe institucionet që e përfaqësojnë fenë.

Karakterit shoqëror i këtyre dy qëndrimeve e bënë investigimin tonë me interes aktual. Do t'i kthemi atyre në pjesët e mëvonshme të këtij studimi. Secila prej tyre kthehet mbrapa te qëndrimet që trajtojnë shndërrimin e fesë në

problem. Bëhen përpjekje që procesi historike dhe pakësimi i ndikueshmërisë dhe i ndikimit të fesë të shpjegohet si një proces i natyrshëm i lidhur, përgjithësisht, me evolucionin e njerëzimit dhe, kështu feja pranohet si *një fenomen human, një sukses human i cili, me gjithë disa kontribute të rëndësishme që ka, është i varur nga koha*¹², për pasoj, pritët të eliminohet me kalimin e kohës. Prandaj ne do të kemi të bëjmë gjithashtu me këtë filozofi. Duke qenë se në shpjegimet, siç pranohet se përdorimi në Europë, veçanërisht nga Kisha, i bindjeve fetare të njerëzve në një mënyrë që s'përputhet me qëllimet e fesë, është një faktorë me rëndësi në këtë çështje, do të ishte e nevojshme të flisnim edhe për ata që përpiqen, secili më vete, t'i gjejnë justifikime shndërrim të fesë në problem. Meqë çka ndodhur, edhe pse jo në hollësi, në linjat kryesore pranohet se është pikërisht ajo që duhej të ndodhte, detyra e shkencës dhe mendimit, në rastin më të mirë, mbetet ta shpjegojë atë që ka ndodhur, pra, ta bëjmë të kuptueshëm në mënyrë racionale faktin e kryer.

1. Kuptimi dhe interpretimi i shndërrimit të fesë në problem

Më dy shekujt e fundit, feja është shndërruar progresivisht në një *problem* në ndryshim e sipër. Ata që merren me shqyrtimin e procesit të shndërrimit të fesë në çështje problematike, e shohin këtë të lidhur krahas me ndryshimet shkencore e shoqërore, edhe njerëzit dhe institucionet që e përfaqësojnë fenë. Në shek. XIX, këtë specifik filozofi i shquar danez Soren Kirkegaard¹³ e tregon kështu:

¹¹ Henri Bergson, *Les deux sources de la morale et de la religion* (plus loin: *Les deux sources ...*), Edition 3, Publication de l'Université de France, Paris: "Univesitaires de France Press", pp. 169-171.

¹² Johann Baptist Metz; Jean-Pierre Jossua, *Fundamental Theology: The Crisis in the Language of Faith*, Volume 5, Issue 9 of Concilium (Glen Rock, N.J.), New York: "Burns & Oates, 1973, pp. 97.

¹³ Soren Aabye Kirkegaard (1813-1855) ishte një shkrimtar i jashtëzakonshëm i shkolluar, i cili shkroi shumë vepra - pothuajse të gjitha të shkruara në vitet 1840 - të cilat janë të vështira për t'u kategorizuar, duke u shtrirë në filozofi, teologji, shkrim devocione dhe fetar, kritikë letrare, psikologji dhe kritikë sociale. Mënyra e Kirkegaard-it për të filozofuar kundërshton ndërtimin e sistemit dhe i detyrohet më shumë në qasjen e tij antike, veçanërisht heroit të tij Sokrati, megjithatë vepra e tij gjithashtu tërheq fuqishëm dhe krijueshëm nga Bibla dhe burime të tjera krishtere. Kundërshtimi ndaj ndërtimit të sistemit ka bërë që Kirkegaardi shpesh të kuptohet si një kundërshtar i madh i Hegelit, por studimet në dekadat e fundit kanë sfiduar dhe ngatërruar këtë pikëpamje, duke sugjeruar se disa nga idetë kryesore të Kirkegaardit janë zhvillime krijuese të ideve të Hegelit, dhe se objekti kryesor i kritikës së tij janë disa hegelianë danezë të ndikshëm në kohën e tij, jo vetë

Hegeli (shih veçanërisht Stewart 2003 dhe seksioni 4 më poshtë). Gjithashtu, ai shpesh quhet "baba i ekzistencializmit", kjo etiketë fsheh të paktën aq sa zbulon, veçanërisht për ata që lidhin ekzistencializmin me figura ateiste siç është Sartre. Veprat e tij janë: *Koncepti i Ironisë me referencë të vazhdueshme ndaj Sokratit, Ose/ose, Sëmundje deri në vdekje*, etj. Kirkegaardi ishte nën ndikimin e Sokratit, Hegelit, Martensenit, etj. *Koncepti i Ironisë* është poashtu tema e doktoratës së Kirkegardit publikuar me 1841. Në këtë vepër, Kirkegaardi e trajton konceptin e ironisë në të dy rrafshet, teorik dhe atë historik apo praktik. Mendimi i Kirkegaardit pa dyshim ka ndikuar mendimtarët në traditat fenomenologjike dhe ekzistenciale (përfshirë Heideggerin, Sartre, Jaspersin, Marcelin dhe Lévinas), por gjithashtu edhe mendimtarët në tradita filozofike shumë të ndryshme, si Wittgenstein (i cili e përshkroi atë si një "shëncë" dhe "mendimtari më i thellë" i shekullit të nëntëmbëdhjetë). Përveç ndikimit të tij në filozofi dhe teologji - brenda dhe jashtë traditës së tij luterane - mendimi i Kirkegaardit ka ndikuar gjithashtu shkrimtarë dhe poetë të ndryshëm (përfshirë Henrik Ibsenin, Franz Kafkaun, Miguel de Unamuno, August Strindbergun, W. H. Audenin, Walker Percy, John Updikeun, Richard Wright, R. S. Thomas dhe Haven Kimmel); artistë dhe regjisorë filmash (përfshirë Edvard Munchin dhe Carl Theodor Dreyer); psikiatër dhe

"Në një cirk shëtitës, një ditë, para fillimit të shfaqjes, del zjarr. Pronari i cirkut dërgon për ndihmë në fshatin ngjitur *palaçon* i cili, ndërkaq, e kishte përfunduar grimin, kishte veshur rrobat dhe priste i gatshëm të fillonte shfaqja. Në këtë gjendje, palaçoja shkon menjëherë në fshat, i mbledh *fshatarët*, dhe u thotë se 'në cirk ka rënë zjarr', i cili po të mos shuhet menjëherë, ka për ta zënë dhe fshatin. Megjithëse përpiket t'ua shpjegojë sa më seriozisht gjendjen, fshatarët, të ndikuar nga pamja e palaços si dhe duke menduar se ai po përpiket të siguronte shikues, e dëgjojnë me të qeshura dhe zbavitën me të. Meqë e dinte se sa serioze ishte gjendja, palaçoja dëshpërohet gjithnjë e më shumë nga qëndrimi i fshatarëve dhe, duke qarë, përpiket më me ngulëm t'u thotë atyre se 'duhet të shkojnë menjëherë për ndihmë për ta shuar zjarrin, përndryshe, do të nisnin të digjeshin arat me të lashta dhe pastaj i gjithë fshati'. Por sa më shumë dëshpërohej palaçoja, aq më shumë dëfreheshin fshatarët që mendonin s palaçoja po e luante me të vërtetë bukur rolin dhe vazhdojnë ta ndjekin lojën e tij me të qeshura, tallje e kënaqësi të madhe. Ndërkaq, zjarri përfshiu edhe të mbjellat dhe arriti në fshat. Tanimë çdo gjë përpjekje e fshatarëve ishte e kotë. Edhe fshati u dogj bashkë me cirkun!"¹⁴.

Sipas Soren Kierkegaard dhe Harvey Coxit, gjendja ku kishin rënë teologët e krishterë i ngjante gjendjes së palaços së cirkut ku kishte rënë zjarr¹⁵. Ata thonë se, "në këtë ngjashmëri, natyra e *palaçollëkut* e cila u jep kuptim shprehjeve të palaços si palaço, në të njëjtën kohë është e lidhur me historinë: fjalët e tij nuk do të merren seriozisht pa parë se çka bërë palaçoja para se të bëhej palaço, gjë që vlen në mënyrë të ngjashme edhe për teologët e krishterë, edhe për teologjinë krishtere"¹⁶.

Në qëndrimet që trajtojnë shndërrimin e fesë në problem, bëhen përpjekje që procesi historik dhe pakësimi i ndikueshmërisë dhe i ndikimit të fesë

të shpjegohen si një *proces i natyrshëm* i lidhur, përgjithësisht, me evolucionin e njerëzimit dhe, kështu, feja pranohet si një *fenomen human*, një *sukses human i cili, me gjithë disa kontribute të rëndësishme që ka*, është i varur nga koha, për pasojë, pritet të eliminohet me kalimin e kohës.

Në shpjegimet, siç pranohet se përdorimi në Europë, veçanërisht nga Kisha, i bindjeve fetare të njerëzve në një mënyrë që s'përpulthet me qëllimet e fesë, është një faktor me rëndësi në këtë çështje, ashtu dhe theksohet veçanërisht fakti që kundërshtimet ndaj kësaj, të cilat, duke përfutur dinamikën e veta, kanë gjetur mbështetje politike dhe, më pas, janë shndërruar në një politikë të plotë, e kanë shndërruar krishterimin të pranuar si fe absolute¹⁷, për rrjedhojë, edhe fenë, në problem. Në këto shpjegime, kohë më kohë duhen edhe pretendimet se feja e cila, në të vërtetë, ka dalë nga brazda e saj, është kthyer në origjinën e vet. Ata që përpulen ta shpjegojnë këtë çështje, pavarësisht nga shpjegimet *shkencore e historike* ose zellit për të kuptuar gjithë çka ndodhur, në fund të fundit, përpulen, secili më vete, *t'i gjejnë justifikimet* shndërrimit të fesë në problem.

Meqenëse çka ndodhur, dhe pse jo në hollësi, në linjat kryesore pranohet se është pikërisht ajo që duhej të ndodhte, detyra e shkencës dhe mendimit, në rastin më të mirë, mbetet ta shpjegojë atë që ka ndodhur, pra, ta bëjë të kuptueshëm në mënyrë *racionale* faktin e kryer.

2. Shndërrimi i fesë në problem dhe sekularizimi

Çfarëdo drejtimi që të kenë shpjegimet, sikurse u tha më lartë, si një vërtetë jashtë çdo diskutimi, sot feja është shndërruar në një problem. Pasi të diferencohen dhe të veçohen problemet fetare nga shndërrimi i fesë në problem, bëhet e mundur që të pyetjet më hapur se *ç'është shndërrimi i fesë në problem?* Sot, veçanërisht kur bëhet fjalë për botën islame, nuk janë, tashmë vetëm problemet fetare që bisedohen, ndoshta më shumë është feja si një problem.

Të thuash se sot feja është shndërruar në problem, do të thotë të pohosh se më parë nuk ka

psikoterapeutë (përfshirë Ludwig Binswanger, Carl Rogers, Rollo May, R. D. Laing dhe Irvin Yalom). Një arsye pse Kierkegaardi ka pasur një ndikim në një diversitet të tillë figurash është fokusi i tij në pyetjen se çfarë do të thotë të jesh një qenie ekzistuese dhe e kufizuar, një shqetësim që ai e lidh me "brendën", dhe që kontraston me idenë e gabuar se mund të kuptohet realiteti në një mënyrë të paangazhuar dhe nga asnjë pikëpamje e veçantë. Ai besonte se epoka e tij në mënyrë të ndryshme kishte harruar këtë të vërtetë themelore, një dështim i madh që shfaqet në filozofinë dhe teologjinë e saj. [Marrë nga: "Soren Aabye Kierkegaard", in: *Wikipedia: Enciklopedia e lirë*, faqja kryesore. Material i

publikuar në uebfaqe: https://sq.wikipedia.org/wiki/S%C3%B8ren_Kierkegaard (accessed 15.06.2023)].

¹⁴ H. Bergson, *Les deux sources ...*, pp. 216-217.

¹⁵ Harvey Cox, *The Secular City*, New York, 1965, p. 34.

¹⁶ Fernand Braudel, *A History of Civilizations*, New York: "Penguin Books", 1995, pp. 308.

¹⁷ Gerhard Ebeling, "Die Bedeutung der historisch-kritischen Methode für die protestantische Theologie und Kirche" (më tej: "Die Bedeutung der historisch-kritischen ..."), në: *Wort and Glaube*, Tübingen, 1960, pp. 1-49.

qenë problem si dhe të bën të mendosh se sot, më shumë se kurrë janë shfaqur konfliktet fetare, ballafaqohemi me një problem të ri. Në të vërtetë, feja në kuptimin e saj absolut, gjer në një shekull më parë të paktën në botën islame, nuk ishte problem, ndërkaq që s'duhet kuptuar se Islami nuk duket si problem. Qysh në krye të herës, në sy të jomyslimanëve, Islami ka qenë dhe ka vazhduar të jetë problem dhe kjo nuk është specifike vetëm për jomyslimanët¹⁸. Edhe për myslimanët, fetë e tjera kanë përbërë problem dhe ende vazhdon t'i shohë. Por të mos harrojmë se çdo fe pretendon se është absolute si domosdoshmëri, kjo, e përmbajtjes së saj, na duhet të themi se kjo tendencë është e ndryshme. Ndërkaq, shndërrimi i fesë në problem si fe dhe shndërrimi i krishterimit ose hebraizmit si fe në problem nuk janë e njëjta gjë. Bashkë me kumtimin e Islamit, në sytë e besimtarëve myslimanë krishterimi u pa si problem. Po kështu, në shfaqjen e krishterimit, hebraizmi u kthye në problem. Nga ana tjetër, herbariumi, edhe krishterimi, edhe islamizmi i sheh në mënyrë të natyrshme si problem. Në mënyrë të njëjtë, Islami është për të krishterët një problem. Pra, po të shqyrtohen fetë një nga një, në mënyrë të natyrshme, fetë e tjera shfaqen si problem dhe, në këtë kuadër, çdo fe ka një shpjegim të vetin për fetë e tjera.

"Faktin që fetë e shohin ose e sjellin njëra-tjetrën si problem, në të njëjtën kohë nxjerr në pah një pyetje lidhur me të vërtetën e feve nga këndvështrimi filozofik ose lidhur me fenë e vërtetë. Kohët e fundit, shumëllojshmëria e feve, si një problem historiko-filozofik, është bërë një shumë e çështje me të cilën po merren shumë historianë e filozofë të fesë. Vetëm se kjo nuk është një çështje e re, por që e ka zanafillën në data shumë të hershme të historisë"¹⁹.

Ndërkaq, shndërrimi i fesë në problem në ditët e sotme shpreh diçka krejt të veçantë. Ndërsa, nga njëra anë, feja duket në mënyrë absolute si një problem, nga na tjetër, çdo fe veç e veç, e individualizuar në vartësi të veçorive të veta dhe të pozitës së anëtarëve të saj, duket si problem. *Shndërrimi i fesë në problem nuk do të thotë se ajo fe, duke u zgjeruar dhe përhapur, i sjell të tjerat në gjendje problematike, përkundrazi, do të thotë se*

një botëkuptim i caktuar jashtë fetar (jo fetar), duke u bërë ndikues, i prish marrëdhëniet mes feve dhe anëtarëve të tyre.

"Shprehja '*një botëkuptim i caktuar jashtë fetar*', sikurse u tha, nuk kërkon që ky botëkuptim të jetë jashtë fetarë në vetvete. Një botëkuptim i cili është fetar për anëtarët e një feje, mund të dalë krejtësisht si një fenomen jo fetar para atyre që s'janë anëtarë të asaj feje, dhe ky fenomen mund të nxjerrë në shesh disa shqetësime parimore mes anëtarëve të kësaj feje dhe fesë së tyre. Një nga shembujt më të qartë të kësaj e përbën fakti që aq sa çka lidhje mes mosbesimit të shfaqur në Francë në shek. XVI dhe kulturës islame, shumë specifika që janë për myslimanët sot fetare, në sytë e krishterëve ose atyre që kanë përvetësuar ne ose pa dashje këndvështrimin e krishterë, kuptohet si një fenomen ekonomik, politik ose tjetër²⁰. Nga kjo pikëpamje, duhet që shprehjen '*jashtë fetare (jo fetare*' ta saktësojmë duke i shtuar '*me formën që konceptohet mes palëve*'. Në këtë kuptim mund të flitet sot parimisht mbi shndërrimin e fesë më problem. Dhe shndërrimi në këtë kuptim i fesë në problem, siç është tjetër gjë për krishterimin dhe për herbartizmin dhe islamizmin është krejt tjetër gjë"²¹.

Por pavarësisht nga gjithçka, po të shihet pak me kujdes *procesi i shndërrimit të fesë në problem*, do të kuptohet se është formuluar mbi krishterimin duke marrë parasysh një proces të realizuar brenda historisë së qytetërimit perëndimor. Në kundërshtim me këtë, shndërrimi i herbartizmit në problem (ose e kundërta, në mënyrë të dallueshme, rritja e ndikueshmërisë së hebraizmit) sipas vështrimit të anëtarëve të vet është realizuar në një mënyrë të ndryshe nga krishterimi. Në këtë çështje jo vetëm ndikimi i rëndësishëm i faktit që procesi historik dhe kushtet e jetesës së hebraizmit dhe hebrenjve kanë qenë në mënyrë të hapur tejet të ndryshme nga krishterimi dhe krishterët, por edhe nga fakti që hebraizmi si fe është i ndryshëm nga krishterimi, ka ushtruar në këtë një ndikim përcaktues. Kurse procesi i shndërrimit Islamit në problem në këtë kuptim nuk i përngjet as

¹⁸ James Carrier, *Occidentalism: Images of the West*, Published by University Oxford, New York: "Oxford University Press", 1995, p. 16.

¹⁹ Adnan Aslan, *Religious, Pluralism in Christianity and Islamic Philosophy: The Thought of John Hick and Seyyed Hossein in Nasar*, London: "Curson Press", 1988, pp. 61-61

²⁰ Vështruesit e hasura për njohjen zyrtare të myslimanëve të Europës Perëndimore si bashkësi fetare megjithëse atje jetojnë miliona myslimanë, si parim duket të lidhura me këtë [Shënim i autorit].

²¹ Brian Davides, *Philosophy of Religion: A Guide to the Subject*, Published by University Georgetown, Washington: "Georgetown University Press", 1998, pp. 114-116.

krishterimit, as hebraizmit. Ky proces është realizuar në një mënyrë krejt të ndryshme. Në vija të trasha, procesi i realizuar në Perëndim, në fillim ka sjell në gjendje problematike krishterimin, pastaj, në këtë kuadër, edhe të gjitha feve të tjera, veçanërisht Islamit²².

Procesi i shndërrimit të kristianizmit në problem emërtohet nga historianët dhe sociologët si *proces i sekularizimit* ose laicizmit. Ky proces përshkruhet si heqja e fesë *temporale* (materiale) nga fushat e veta sunduese për t'i bërë ato të *pavarura* dhe *humanitare*²³. Nga shumë studiues është theksuar kohët e fundit, veçanërisht në Perëndim, është arritur fund të këtij procesi dhe, duke marrë zhvillim teza e rikthimit të shenjtërisë, janë përjetuar, në këtë çështje, ndërrime shoqërore të rëndësishme. Ndonëse sekularizimi dhe laicizmi janë të lidhura ngushtë, ekzistojnë dallime të vërteta, sepse ato nuk ofrojnë domosdoshmërisht të njëjtën përgjigje ndaj çështjes së rolit të fesë në shoqëri. Laicizmi është një sistem apo ideologji e bazuar në parimin që duhet të ketë një sferë të njohurive, vlerave dhe veprimit që është e pavarur nga autoriteti fetar, por nuk përjashton domosdoshmërisht fenë që të ketë ndonjë rol në çështjet politike dhe shoqërore.

"Gjatë procesit të sekularizimit, institucionet në të gjithë shoqërinë - ekonomike, politike dhe sociale - hiqen nga kontrolli i fesë. Herë pas here, ky kontroll i ushtruar nga feja mund të kishte qenë i drejtpërdrejtë, me autoritetet kishtarë që gjithashtu kishin autoritet mbi funksionimin e këtyre institucioneve - për shembull, kur priftërinjtë janë përgjegjës për sistemin e vetëm shkollor të kombit. Herë të tjera, kontrolli mund të ketë qenë i tërthortë, me parimet fetare që përbëjnë bazën për mënyrën se si funksionojnë gjërat, siç është kur feja përdoret për të përcaktuar shtetësinë. Cilado qoftë rasti, këto institucione thjesht hiqen nga autoritetet fetare dhe u dorëzohen udhëheqësve politikë, ose krijohen alternativa konkurruese përkrah institucioneve fetare. Pavarësia e këtyre institucioneve, nga ana tjetër, lejon që individët të jenë më të pavarur nga autoritetet kishtarë - nuk u kërkohet t'u nënshtrohen udhëheqësve fetarë jashtë kufijve të një kishe ose tempulli. Një pasojë praktike e sekularizimit është ndarja e

kishës dhe shtetit - në fakt, të dy janë aq të lidhura ngushtë saqë ato janë pothuajse të këmbyeshme në praktikë, kur njerëzit shpesh përdorin shprehjen 'ndarjen e kishës dhe shtetit' më tepër kur ato nënkuptojnë sekularizimin. Megjithatë, ekziston një ndryshim midis dy, sepse sekularizimi është një proces që ndodh në të gjithë shoqërinë, ndërkohë që ndarja e kishës dhe shtetit është thjesht një përshkrim i asaj që ndodh në sferën politike. Ajo që ndarja e kishës dhe e shtetit nënkupton në procesin e sekularizimit është se institucionet specifike politike - ato që lidhen me nivele të ndryshme të qeverisjes dhe administratës publike - hiqen nga kontrolli i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i fesë. Kjo nuk do të thotë se organizatat fetare nuk mund të kenë asgjë për të thënë për çështjet publike dhe politike, por kjo do të thotë që ato pikëpamje nuk mund të imponohen ndaj publikut dhe as nuk mund të përdoren si bazë e vetme për politikën publike. Qeveria, në fakt, duhet të jetë sa më neutralë sa i përket besimeve fetare të kundërta dhe të papërshtatshme, as të pengojë as të përparojë asnjë prej tyre"²⁴.

Trajtimi historik i këtij procesi do të na largojë ne nga tema si rrjedhojë e numrit të madh të punimeve dhe e faktit që, megjithëse çështja mund të trajtohet filozofikisht, është shqyrtuar më shumë nga ana e sociologëve të fesë. Ndërkaq, fakti që teza e sekularizimit, edhe temën, edhe arsyetimet i ka marrë nga historia e qytetërimit perëndimor, është e qartë në mënyrë të padiskutueshme.

Në botën islame, procesi i shndërrimit të Islamit në problem nuk është, si në Perëndim - sekularizim - por kjo s'do të thotë se në botën islame nuk ka sekularizim. Fundja, shndërrimi i fesë në problem dhe sekularizimi janë dy shprehje të veçanta të të njëjtit fenomen.

"Nëse diku ka sekularizim, feja është shndërruar në problem; nëse diku feja është shndërruar në problem, kjo është shenjë sekularizimi. Ndërkaq, në botën islame, sekularizimik është kryer më parë prej një procesi tjetër që i ka paraprirë sekularizimit, duke e shndërruar, për pasojë, Islamin, në problem. Emri i këtij

²² G. Ebeling, "Die Bedeutung der historisch-kritischen ...", pp. 1-49.

²³ Harvey Cox, *The Secular City*, New York, 1965, p. 34.

²⁴ Austin Cline, "Sekularizmi kundër sekularizmit: Cili është ndryshimi?", në: *Eferrit*, faqja kryesore. Material i publikuar në uebfaqe: <https://sq.eferrit.com/sekularizmi-kunder-sekularizmit-cili-eshte-ndryshimi/> (i aksesuar 21.06.2013).

procesi është *kolonializëm*. E shprehur ndryshe, në botën islame, edhe sekularizimi, edhe shndërrimi i Islamit në problem në varësi dhe si pasojë e sekularizimit, janë rezultate të kolonializmit. Në procesin e filluar në botën islame, duke e parë Islamin si pengesë më e madhe dhe e mbështetur përballë realizimit dhe vazhdimit të kolonializmit, u shndërrua në problem se pari në sy të kolonialistëve, pastaj, në ballafaqim me këtë pikëpamje, në botën islame që e kishte konsumuar qenien e vet politike, në sy të administratave koloniale ose në sy të atyre që e patën marrë në dorëzim administrimin nga kolonialistët²⁵.

Për shkak se shndërrimi i Islamit në problem u realizua përmes një procesi të tillë, myslimanët u përballën, në këto kushte, me vështirësi të buruara nga feja, por nga gjendja ku ranë. Një ndër figurat më të shquara të historiografisë moderne të shek. XX, Fernand Braudel²⁶ e lidhte rënien e myslimanëve jo me fenë ose gabimet në botëkuptimin e tyre fetar, por me dobësimin me kohë të anës ndjesore të fesë²⁷. Ky shpjegim, ndërsa e sheh gjendjen ku kanë rënë myslimanët si një proces i natyrshëm, këtë proces të natyrshëm e trajton nga një perspektivë e gjerë që e supozon të mundur sa dobësim me kohë të anës ndjesore të lidhjes ë drejtpërdrejtë mes fesë dhe besimit fetar, aq dhe rifuqizimin e kësaj. Në këtë pikë, specifika e treguar si esenciale prej saj është se Islami dhe krishterimi janë fe krejt të ndryshme nga njëra-tjetra dhe se, për rrjedhojë, nuk është e drejtë që vështirësitë e shfaqura në lidhje me njërën fe të konsiderohet e vlefshme edhe për tjetrën.

Gjithashtu, pa ju larguar tematikës tonë, bëhen përpjekje për t'u dhënë përgjigje debateve mbi praninë apo të një afrimi ose mospërshtatje mes qytetërimit dhe Islamit duke iu referuar dallimeve esenciale mes Islamit dhe krishterimit, në të njëjtën kohë bëheshin përpjekje që një pyetje e bërë nga këndvështrimi i kolonizatorëve, të interpretohej në të kundërt për ta sjellë në të favorshme. Vetë kjo formë qëndrimi që i ndanë nga njëri-tjetri Islamin me myslimanët, s'quhet se

është bërë suksesshëm me tërë kuptimin e fjalës, madje ky qëndrim, duke u bërë përgjegjës për gjendjen e rënë brenda traditës klasike një hap më tej, është orientuar për ta mbyllur këtë llogari dhe, duke formuar një *vështrim të ri*, për të shpëtuar nga barra e traditës. Ndërkaq, të gjitha këto përpjekje jo vetëm nuk ia arritën qëllimit, por problemet e jetuara nga krishterët duke i bërë të vetat kushtet kolonialiste në të cilat jetohej, u sollën në gjendje efektive për myslimanët ndoshta më shumë se ç'i kishin jetuar krishterët.

Sot myslimanët e ndjen veten të detyruar t'u gjejnë zgjidhje jo vetëm çështjeve që burojnë nga besimi dhe aktet e veta, por dhe përtej kësaj, çështjeve për të cilat është shkaktar krishterimi. Si shtojcë e kësaj, meqë edhe problemet që ka nxjerrë në shesh modernizimi, kanë arritur te myslimanët duke i bërë më serioze e të rrezikshme. Më shumë se virtytet, janë banalitetet dhe perverstet e modernizimit që i bartin problemet me të cilat përballen myslimanët, në përmasa të papërballueshme. Përpjekjet e tyre për t'u gjetur përgjigje këtyre çështjeve, jo vetëm na dalin para në fusha të shumëllojshme, por edhe kur bëhet fjalë për kuptimin dhe interpretimin objektiv të shndërrimit të fesë në problem.

Konkluzione

Procesi i shndërrimit të fesë në problem shprehet në Perëndim si *sekularizim* ose *laicism*. Meqë ky proces është, në parim, proces i shikimit të njeriut final, në të njëjtën kohë cilësohet edhe si humanizëm. Prandaj, procesi i shndërrimit të fesë në problem cilësohet edhe si humanizëm. Prandaj, procesi i shndërrimit të fesë mund të shihet si "*një rezultat i si rezultat i humanizmit*"²⁸. Ndryshe nga kjo, duhet thënë se "bota islame s'ka përjetuar as ndonjëherë sekularizmin, as ndonjë humanizim të buruar nga dinamikat e saj të brendshme, domethënë, nga problemet e nxjerra nga feja, hyri brenda një procesi të pajetuar për realitetin evropian, brenda procesit të kolonializmit"²⁹. Edhe në proceset e kolonializmit, si parim duket si një proces politik dhe ekonomik, si përfundim, nxori edhe një

²⁵ Po aty.

²⁶ Fernand Braudel (1902-1985) ishte një historian francez dhe udhëheqës i shkollës "Annales". Studimet e tij u fokusuan në tre projekte kryesore: *Mesdheu* (1923-1949, pastaj 1949-1966), *Qytetërimi dhe Kapitalizmi* (1955-1979) dhe *Identiteti i papërfunduar i Francës* (1970-1985). Ai ishte anëtar i Shkollës "Annales" të historiografisë franceze dhe historisë sociale në vitet 1950 dhe 1960. Ai ishte një student i Henri Hauser. Braudel theksoi rolin e faktorëve socio-ekonomikë në shkallë të gjerë në krijimin dhe shkrimin e historisë. Ai gjithashtu mund të konsiderohet si një nga pararendësit e

teorisë së sistemeve botërore [Marrë nga: "Fernand Braudel", in: *Wikipedia: The Free Encyclopedia*, faqja kryesore. Material i publikuar në uebfaqe: https://en.wikipedia.org/wiki/Fernand_Braudel (accessed 18.07.2023)].

²⁷ Fernand Braudel, *Grammaire des Civilisations*, Paris: "Flammarion", 1987, p. 299.

²⁸ Rudolf Bultmann, "Humanismus und Christentum", in: *Glaube und Verstehen*, Vol. II, Tübingen, 1993, p. 135.

²⁹ Hugh Ross, *Types of Modern Theology*, London: "Collins", 1964, p. 146.

transformim kulturor. Krahas përhapjes së modeleve dhe mënyrës perëndimore të jetesës, veçanërisht të shprehive të konsumit, transformimi kulturor nxori në shesh, në mos si bindje fetare, si fakt praktik, një distancë midis fesë dhe jetës, distancë e cila flet për mundësinë që në mos këtë çast, në të ardhmen feja të duket problem në sytë e vetë anëtarëve të saj.

Njëra prej rezultateve më të rëndësime të procesit të kolonizimit është se, si reaksion ndaj administratave kolonialiste që e kanë pranuar Islamin si një temë politike, ka sjell në rend të ditës edhe Islamin një mënyrë shikimi politike në kuptimin e tij. Si rezultat i kësaj, në botën islame, Islami është shndërruar në problem jo fetar, por politik. Përtej kësaj, në botën islame ekziston një situatë si ballafaqimi i një mënyre shikimi që e kupton çdo gjë fetare si politike, me reaksione në përputhje me natyrën e saj, domethënë, pamundësia e fesë për ta shprehur veten pa u politizuar.

Termat "*Islami politik*" ose "*politizimi i Islamit*", ndërsa nga njëra anë janë shprehje ku pohohet kjo mënyrë shikimi, nagant tjetër, shprehin edhe një situatë paradoksale që e vlen mjaft të shihet me vëmendje, sipas së cilës, ata që dëshirojnë ta jetojnë fenë ose të jetojnë sipas saj, përvetësojnë vështrimin e të tjerëve mbi ta dhe, në një kuptim, pa i rënë në të, vetadaptohet sipas tyre.

Megjithëse shndërrimi i fesë në problem, po ta themi më thjesht, nuk është e njëjta gjë si për krishterimin, si për Islamin, sot, qoftë edhe në kuptime të ndryshme, krishterimi dhe Islami kanë ardhur dhe janë sjellë në gjendje problematike. Është një specifikë e palidhur drejtpërdrejtë me këtë që këto çështje nuk burojnë nga vetë këtë dy fe. Këto janë çështje me të cilat përballen jo ata që e sjellin fenë në gjendje problematike, por ata që kërkojnë ta jetojnë fenë. Edhe nëse këto çështje, në periudha të ndryshme historike shfaqin ndryshime, në esencë janë të njëjta dhe çështje që mund të shfaqen gjithmonë mesë fesë dhe fetarizmit.

Edhe në këtë pikë ka disa ndryshime parimore që burojnë nga entiteti i feve përkatëse. Kur është fjala për krishterimin, meqë feja mbështet mbi një *person* dhe *ngjarje* dhe mbi një *interpretim* të kësaj ngjarje, interpretimi është një element esencial i fesë, afetarizmi dhe interpretimi janë emërtime të ndryshme të një gjëje të vetme dhe identike.

Në ndryshim nga kjo që thamë më lartë, meqë Islami mbështet mbi një komunikim dhe mbi deklarin dhe kumtimin e tij nga ana e njeriut, dija dhe kuptimi i mbështetur mbi dijen si dhe një konfirmim i mbështetur mbi kuptimin përbëjnë bazën e afetarizmit. Në kundërshtim me këtë, interpretimi, megjithëse përdoret herë pas here, nuk është një element esencial, por aksidental.

Për rrjedhojë përmes përpjekjeve për të ditur dhe kuptuar dhe, në përfundim të kësaj, në kuadrin e konformimit. Nga ana e këtyre çështjeve buron më shumë nga ndryshimi në mjediset dhe kushtet mes të cilave konformimi mbetet i detyruar të realizohet meqë feja (baza e fesë) si *deklaratë* dhe *kumtim*, mbetet gjithmonë po ajo. Një tjetër element që është, këtu, vazhdimisht burim problemi, janë veçoritë që bart brenda vetes njeriu, subjekti i konformimit. Këto veçori janë, ndoshta, burim i vazhdueshëm problemi si kushte të brendshme dhe parakushte të konformimit, Në të njëjtën kohë mendojmë edhe për faktin që feja zë vend në jetën e njeriut si konfirmim, edhe për bazën ekzistenciale të fesë.

Bibliografia

- ASLAN, Adnan - *Religious, Pluralism in Christianity and Islamic Philosophy: The Thought of John Hick and Seyyed Hossein in Nasar*, London: "Curson Press", 1988.
- BERGSON, Henri - *Les deux sources de la morale et de la religion*, Edition 3, Publication de l'Université de France, Paris: "Press Univesitaires de France", 2020.
- BOTTOMORE, Thomas - *Sociology: A Guide to Problems and Literature*, London: "Allen & Unvin", 1987.
- BRAUDEL, Fernand - *A History of Civilizations*, New York: "Penguin Books", 1995.
- BRAUDEL, Fernand - *Grammaire des civilisations*, Paris: "Flammarion", 1987.
- BULTMANN, Rudolf - "Humanismus und Christentum", in: *Glaubb und Verstehen*, Vol. II, Tübingen, 1993.
- CARRIER, James - *Occidentalism: Images of the West*, Published by University Oxford, New York: "Oxford University Press", 1995.
- CLINE, Austin - "Sekularizmi kundër sekularizmit: Cili është ndryshimi?", në: *Eferrit*, faqja kryesore. Material i publikuar në uebfaqe: <https://sq.eferrit.com/sekularizmi-kunder-sekularizmit-cili-eshte-ndryshimi/> (i aksesuar 21.07.2013).
- COX, Harvey - *The Secular City*, New York, 1965.
- DAVIDES, Brian - *Philosophy of Religion: A Guide to the Subject*, Published by University Georgetown, Washington: "Georgetown University Press", 1998.
- EBELING, Gerhard - "Die Bedeutung der historisch-kritischen Methode für die

- protestanische Theologie und Kirche", in: *Wort and Glaube*, Tübingen, 1960.
- KEARNEY, Richard - *Modern Movements in European philosophy*, Edition, 2, Published by University, Manchester: "Manchester University Press", 1986.
 - METZ, Johann Baptist; JOSSUA, Jean-Pierre - *Fundamental Theology: The Crisis in the Language of Faith*, Volume 5, Issue 9 of Concilium (Glen Rock, N.J.), New York: "Burns & Oates, 1973.
 - Metz, Johann Baptist; Jossua, Jean-Pierre - *The Crisis of Religious Language*, New York: "Herder and Herder, 1973.
 - PAILIN, David E. - *Groundwork of Philosophy of Religion*, London: "Epworth Press", 1986.
 - PARSON, Taletcott - *Sociological Theory and Modern Society*, New York: "The Free Press", 1967.
 - POPPER, Karl - *The Open Society and Its Enemies*, Volume 1: The Spell of Plato, Published by Routledge, United Kingdom, 1995.
 - ROBERTSON, Ian - *Sociology*, New York: "Worth Inc", 1981.
 - ROSS, Hugh - *Types of Modern Theology*, London: "Collins", 1964.
 - "Fernand Braudel", in: *Wikipedia: The Free Encyclopedia*, The main page. Material published on the website: https://en.wikipedia.org/wiki/Fernand_Braudel (accessed 18.06.2023).
 - "Soren Aabye Kierkegaard", in: *Wikipedia: The Free Encyclopaedia*, The main page. Material published on the website: https://simple.wikipedia.org/wiki/S%C3%B8ren_Kierkegaard (accessed 15.06.2023).

Të drejtat e njeriut në internet

Dr. Loreta Tozaj

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
loreta.alushi@yahoo.it

Dr. Eriola Cakrani

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
eriol_hoxha@yahoo.it

Abstrakt

Zhvillimi i internetit dhe përdorimi i vazhdueshëm i teknologjisë kanë prodhuar shoqërinë e sotme, që njihet si "shoqëria e informacionit", dhe ekonominë që është përcaktuar si "ekonomia e njohurive", transformime epokale, të cilat kanë çuar në zhvillimin e një "ekosistemi të vërtetë digjital". Edhe pse teknologjia ka mundësuar rritje të paprecedent ekonomike, rritjen e aksesit në informacion, dhe ka realizuar zgjidhje të reja për

sfidat historike, zgjerimi i internetit ka sjellë sfida dhe dobësi. Në vitet e fundit, ëshë fituar bindja se e drejta nuk mund të shmanget ose t'i largohet kohëve që ndryshojnë, por, përkundrazi, duhet të shfrytëzojë zhvillimet teknologjike për t'iu përshtatur nevojave të reja të mbrojtjes së degëve të së drejtës dhe të të ashtuquajturave "të drejta të reja".

Fjalë kyçe: të drejtat e njeriut, internet, të drejtat digjitale, shoqëria e informacionit, etj.

Abstract

The development of the Internet and the continued use of technology have produced today's society, that is known as the "information society", and the economy that is defined as the "knowledge economy", epochal transformations, which have led to the development of a "true digital ecosystem". Although technology has enabled unprecedented economic growth, increased access to information, and realized new solutions to historical challenges, the expansion of the Internet has brought challenges and vulnerabilities. Recently we have gained the conviction that the legislation cannot avoid the development of technology and, on the other hand, the law use technological developments to adapt to the new needs of the protection of branches of law and the so-called "new and emerging human rights".

Keywords: human rights, internet, digital rights, information society, etc.

Hyrje

Prej vitesh jemi dëshmitarë të një procesi të thellë transformimi për shkak të zhvillimit të teknologjive të reja të informacionit, që nga një anë kanë revolucionarizuar në mënyrë pozitive shumë sektorë të shoqërisë sonë, duke përmirësuar gati të gjitha aktivitetet, dhe në anën tjetër kanë amplifikuar konfliktin, midis tyre dhe të drejtave të njeriut. Teknologjia duket e vendosur të ndryshojë gjithnjë e më shumë rregullat institucionale të njohura dhe vetë proceset demokratike janë të ndikuara thellësisht nga mënyra në të cilën qarkullojnë informacionet¹.

Para mundësive të mëdha dhe ende të panjohura që teknologjitë e reja paraqesin para syve tanë, ka edhe rreziqe që lidhen me zhvillimin jashtë kontrollit, për shkak të vështirësisë së hartimit të politikave dhe legjislacionit për ta mbajtur nën kontroll².

Çështja është se globalizmi dhe epoka teknologjike sigurojnë një bazë të re pjellore për

¹ Rodota S, Tecnologia e diritti, Bologna, Il Mulino, 1995.

² Frosini T. E., Tecnologie e libertà costituzionali, Milano, Comandè G. e Ponzalli G. (a cura di) in Scienza e diritto

të patur një qasje të re në lidhje me lindjen e të drejtave të reja. Në të njëjtën linjë mendimi, mund të argumentojmë shfaqjen e të drejtave të reja digjitale nga koncepte tradicionale të tilla si privatësia e cila ndodhet nën trysinë dhe rrezikun e mjeteve të reja të epokës teknologjike, duke sjellë lindjen e një të drejte të re siç është e drejta për t'u harruar.

Shoqëria dhe teknologjia kanë ndikuar njëra-tjetrën dhe kanë gjeneruar një proces transformimi që ka vazhduar më tej në sferën publike, të ndërveprimit, demokracisë dhe marrëdhënieve të qytetarëve me institucionet, në të tillë mënyrë që në ditët e sotme mund të flasim për një status të ri, që në këtë kontekst është shtetësia digjitale. Në këtë kuptim, analiza e ndikimit të internetit dhe teknologjive të informacionit në të drejtat e njeriut nuk mund të kufizohet vetëm në zbulimin e sfidave të reja apo të ndonjë mangësie për mbrojtjen e tyre në raport me progresin e vazhdueshëm teknologjik. Për këtë arsye, ky artikull kërkon të bëjë një hap më tej, i cili do të përpikët të verifikojë mënyrën e reagimit të modelit tradicional të të drejtave të njeriut, të parashikuar në dokumente ndërkombëtare dhe kombëtare, në lidhje me një fenomen thelbësisht postmodern të tillë si përhapja e internetit. Gjithashtu është e nevojshme të bëhet një analizë e të drejtave të reja të njeriut për të forcuar mbrojtjen e tyre në dritën e ndryshimeve të shoqërisë, progresit social dhe zhvillimeve shkencore dhe teknologjike.

Gjenerata e të drejtave të reja të njeriut

Në 200 vitet e fundit, të drejtat e njeriut janë shndërruar nga një koncept perëndimor i të drejtës civile dhe politike, në sistemin e vetëm të njohur universalisht të kohës sonë. Ideja themelore e të drejtave të njeriut është se çdo person zotëron dinjitet, për vetë faktin se ai ose ajo është një qenie njerëzore. Koncepti i të drejtave të njeriut qëndron mbi një sistem vlerash universale të përbashkëta nga të gjithë popujt çka janë të ndërlidhura, të ndërvarura dhe të pandashme³.

Të drejtat e njeriut kanë një logjikë të tyre krijimi. Fillimisht ato kanë lindur në dokumenta kushtetuese kombëtare dhe më pas janë bërë

pjesë e normave ndërkombëtare, duke rregulluar marrëdhëniet midis shtetit dhe individëve nën juridiksionin e shtetit përkatës, sesa marrëdhëniet midis shteteve⁴.

Nga një përmendje e shkurtër e historisë së të drejtave të njeriut është e qartë se përmbajtja e këtyre të drejtave ka evoluar me kalimin e kohës dhe mund të mendojmë se ky zhvillim do të vazhdojë. Të drejtat e njeriut nuk janë kategori dhe koncepte statike, por ndryshojnë me ndryshimin e kushteve historike, politike ekonomike dhe shoqërore. Kuptimi i të drejtave dhe lirive ka përballur disa herë edhe përpjekjen për të hierarkizuar të drejtat dhe liritë themelore, nisur nga kritere të ndryshme duke i ndarë ato në range dhe në shkallë⁵.

Në këtë drejtim studiuesit që merren me të drejtat e njeriut kanë identifikuar gjenerata reale të të drejtave, të ndara në bazë të kontekstit historik në të cilin ato janë zhvilluar, por jo në bazë të rëndësisë së tyre. Avokati francez me origjinë çeke Karel Vasak⁶ ishte i pari që i ndau të drejtat e njeriut në tre gjenerata, në vitet '70 dhe teorinë e tij kanë hedhur rrënjë fillimisht në të drejtën evropiane⁷. Në ditët tona identifikojmë katër gjenerata të të drejtave të njeriut të cilat janë si më poshtë:

Gjenerata e parë e të drejtave të njeriut është ajo e të drejtave tradicionale civile dhe politike të sanksionuara në kushtetutat liberal-demokratike. Lindja e këtyre të drejtave daton rreth vitit 1789, një kohë kur, me fundin e Revolucionit Francez, ndërhyr miratimi i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe qytetarit. Bëhet fjalë për të drejta dhe liri negative. Të tilla të drejta individuale, kërkojnë nga të tjerët, duke përfshirë dhe autoritetet publike, detyrime thjesht negative: përmbajtjen nga sjellje të caktuara, mos kufizimin e një sjellje të caktuar, etj. Ishin të drejta që rridhnin nga kërkesa për një numër të lirive themelore deri atëherë të përjashtuara për shtresa të gjera të popullsisë, të tilla si e drejta për jetën dhe integritetin fizik, të drejtat që lidhen me lirinë e mendimit, besimit, shprehjes, të tubimit dhe organizimit, të pjesëmarrjes politike, e drejta e votës aktive dhe pasive. Pjesë e kësaj gjenerata janë të ashtëquajturat "të drejta klasike" si e drejta e

nel prisma del diritto comparato, Milano, Giuffrè, 2004, pag 189; Rodotà S, Tecno politica. La democrazia e le nuove tecnologie della comunicazione, Roma-Bari Laterza, 1997.

³ Shih www.kdnj.al/sq/content/të-drejtat-e-njeriut.

⁴ 4 Mucollari O, "Të drejtat ndërkombëtare të njeriut", Tiranë Shtëpia botuese Mirgeeralb, 2015.

⁵ Omari L, Anastasi A, "E drejta kushtetuese", Tiranë, Shtëpia botuese ABC, 2010, faqe 87.

⁶ Vasak K, "Human Rights: A Thirty-Year Struggle: The Sustained Efforts to give Force of law to the Universal Declaration of Human Rights", Paris, UNESCO Courier 30:11, United Nations Educational, Scientific, and Cultural Organization, 1977.

⁷ De Stefani P, Diritti umani di terza generazione, Studi e ricerche, AS 01 [2009], 2010. Në dispozicion në <http://www.jelsi.com/news/2010/11/diritti.pdf>

jetës, barazia para ligjit, e drejta e votës, liria e shprehjes, liria e besimit, etj.⁸ Ato shfaqen si një interes i mbrojtur drejtëpërdrejtë nga rendi juridik shtetëror. Këto të drejta janë mishëruar në nivel global dhe janë përfshirë në të drejtën ndërkombëtare për herë të parë nga nenet 3 deri në 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut⁹ të vitit 1948 dhe më vonë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966. Në Evropë, ato janë të mishëruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁰ të vitit 1953.

Gjeneratës së dytë të të drejtave të njeriut i përketin të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Ky brez i dytë e ka zanafillën pas luftës së dytë botërore në Deklaratën Universale të të Drejtave të njeriut të vitit 1948 dhe përfshin të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (të tilla si e drejta për arsim, e drejta për një ambjent pune të sigurt e të shëndetshëm, e drejta për strehim të përshtatshëm, e drejta për sigurim social, shëndetësi, e drejta për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe kulturore etj.) edhe pse në Kushtetutën franceze të vitit 1791 janë përmendur për herë të parë të drejtat sociale, në formën e tyre embrionale. Këto të drejta u garantojnë anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë kushte dhe trajtim të barabartë. Më idealiste si natyrë, këto të drejta janë më të vështira për t'u realizuar, sidomos nga shtetet në zhvillim¹¹. Njësoj si të drejtat e gjeneratës së parë, ato janë përfshirë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe janë mishëruar në nenet 22 deri 28 të Deklaratës Universale, dhe në Paktin ndërkombëtar i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore¹².

Të drejtat e gjeneratës së dytë përbëhen nga kërkesa specifike drejtuar shtetit, jo vetëm thjesht në liri të dhëna nga ky fundit. Në këtë rast nuk vlen vetëm kërkesa që pushtetet publike të mos ndërhyjnë në sferën e autonomisë private, por edhe kërkesa që këto pushtete të bëhen aktive, duke vepruar pozitivisht, duke marrë një angazhim më të madh, sepse nuk ishte më e mjaftueshme thjesht shpallja apo njohja e të drejtës në një tekst kushtetues, duke qenë shteti i detyruar t'i zbatojë, duke vënë në dispozicion mjetet e duhura. Edhe për të drejtat e gjeneratës

së dytë, jemi ende në perspektivën e shtetit, pasi janë arritje të qytetarëve përballë shtetit.

Për të drejtat e gjeneratës së tretë është folur qysh gjatë viteve 70 për të nxjerrë në pah një dimension të ri të të drejtave të njeriut; jo më individuale (gjenerata e parë) ose vetëm kolektive (gjenerata e dytë), por humanitare, më saktësisht, i të drejtave të solidaritetit njerëzor. Në themel të këtij brezi të të drejtave është nevoja për të kundërshtuar rendin e ri ndërkombëtar ekonomik, me një rend të ri ndërkombëtar humanitar të bazuar në solidaritetin midis anëtarëve të njerëzimit¹³. Të drejtat e brezit të tretë marrin formulimin e tyre kryesisht në dokumente ligjore ndërkombëtare dhe zhvillojnë së bashku katër linja kryesore: të drejtën për paqe, të drejtën për mbrojtjen e mjedisit, të drejtën për individin dhe familjen për kushtet e nevojshme për zhvillim, e drejta e trashëgimisë së përbashkët të njerëzimit. Bëjnë pjesë tek të drejtat e gjeneratës së tretë edhe ato të drejta që mbrojnë kategoritë e personave, të cilët konsiderohen të dobët dhe të ekspozuar ndaj rreziqeve të shkeljes së të drejtave të tyre si për shembull të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e grave. Këto të drejta janë krijuar më shumë si të drejta të popujve dhe të njerëzimit si një e tërë sesa si të drejta individuale, si në rastin e të drejtave të gjeneratës së parë dhe të dytë. Ndonjëherë të drejtat e brezit të tretë mund të bien ndesh me të drejtat tradicionale dhe zgjidhja e konflikteve të tilla nënkupton një vizion të qartë politik dhe gjykatat kompetente dhe të guximshme. Këto janë të drejta solidariteti, sepse çdo komb ka përgjegjësi ndaj popujve të tjerë, sidomos ndaj atyre që janë në situata të vështira. Mendoni, për shembull, problemin e zhvillimit: shumë vende janë në kushte varfërie të tilla që janë në pamundësi të furnizimit me ushqim për të gjithë banorët apo, me ilaçe për ata që janë prekur nga sëmundjet dhe nuk janë në gjendje të kurohen për shkak të mungesës së burimeve ekonomike për blerjen e ilaçeve. Përballë këtyre situatave nxitet ose duhet të nxitet detyra e solidaritetit e vendeve më të pasura kundrejt vendeve të ndryshme në nevojë. Përsa i përket të drejtave të kësaj gjenerate, Norberto Bobbio¹⁴ ka argumentuar se "kjo është një kategori

⁸ Omari L, Anastasi A, E drejta kushtetuese, Tiranë, shtëpia botuese ABC, 2010, faqe 93.

⁹ Deklarata Universale e të Drejtave të njeriut. Në dispozicion në <http://www.crca.al/sites/>.

¹⁰ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në dispozicion në <http://www.qbz.gov.al/>.

¹¹ Mucollari O, Të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Tiranë, Shtëpia botuese Mirgeeralb, 2015, fq 21.

¹² International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights, në dispozicion në www.refworld.org.

¹³ Cao M. T. e Siliani S. (2015), Nuove generazioni dei diritti, on line në dispozicion në <http://www.testimonianzeonline.com/2015/11/nuove-generazioni-dei-diritti>.

¹⁴ Bobbio N ka qenë një filozof, jurist, historian, politikan, dhe senator i përjetshëm në Itali. Shih

heterogjene dhe e paqartë, në të cilën autorë të ndryshëm bëjnë pohime të ndryshme, të tilla si të drejtat e solidaritetit, e drejta për paqe, e drejta për zhvillimin ekonomik dhe cilësisë së jetës, e drejta për një mjedis të mbrojtur, të drejtat e konsumatorëve".

Gjenerata e të drejtave të reja. Së fundi, ka një gjeneratë të katërt të të drejtave, të cilat, ende nuk janë përpunuar me saktësi duke qenë një fenomen i kohëve të fundit. Gjenerata e re e të drejtave rrjedh nga dimensionet e ri teknologjive të komunikimit dhe informacionit. Përballë zhvillimit të ekonomisë së re, teknikave të reja të marrjes, përpunimit dhe shpërndarjes së informacionit si dhe transferimit të këtij informacioni, kanë ardhur duke u konfiguruar të ashtuquajturat të drejtat e shoqërisë teknologjike. Të drejta të reja janë shfaqur në horizont si pasojë e marrëdhënieve të pushtetit publik me qytetarët, por sidomos, e rolit të progresit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe bioetikës¹⁵, fenomen ky i kohëve të fundit. Lindja e këtyre të drejtave të reja është rezultat i drejtpërdrejtë i zbulimeve që pasojnë përdorimin e teknologjive të reja. Në këtë kuptim, kërkesa për të drejtat e reja rrjedh nga kërcënimi i shkakuar nga përdorimi i të njëjtave teknologji që kanë një ndikim të rëndësishëm dhe në mënyrë të pashmangshme në kuadrin e të drejtave themelore.

Të drejtat e reja digjitale në thelb janë të drejta të njeriut në epokën e internetit. Për shembull të drejtat për privatësi në internet dhe liria e shprehjes, janë me të vërtetë zgjerime të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të paraqitura në Deklaratën Universale të të

Drejta të Njeriut të Kombeve të Bashkuara. Sipas OKB-së, shkyçja e njerëzve nga interneti shkel këto të drejta dhe shkon kundër ligjit ndërkombëtar¹⁶.

Edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian¹⁷ në nenet 3 (e drejta e integritetit të personit) dhe 8 (mbrojtja e të dhënave personale) të saj, iu dha statusi i të drejtave themelore situatave të reja që u shfaqën në bioetikë dhe informatikë¹⁸. Megjithatë, këto shpallje abstrakte në parim ka të ngjarë të mbeten në letër, nëse njohja e tyre formale nuk shoqërohet me institucione të forta që sigurojnë një zbatim të vazhdueshëm.

Të drejtat e njeriut në internet

Në vitet nëntëdhjetë, me përhapjen e internetit, institucionet e lidhura ngushtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të tilla si OKB, fillojnë të diskutojnë të drejtat e njeriut dhe internetin. Megjithatë për shumicën e përdoruesve të internetit, kjo dukuri është ende shumë e re dhe emocionuese për t'u ndaluar dhe për të menduar për gjëra abstrakte të tilla si të drejtat e njeriut. Në fakt disa mendojnë që interneti është natyrisht i lirë dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për institucionet e së kaluarës, duke përfshirë të drejtat e njeriut¹⁹.

Interneti ka transformuar ndjeshëm, madje ka revolucionarizuar mënyrën tonë të komunikimit, të shkëmbimit të informacionit dhe të organizimit të jetës shoqërore, politike dhe ekonomike. E ashtuquajtura "shoqëri e dijes" ka potencial të madh në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke promovuar qarkullimin e dijes dhe duke ndikuar

<http://www.juragentium.org/topics/rights/it/bobbio.htm>.

¹⁵ Shih Angeletti L. R., Gazzaniga V, Storia, Filosofia ed etica generale della medicina, terza edizione, Elsevier Masson, 2008, faqe 163.

Shënim: Bioetika është përkufizuar si një fushë kërkimi që në sajë të disiplinave të ndryshme mbi të cilat mbështetet, ka si objekt të studimeve të saj kqyrjen (ekzaminimin) sistematik të sjelljes njerëzore në fushën e shkencës, jetës dhe shëndetit.

¹⁶ Hutt Rosamond, What are your digital rights, në dispozicion në <https://www.weforum.org/>. Akses i fundit në 27 dhjetor 2015. Shënim: Autori është referuar në Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, Frank La Rue, në dispozicion në <http://www2.ohchr.org/>.

¹⁷ Carta dei Diritti Fondamentali dell'Unione Europea, (2000/C 364/01). Në dispozicion në <http://www.europarl.europa.eu/>.

¹⁸ "Çdo person ka të drejtën për integritet fizik dhe mendor. Në fushën e mjekësisë dhe biologjisë, duhet

të respektohen në mënyrë të veçantë pëlqimi i lirë dhe e drejta e informimit të personit në fjalë, në mënyrën e përcaktuar me ligj, ndalohen praktikatat eugjenike, ndalohen praktikatat për ta bërë trupin e njeriut dhe pjesët e tij burim të fitimit financiar, ndalohet klonimi riprodhues i qenieve njerëzore" (neni 3), dhe "Çdo person ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave të tij personale. Këto të dhëna duhet të jenë të përpunuara në bazë të parimit të besimit, për qëllime të caktuara dhe me pëlqimin e personit në fjalë apo në një bazë tjetër legjitime të përcaktuar me ligj. Çdo person ka të drejtën për të hyrë në të dhënat e mbledhura në lidhje me të dhe të kërkojë korrigjimin. Respektimi i këtyre rregullave është subjekt i kontrollit nga një autoritet i pavarur" (neni 8).

¹⁹ De Martin J. C, Liberté, égalité, Internet. Per una Carta dei diritti digitali, në dispozicion në <http://www.lastampa.it/2015/03/28/cultura/libertegalit-internet-per-una-carta-dei-diritti-digitali>.

thellësisht dinamikën e demokratizimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut²⁰.

Interneti po shfaqet si "pushteti i pestë" i aftë për të promovuar fuqizimin e qeverive dhe mediave në mbarë botën. Në të njëjtën kohë, përdorimi gjithnjë e më i përhapur i platformave të rrjetit dhe pajisjeve portative ka ekspozuar përdoruesit kundrejt rreziqeve të reja, si keqpërdorimi i të dhënave personale për qëllime të ndryshme, shkelja e sigurisë së vetë infrastrukturave etj. Sipas *Stefano Rodotès*, interneti është hapësira publike më e madhe që njerëzimi ka njohur. Interneti është gjithashtu një ekosistem kompleks²¹.

Së pari, ai është një vend i rëndësishëm i prodhimit dhe shkëmbimit të njohurive dhe, si i tillë, është një burim i paçmuar për edukimin, informimin, hulumtimet, dhe zhvillimin e popujve. Promovimi i aksesit në informacion, gjithashtu promovon mekanizma të transparencës dhe qeverisjes së mirë.

Së dyti, interneti është motori i ekonomisë globale, nxitës jo vetëm i inovacionit, por edhe i infrastrukturës kryesore për pjesëmarrjen e sipërmarrjeve lokale në ekonominë globale. Së treti, interneti është një platformë komunikimi ndërpersonale i cili, në sajë të përhapjes së pajisjeve të lëvizshme, është bërë mjeti kryesor i komunikimit, në gjendje për të thyer barrierat gjeografike dhe për të çelur kanale të reja ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve, duke nxitur krijimtarinë, shpërndarjen dhe pjesëmarrjen.

Së fundmi, interneti është një mjet gjithnjë e më i domosdoshëm për organizimin shoqëror dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punët publike.

Në të njëjtën kohë interneti është shndërruar në një makinë survejimi qeveritare. Kjo nuk ndodh vetëm në Kinë, Iran, Rusi apo vende të tjera autoritare, por madje siç dokumentohet nga Edëard Snoëden edhe në vendet me tradita të forta demokratike në të dy anët e Atlantikut.

Të drejtat virtuale ose digjitale të cilat janë shfaqur rishtazi janë në thelb të drejtat e njeriut në epokën e internetit. Këto të drejta përshkruajnë të drejtat e njeriut që lejojnë individët të kenë akses, të përdorin, të krijojnë dhe të botojnë në median digjitale ose të hyjnë dhe të përdorin kompjuterat, pajisjet e tjera

elektronike dhe rrjetet e komunikimit. Termi është veçanërisht i lidhur me mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave ekzistuese, të tilla si e drejta për privatësi ose liria e shprehjes, në kontekstin e teknologjive të reja digjitale, sidomos në internet. E drejta e aksesit në internet është njohur si e drejtë nga legjislacioni i disa vendeve²².

E drejta për privatësi dhe liria e shprehjes në internet, për shembull, janë me të vërtetë zgjerime të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara. Sipas OKB-së, "shkëputja e njerëzve nga interneti shkel këto të drejta dhe është në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar"²³.

Analiza e ndikimit të internetit tek të drejtat e njeriut nuk mund të kufizohet vetëm në zbulimin e sfidave të reja apo të ndonjë mangësie në sistemin e mbrojtjes të këtyre të drejtave në raport me progresin e vazhdueshëm teknologjik. Në lidhje me këtë aspekt, studiuesit mund të verifikojnë mënyrën e reagimit të modelit ekzistues të të drejtave të njeriut, të parashikuar apo të sanksionuar në kushtetuta, në raport me përhapjen e internetit. Në një fazë ku asnjë zgjidhje nuk mund të parashikohet me siguri, kjo do të duket një sipërmarrje e lavdërueshme tashmë në përpjekjen për të përcaktuar kushtet e marrëdhënieve ndërmjet një ngjarjeje në thelb postmoderne, si lindja dhe zhvillimi i rrjetit të internetit, dhe atyre vlerave të transpozuar dhe të njohura nga kushtetutat republikane, bija të modernizmit iluminist²⁴.

Natyra hibride e internetit, nga njëra anë një instrument dhe mjet i lirisë, dhe në anën tjetër një kërcënimin kanosës, ngre problemin e konsistencës ligjore si të mundësive të reja për veprim të ofruara nga interneti, si të kërkesave të reja të mbrojtjes së të drejtave që individi i parashtron sistemit ligjor si pasojë e zhvillimeve të vrullshme të realitetit virtual.

Pas përcaktimit nëse këto të drejta të reja në raport me zhvillimin e teknologjive janë të drejta subjektive mbetet ende i paqartë statusi i tyre, nëse janë të drejta kushtetuese dhe a duhet një përditësim formal i katalogut të të drejtave të njeriut të parashikuara nga Kushtetutat dhe dokumentet e tjera? Përsa i përket kësaj qasjeje

²⁰ Importanza di internet në dispozicion në <http://discussionepubblica.ideascale.com/a/dtd/importanza-di-internet/>.

²¹ La posizione italiana sui principi fondamentali di Internet, pdf në dispozicion në <http://download.repubblica.it/>.

²² Lucchi N, "Access to Network Services and Protection of Constitutional Rights: Recognizing the Essential Role of Internet Access for the Freedom of

Expression", Cardozo Journal of International and Comparative Law (JICL), Vol. 19, No. 3, 2011. Në dispozicion në <http://papers.ssrn.com>

²³ What-are-your-digital-rights-explainer, në dispozicion në <https://www.weforum.org>.

²⁴ Caruso C, L'individuo nella rete: i diritti della persona al tempo di internet, fq 5, në dispozicion në www.forumcostituzionale.it/wordpress/images/stories/pdf/documenti_forum/paper/0406_caruso.pdf.

ka studiues që besojnë se interneti ka përfshirë në sistemet ligjore situata të reja subjektive të tilla si psh e drejta e aksesit në internet²⁵.

Ky orientim doktrinor e konsideron të drejtën për akses në internet, një të drejtë sociale, e cila detyron autoritetet publike që t'i sigurojnë individit mjetet materiale për të patur akses me brez të gjerë dhe lidhje të shpejtë²⁶.

Të drejtat e përdoruesve në internet

Me rëndësi strategjike për rajonin tonë është *Udhëzuesi Për të Drejtat e Përdoruesve në Internet*²⁷ në kuadër të Këshillit të Evropës i cili, në një kontekst të fragmentuar si Evropa, nga prilli 2014 rreshtohet kundër mbikëqyrjes pa dallim të përdoruesve të internetit duke argumentuar se vetëm një gjykatë mund të kufizojë të drejtat e përdoruesve në internet dhe lirinë e tyre të shprehjes. Strategjia e Rregullimit të Internetit e Këshillit të Evropës 2012-2015 së bashku me Udhëzuesin u kushton rëndësi të drejtave të përdoruesve të internetit. Kapitulli "Maksimizimi i të Drejtave dhe Lirive për Përdoruesit e Internetit", i cili kishte për qëllim promovimin e aksesit dhe përdorimin më të mirë të internetit, përfshinte si linjë të veprimit: "hartimin e një përmbledhjeje të të drejtave ekzistuese të njeriut për përdoruesit e internetit për t'i ndihmuar në komunikimin me aktorë kyç të internetit dhe agjencitë qeveritare dhe në kërkimin e rekursit të efektshëm, kur ata konsiderojnë se të drejtat dhe liritë e tyre janë prekur negativisht: për të raportuar një incident, për të paraqitur një ankesë ose për të kërkuar një të drejtë, dëmshpërblim apo formë tjetër të rekursit".

Këshilli i Evropës në prill të 2014 në kuadër të mbledhjes së 1197 të zëvendësministrave nëpërmjet një rekomandimi²⁸ rikujtoi që "shtetet anëtare janë të detyruara të garantojnë për çdo person brenda juridiksionit të tyre mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut të sanksionuara në Konventën Evropiane" duke shtuar se "i njëjti detyrim vlen njësoj dhe në kontekstin e përdorimit të internetit". Duhet të zbatohen gjithashtu në këtë fushë konventat dhe instrumentet e tjera të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, lirisë së aksesit në informacion, lirisë së mbledhjes, mbrojtjes kundër kriminalitetit

kibernetik, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në internet apo jashtë tij të gjithë duhet të trajtohen si njerëz, persona, qytetar duke respektuar të gjitha të drejtat themelore të fituara.

Rekomandimi i Këshillit të Evropës vazhdon më tej duke u shprehur se: përdoruesit e internetit duhet të ndihmohen që të kuptojnë të drejtat e njeriut që ata gëzojnë on line dhe të mund ti ushtrojnë ato edhe kur janë vendosur kufizime ose kur ka ndërhyrje shqetësuese në të drejtat dhe liritë e tyre²⁹.

Kjo nënkupton se përdoruesit e internetit duhet të jenë të informuar për mënyrën e aksesit dhe mjetet juridike të ankimit me qëllim shfrytëzimin në mënyrë efektive të tyre.

Në dritën e mundësive të ofruara nga interneti në fushën e transparencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e punëve publike, përdoruesve duhet tu krijohen kushtet për përdorimin e internetit që të mund të marrin pjesë në jetën demokratike. Për t'u siguruar që të drejtat ekzistuese të njeriut dhe liritë themelore të aplikohen njësoj jashtë internetit dhe në internet, Komiteti i Ministrave rekomandon³⁰ që shtetet anëtare të promovojnë Udhëzuesin midis qytetarëve, autoriteteve publike dhe aktorëve të sektorit privat si dhe të marrin masa specifike në lidhje me zbatimin e tij, në mënyrë që t'u mundësojnë përdoruesve ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre të njeriut dhe lirive themelore gjatë përdorimit të internetit; të vlerësojnë, të shqyrtojnë rregullisht dhe, sipas rastit, të heqin kufizimet në lidhje me ushtrimin e të drejtave dhe lirive në internet, sidomos kur nuk janë në përputhje me këtë Konventë, nën dritën e jurisprudencës përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Çdo kufizim duhet të jetë i përshkruar me ligj, i nevojshëm në një shoqëri demokratike, të ketë një qëllim të ligjshëm dhe të jetë proporcional me qëllimin legjitim; të sigurohen që përdoruesit e internetit kanë qasje në korrigjime efektive kur të drejtat dhe liritë e tyre janë të kufizuara ose kur ata besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur. Kjo kërkon rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve, subjekteve dhe komuniteteve përkatëse. Gjithashtu, kërkon angazhimin e sektorit privat dhe organizatave të

²⁵ Frosini E. T, Il diritto costituzionale di accesso a internet, Rivista Aic N°: 1/2011. Në dispozicion në <http://www.rivistaaic.it/>.

²⁶ Caruso C, L'individuo nella rete: i diritti della persona al tempo di internet, fq 9, në dispozicion në www.forumcostituzionale.it/wordpress/images/stories/pdf/documenti_forum/paper/0406_caruso.pdf.

²⁷ Recommendation CM / Rec (2014) 6 of the Committee of Ministers to member states on a guide

rights for Internet users. Në dispozicion në https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.

²⁸ Recommendation CM / Rec (2014) 6 of the Committee of Ministers to member states on a guide rights for Internet users.

²⁹ Rodota S, Masero A, Scorza G, Internet, i nostri diritti, Editori Laterza, 2016 faqe 4.

³⁰ Sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës.

shoqërisë civile, dhe bashkëpunimin efektiv me këta aktorë.

Në varësi të kontekstit kombëtar, kjo mund të përfshijë mekanizma dëmshpërblimi, si ato të parashikuara nga autoritetet e mbrojtjes së të dhënave, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (si avokatët e popullit), proceset gjyqësore dhe linjat e drejtpërdrejta; të promovojnë koordinimin me aktorë të tjerë shtetërorë dhe jo-shtetërorë, brenda dhe përtej Këshillit të Evropës, në lidhje me standardet dhe procedurat të cilat kanë një ndikim në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në internet; të inkurajojnë sektorin privat për t'u angazhuar në dialog të sigurtë me autoritetet përkatëse shtetërore dhe shoqërinë civile në ushtrimin e përgjegjësisë së tyre korporative sociale, në veçanti për transparencën dhe llogaridhënien e tyre, në përputhje me "Parimet udhëzuese mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut: zbatimi i Kornizës për 'Mbrojtje, Respekt dhe Korrigjim' të Kombeve të Bashkuara".

Sektori privat duhet gjithashtu të inkurajohet që të kontribuojë në përhapjen e udhëzuesit; të inkurajojë shoqërinë civile për të mbështetur përhapjen dhe aplikimin e udhëzuesit në mënyrë që të sigurohet një mjet efektiv për përdoruesit e internetit.

Interneti ka vlerën e shërbimit publik. Individët, komunitetet, institucionet publike dhe kompanitë private mbështeten në internet për të ushtruar biznesin e tyre dhe kanë të drejtë të presin që shërbimet online të jenë të aksesueshme, të ofrohen pa diskriminim, të përbalueshme, të sigurta, të besueshme dhe të vazhdueshme. Përveç kësaj, gëzimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të përdoruesve të internetit nuk duhet të jetë objekt i çfarëdo kufizimi të paligjshëm, të panevojshëm ose disproporcional.

Udhëzuesi është i bazuar në të drejtat dhe liritë që përmban Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe interpretimin e këtyre të drejtave nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe në instrumente të tjera dhe tekste ligjore të Këshillit të Evropës, dhe është miratuar në 16 prill 2014 nga Komiteti i Ministrave. Udhëzuesi nuk përcakton të drejta të reja të njeriut dhe liri themelore. Ai bazohet në standardet ekzistuese të të drejtave të njeriut dhe mekanizmat e zbatimit³¹.

Në përgjithësi, Këshilli vë në dukje që "të drejtat e përdoruesve përcaktohen në kushtet e shërbimit të kompanive të internetit, të cilat janë kryesisht kushtet kontraktuale, shqyrtime të

gjata ligjore mbi këtë temë, të cilat rrallë lexohen, dhe gjithnjë e më rrallë janë të kuptueshme". Udhëzuesi është zhvilluar nga një konsultim i shumë palëve të interesuara me qeveritë, kompanitë private dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimit online, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të komunitetit teknik dhe botës akademike dhe fokusohet në disa të drejta themelore si më poshtë:

E drejta e aksesit dhe e mosdiskriminimit: interneti është një mënyrë e rëndësishme për të ushtruar të drejtat dhe liritë, dhe për të marrë pjesë në demokraci. E drejta e aksesit është një mjet për të ushtruar të drejtat e tjera njerëzore. Si rregull i përgjithshëm, përdoruesit nuk duhet të jenë "të shkyçur" nga interneti kundër vullnetit të tyre, përveç kur është vendosur nga një gjykatë.

Liria e shprehjes dhe informacionit: përdoruesit kanë lirinë për të shprehur mendimet e tyre në internet dhe të drejtën e përdorimit të informacioneve dhe mendimeve të të tjerëve.

Liria e mbledhjes, organizimit dhe pjesëmarrjes: përdoruesit kanë lirinë për të zgjedhur çdo faqe elektronike, aplikim apo shërbim tjetër me qëllim organizimi dhe tubimi. Ata gjithashtu kanë të drejtë të protestojnë në mënyrë paqësore në internet. Megjithatë, përdoruesit duhet të jenë të vetëdijshëm se mund të përballen me pasojat ligjore nëse protesta në internet, sjell bllokim, ndërprerje të shërbimeve ose dëmtim të pronës së të tjerëve.

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale: të dhënat personale, duhet të përpunohen vetëm kur përdoruesit e internetit janë dakord ose përpunimi i tyre parashikohet me ligj. Përdoruesit duhet të informohen për të dhënat personale që janë përpunuar apo transferuar palëve të tjera, kur, nga kush, për çfarë qëllimi dhe duhet të ushtrojnë kontroll mbi ta (për të verifikuar saktësinë e tyre, të kërkojnë ndreqjen ose fshirjen). Përdoruesi nuk duhet të jetë subjekt i masave të përgjithshme të vëzhgimit dhe përgjimit, me përjashtim të rrethanave të veçanta të parashikuara me ligj, si në rastin e ndjekjes penale.

Edukimi dhe arsimimi: përdoruesit duhet të kenë të drejtën e aksesit të internetit për edukimin dhe arsimim e tyre on line.

Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve: fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për një mbrojtje dhe përkrahje të vecantë kur përdorin internetin. Nëse përmbajtja e publikuar prej tyre rrezikon dinjitetin, sigurinë, apo privatësinë, ose mund të

anëtare të Këshillit të Evropës. Në memorandumin shpjegues të Rekomandimit gjendet informacion më i hollësishëm shpjegues i udhëzuesit.

³¹ Ky udhëzues është pjesë e një rekomandimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave të 47 shteteve

jetë e dëmshme për ta në të ardhmen, me kërkesën e tyre, duhet të eliminohet brenda një periudhe të shkurtër kohe. Ata duhet gjithashtu të jenë të mbrojtur nga ndërhyrjet në zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral, në veçanti përsa i përket abuzimit dhe shfrytëzimit seksual.

E drejta për mjete efektive ligjore për shkeljet: përdoruesit kanë të drejtë për mjete efektive ligjore kur të drejtat e tyre janë kufizuar ose shkelur. Mjetet efektive ligjore mund të sigurohen direkt nga ofruesit e shërbimeve të internetit, nga autoritetet publike dhe/ose institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, dhe mund që në varësi të shkeljes në fjalë, të kryejnë hetime, të japin shpjegime, përgjigje, korrigjime, të kërkojnë ndjesë, riintegrim, rilidhje të linjës së internetit dhe kompesim.

Refleksione përmbyllëse

Nga analiza e mësipërme mund të arrijmë në disa refleksione përmbyllëse, të cilat na vërtetojnë se në ditët tona sipas doktrinës është zhvilluar një gjeneratë e të drejtave të reja, të cilat, ende nuk janë përpunuar me saktësi duke qenë një fenomen i kohëve të fundit.

Risitë shkencore dhe teknologjike kanë ndikuar në dimensionin e të drejtave themelore dhe ky ndikim është i destinuar të vazhdojë edhe në të ardhmen. Kjo kategori e të drejtave të reja ka gjetur tashmë njohje në dokumenta ndërkombëtare dhe mbikombëtare, në kushtetuta dhe ligje.

Të drejtat e reja janë ato që lidhen me fushën e teknologjive të reja të komunikimit. Ato janë

shfaqur në horizont si pasojë e marrëdhënieve të pushtetit publik me qytetarët, por sidomos, e rolit të progresit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe bioetikës, fenomen ky i kohëve të fundit.

Lindja e këtyre të drejtave të reja është rezultat i drejtpërdrejtë i zbulimeve që pasojnë përdorimin e teknologjive të reja. Në këtë kuptim, kërkesa për të drejtat e reja rrjedh nga kërcënimi i shkakuar nga përdorimi i të njëjtave teknologji që kanë një ndikim të rëndësishëm dhe në mënyrë të pashmangshme në kuadrin e të drejtave themelore. Në këtë kategori përfshihen të drejtat virtuale ose digjitale, të cilat janë në thelb të drejtat e njeriut në epokën e internetit. Këto të drejta përshkruajnë të drejtat e njeriut që lejojnë individët të kenë akses, të përdorin, të krijojnë dhe të botojnë në median digjitale ose të hyjnë dhe të përdorin kompjuterat, pajisjet e tjera elektronike dhe rrjetet e komunikimit. Termi është veçanërisht i lidhur me mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave ekzistuese, të tilla si e drejta për privatësi ose liria e shprehjes, në kontekstin e teknologjive të reja digjitale, sidomos në internet.

Analiza e ndikimit të internetit tek të drejtat e njeriut nuk mund të kufizohet vetëm në zbulimin e sfidave të reja apo të ndonjë mangësie në sistemin e mbrojtjes të këtyre të drejtave në raport me progresin e vazhdueshëm teknologjik. Në lidhje me këtë aspekt, studiuesit mund të verifikojnë mënyrën e reagimit të modelit egzistues të të drejtave të njeriut, të parashikuar apo të sanksionuar në kushtetuta, në raport me përhapjen e internetit.

Literaturë

- Rodota S, Masero A, Scorza G, *Internet, i nostri diritti*, Editori Laterza, 2016
- Rodota S, *Diritti umani e nuove tecnologie. Në dispozicion në* <http://www.infoleges.it/>.
- Rodota S, *Tecnologia e diritti*, Bologna, Il Mulino, 1995.
- Frosini T. E, *Tecnologie e libertà costituzionali*, G. Comandè e G. Ponzalli (a cura di) in *Scienza e diritto nel prisma del diritto comparato*, Milano, Giuffrè, 2004.
- Rodotà S, *Tecnopolitica. La democrazia e le nuove tecnologie della comunicazioni*, Roma-Bari, Laterza, 1997.
- Mucollari O, "Të drejtat ndërkombëtare të njeriut", Tiranë „Shtëpia botuese Mirgeeralb, 2015.
- Omari L, Anastasi A, "E drejta kushtetuese", Tiranë, Shtëpia botuese ABC, 2010.
- De Stefani P, *Diritti umani di terza generazione, Studi e ricerche*, AS 01 [2009] 11-23. Në dispozicion në <http://www.jelsi.com/news/2010/11/diritti.pdf>.
- Cao M. T. e Siliani S, *Nuove generazioni dei diritti, on line në dispozicion në* <http://www.testimonianzeonline.com/2015/11/nuove-generazioni-dei-diritti>.
- Caruso C, *L'individuo nella rete: i diritti della persona al tempo di internet, në dispozicion* www.forumcostituzionale.it/wordpress/images/stories/pdf/documenti_forum/paper/0406_caruso.pdf.
- Recommendation CM / Rec (2014) 6 of the Committee of Ministers to member states on a guide rights for Internet users.

*Në dispozicion në
https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.*

- *Internet user rights guide. Në dispozicion në <http://www.coe.int/en/web/internet-users-rights/guide>.*

Aspekte juridiko-civile mbi ndikimin e legjislacionit kombëtar e atij ndërkombëtar në mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike Shqiptare

Prof.Asoc.Dr. Saimir Shatku

Lektor në Universitetin e Tiranës

s_shatku@yahoo.com

Abstrakt

Sa e rëndësishme është për ne, popullsinë e ditëve të sotme, të zbulojmë dhe të njohemi me historinë e krijimit dhe të zhvillimit të njerëzimit që nga periudhat fillestare të saj?

Trashëgimia kulturore sëbashku me të gjitha degët e saj përfaqëson fakte thelbësore mbi njohjen dhe zhvillimin e historisë mbarënjëzore ndër shekuj për shumë vende të botës. Pikërisht njohja me secilën etapë historike të zhvillimeve kulturore botërore ndër vite, të cilat sëbashku me karakteristikat e tyre specifike përbëjnë historinë e veçantë të identifikimit të një vendi, na ndihmon që të kuptojmë më mirë prejardhjen tonë, përkatësinë shoqërore dhe trashëgiminë kulturore të vendit të origjinës.

Arkeologjia, si pjesë e pandarë e shkencave historike që studiojnë procese të tëra evoluimi të njerëzimit kudo në botë dhe trashëgiminë e tyre kulturore, veçanërisht për periudhat kur mungojnë burimet e shkruara, duke u mbështetur vetëm në gjurmët e mbetura të jetës së popullsisë të lashta, që ruhen në rrënojat e vendbanimeve dhe në varrezat e tyre, të tilla si: ndërtime, vepra arti, sende të përdorimit të përditshëm, mbishkrime, monedha etj., të cilat gjatë studimit të tyre dëshmojnë për veprimtarinë ekonomike, shoqërore e politike, të një shoqërie apo të një popullsie të veçantë, na ndihmon të hedhim dritë mbi fakte të panjohura mbi funksionimin dhe zhvillimin e një shoqërie të caktuar që nga lashtësia e deri në aktualitetin e sotëm.

Duhet përmendur fakti se asnjë shkencë e re, apo disiplinë e së drejtës nuk mund të zhvillohet dhe të ushtrojë veprimtarinë e saj efektive, nëse nuk ekziston një kuadër i plotë ligjor, i miratuar për ta rregulluar atë apo pasojat që vijnë prej shtrirjes së saj në objekte të ndryshme. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkencën e

arkeologjisë, e cila nuk mund të funksiononte nëse nuk do të rregullohej nga aspekte të legjislacionit përkatës për të, si në sajë të një kuadëri ligjor kombëtar, ashtu edhe atij ndërkombëtar. Për këtë arsye, në këtë punim vëmendje do të marrë trajtimi i disa aspekteve kryesore të legjislacionit specifik, i cili rregullon dhe mbron fushën e veprimit të arkeologjisë në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Arkeologji; trashëgimi; kulturë; legjislacion; mbrojtje*

Abstract

How important is it for us, the population of today, to discover and become familiar with the history of the creation and development of mankind from its initial periods?

Cultural heritage together with all its branches represent essential facts about the knowledge and development of the whole human history over the centuries for many countries of the world. Knowing each historical stage of the world's cultural developments over the years, which together with their specific characteristics constitute the special history of the identification of a country, helps us to better understand our origin, social affiliation and cultural heritage of the country of origin.

Archaeology, as an integral part of the historical sciences that study entire processes of evolution of humanity anywhere in the world and their cultural heritage, especially for periods when there are no written sources, relying only on the remaining traces of the life of ancient populations, that are preserved in the ruins of settlements and in their cemeteries, such as: buildings, works of art, items of daily use, inscriptions, coins, etc., which during their study

testify to the economic, social and political activity of a society or a particular population, helps us shed light on unknown facts about the functioning and development of a certain society from antiquity to the present day.

It should be mentioned that no new science or discipline of law can develop and exercise its effective activity, if there is no complete legal framework, approved to regulate it or the consequences that come from its extension in different objects. The same can be said for the science of archaeology, which could not function if it were not regulated by aspects of the legislation relevant to it, both thanks to a national and international legal framework. For this reason, in this paper attention will be paid to the treatment of some main aspects of the specific legislation, which regulates and protects the field of action of archeology in Albania.

Keywords: *Archaeology; inheritance; culture; legislation; defence*

1. Hyrje

Trashëgimia kulturore përfaqëson ruajtjen ndër shekuj të tërësisë së pasurive apo objekteve fizike me rëndësi të veçantë për një shoqëri të caktuar, e cila merr të gjitha masat e nevojshme për kujdesin, mbrojtjen dhe kalimin e tyre nga brezat e kaluar, tek brezat e tashëm, e më vonë në kohë atyre të ardhshëm. Trashëgimia kulturore përfshin **kulturën materiale** (të tillë si ndërtesat, monumentet, peizazhet, librat, veprat e artit dhe objektet e ndryshme), **kulturën shpirtërore**, (të tilla si folklori, traditat, gjuha dhe njohurit tradicionale), si dhe **trashëgiminë natyrore** (duke përfshirë peisazhet e rëndësishme kulturore). Në këtë punim, vlerë të madhe merr trajtimi i shkencës së arkeologjisë në Shqipëri, trajtuar nën mbrojtjen dhe rëndësinë që i kushton legjislacioni shqiptar zhvillimit të saj.

Arkeologjia si shkencë më vetë përfaqëson si ndër degët kryesore të kulturës materiale, e cila përgjatë zhvillimit të studimeve të saj mbi objekte të caktuara përdor disa kritere, të cilat i japin të drejtën ekskluzive kësaj shkence që të veprojë mbi to. Në mënyrë që një objekt të përbëjë objekt studimi për arkeologjinë duhet të:

- paraqesë një kryevepër gjeniale krijuese të njeriut ose rëndësi kulturore;
- ekspozon një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore, në një hark kohor, ose brenda një zone kulturore në botë, në zhvillimin e arkitekturës ose teknologjisë, artit monumental,

planifikimit urbanistik, ose dizajn të peizazhit;

- të mbajnë një dëshmi unike ose të paktën të jashtëzakonshme për një traditë kulturore apo një qytetërim i cili jeton apo është zhdukur;
- është një shembull i shkëlqyer i një lloji të ndërtimit, arkitekturës, apo ansambël teknologjik apo peizazhin i cili ilustron një fazë të rëndësishme në historinë njerëzore;
- është një shembull i shkëlqyer i vendbanimeve njerëzore tradicionale, shfrytëzimi i tokës, ose shfrytëzimi i detit që është një përfaqësues i një kulture, ose ndërveprimi i njeriut me natyrën veçanërisht kur ajo është prekur nga ndikim e ndryshimeve të pakthyeshme;
- është e lidhur dukshëm ose drejtpërdrejt me ngjarje apo tradita që jetojnë, me ide, ose me besime, me veprat artistike dhe letrare të një rëndësie të jashtëzakonshme universal.

2. Rëndësia e zhvillimit të arkeologjisë për trashëgiminë kulturore të një vendi

- ❖ Lind pyetja: *Përse një vend i caktuar i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit dhe mbrojtjes së arkeologjisë?*

Në përgjigje të kësaj pyetje mund të themi se:

- Çdo vend në botë dhe çdo shoqëri shpreh interes për njohjen me prejardhjen e saj;
- Prania e objekteve arkeologjike dëshmon historinë e krijimit, zhvillimit dhe ekzistencës së një vendi;
- Qytetërimet e lashta, apo objektet mijëra vjeçare dëshmojnë për kulturën specifike të një shoqërie të caktuar;
- Zbulimet arkeologjike japin detaje mbi mënyra të jetesës dhe faktorë të shumtë zhvillimi për kultura të ndryshme;
- Zbulimet arkeologjike përbëjnë atraksione për zhvillimin e turizmit kulturor;
- Përkatësia dhe lidhja e një shoqërie me zbulime arkeologjike i jep asaj shoqëria apo atij vendi një pozicion të caktuar në rendin kulturor dhe zhvillimet e ndryshme në nivel botëror.

3. Zhvillimet arkeologjike ndër vite në Shqipëri

Shqipëria si një vend me kulturë shumë të lashtë dhe me pozitë të favorshme gjeografike, ku janë gërrshetur kulturat më të rëndësishme të botës

antike në pellgun e Mesdheut, i cili njihet si një prej djepeve më të rëndësishme të civilizimit botëror, ruan në brendësi të saj një numër të konsiderueshëm të pikave arkeologjike, të cilat janë dëshmi e plotë e këtij qytetërimi¹.

Kërkimet arkeologjike në Shqipëri filluan vonë për shkak të ngjarjeve të shumta historike deri në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar në 1912. Edhe pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar nën kryesinë e Ismail Qemalit, u desh kohë që të formoheshin dhe vepronin disiplinat shkencore të fushave shoqërore e natyrore të cilat do të fillojnë veprimtarinë kryesisht pas Luftës së II Botërore². Arkeologjia kaloi në disa faza deri sa u formua si disiplinë më vete³.

Zanafilla e saj në aspektin institucional nis në vjeshtën e vitit 1948 kur krijohet Grupi arkeologjik dhe Muzeu Arkeologjik Etnografik në përbërje të Institutit të Shkencave në Tiranë. Më 1948 u çel Muzeu i parë arkeologjik-etnografik, dhe arkeologët shqiptarë filluan gjurmimet e para sistematike në Apoloni e më pas në tumat e Matit⁴. Grupi i arkeologëve në vitet më pas do të shtrinte veprimtarinë gjurmuese e kërkimore arkeologjike në gjithë Shqipërinë, duke kaluar gradualisht në forma organizimi më të mëdha siç ishte Sektori i Arkeologjisë në Institutin e Historisë (1964), Qendra e Kërkimeve arkeologjike (1976) e Akademisë së Shkencave e cila u shndërrua në Institutin e Arkeologjisë (1991) dhe nga viti 2008 Instituti i Arkeologjisë bëhet pjesë e Qendrës së Studimeve Albanologjike. Gjatë kësaj periudhe arkeologjia shqiptare realizoi jo vetëm zbulime të mëdha të kulturës materiale e shpirtërore të qytetërimeve të shkuara (vendbanime, qytete, monumente e objekte) nëpërmjet qindra ekspeditave

kërkimore në terren, por forcoi edhe qëndrueshmërinë e saj si shkencë e veçantë⁵.

Ndryshimet e mëdha demokratike dhe përpjekjet e Shqipërisë për tu afruar e integruar me vendet e tjera evropiane në fillim të viteve 90, krijuan kushte të reja për zhvillimin e kërkimit shkencor sipas modeleve perëndimore duke dalë kështu nga mbyllja e gjatë prej disa dekadash izolim gjatë sundimit komunist. Kërkimi i deriatëhershëm i mbështetur vetëm në burimet e mjetet e brendshme duke mos shfrytëzuar sa e si duhet përparimet e shkencës dhe teknikës evropiane e botërore, po bëhej gjithnjë e më frenues për zhvillimin e arkeologjisë shqiptare.

Organizimi i projekteve të para të bashkëpunimit për kërkimet arkeologjike të aplikuara në Apoloni e Sovjan të Korçës me arkeologë nga Franca, në Butrint me arkeologë nga Anglia e Greqia pas viteve 90' dhe eksperiencia e fituar nga këto bashkëpunime, treguan jo vetëm mundësitë e reja për kërkime në të gjitha fushat me mjete e metoda bashkëkohore, por edhe për kualifikimin e specialistëve të rinj të arkeologjisë. Këto zhvillime ndodhën në periudhën kur Shqipëria kalonte vështirësi të mëdha, në kushtet e transformimit politik, ekonomik dhe shoqëror. Megjithatë Instituti i Arkeologjisë u përfshi hap pas hapi në një veprimtari të gjerë kërkimore duke organizuar projekte bashkëpunimi me universitete e institucione simotra të vendeve perëndimore. Projektet shumëvjeçare të gjurmimeve bashkuan përvojat e arkeologëve shqiptarë me ato të arkeologëve dhe specialistëve nga vende si Anglia, Franca, SHBA, Italia, Greqia, Austria, Gjermania, Zvicra, Izraeli e Polonia në kërkimet për të gjitha fushat e arkeologjisë si për prehistorinë, antikitetin dhe mesjetën.

¹ Durrësi i Lashtë daton në shek e VII para Kr., bazuar në dokumentat dhe burimet antike tradicionale në vitin 627. Qyteti modern është ndërtuar mbi rrënojat e Epidamnit ose Dyrrachion-it të lashtë, që më vonë u transformua në Dyrrachium-in e periudhës Romake.

² Disa hapa që u hodhën në ngritjen e koleksioneve arkeologjike private (në Shkodër, Vlorë) si dhe muzeve të parë publik arkeologjikë në Tiranë (1922) e Vlorë (1936), por shpejt morën fund gjatë Luftës së II.

³ Në tre dhjetëvjeçarët e parë të shek.XX kërkimet u bënë më të shpeshta dhe misionet e huaja arkeologjike austriake (K.Prashniker), francezë (L.Rei) e italianë (L.Ugolini) ndërmorën gjurmime arkeologjike në Apoloni e Butrint.

⁴ Për përgatitjen e listës së parë të monumenteve të kulturës që mbrohen nga shteti dha ndihmesë inxhinieri dhe arkeologu Jovan Adami (1892-1951).

⁵ Kjo dëshmohet nga koleksionet arkeologjike prej dhjetëra mijë objekte të fondit të përhershëm, 5 muzetë arkeologjik në qytetet (Tiranë, Durrës, Apoloni, Butrint dhe Korçë), pavijoni arkeologjik në Muzeun Historik Kombëtar dhe shumë të tilla në muzetë e rrethëve në të gjithë Shqipërinë.

4. Legjislacioni kombëtar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore shqiptare

Legjislacioni kombëtar i një vendi, nëpërmjet dispozitave dhe normave të tij përshkruese apo procedurale luan rol kryesor ndikues në mbrojtjen dhe rregullimin e një veprimtarie të caktuar me rëndësi të veçantë për të drejtën. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndikimin e legjislacionit shqiptar në zhvillimin e shkencës së arkeologjisë, i cili nëpërmjet normave të tij ndikon në aspekte mbrojtëse dhe parandaluese për realizimin e kësaj veprimtarie.

Për shkak të rëndësisë së madhe që luan arkeologjia në ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore të shtetit tonë, legjislatori ka marrë të gjitha masat e nevojshme për kultivimin dhe krijimin e një kuadri të plotë ligjor dhe specifik, i cili nëpërmjet dispozitave të tij ka mundur të rregullojë aspektet kryesore të realizimit të objektit mbi të cilën shtrihet veprimtaria e arkeologjisë shqiptare.

Referuar në rang hierarkik, aktet kryesore të cilat përbëjnë bazën e legjislacionit shqiptar dhe që rregullojnë realizimin e objektit të arkeologjisë, janë: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodi Civil, ligji specifik, si dhe strategji apo nisma të ndërmarra nga organet kompetente ligjzbatuese në këtë fushë. Le të trajtojmë secilën prej tyre:

▪ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Akti ligjor më i rëndësishëm në hierarkinë e rendit kushtetues në Republikën e Shqipërisë prej nga burojnë dhe marrin jetë më pas një sërë aktesh të tjera, që është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet dispozitave të saj i ka dhënë vend dhe e ka parashikuar rolin e trashëgimisë kulturore për shtetin e pavarur shqiptar. Kjo shpreh në mënyrë të qartë rëndësinë dhe mbrojtjen që i jepet këtij instituti në vendin tonë. Duke cituar disa prej këtyre dispozitave shohim se:

Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: *"Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe*

bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë."

Neni 8 citon: *"1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj..... Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare."*

Ndërsa në kreun 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohen objektivat social të shtetit shqiptar, ndër të tjera, **në nenin 59** citohet se: *"1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe....."*⁶.

Referuar këtyre parashikimeve shohim së ndër bazat e funksionimit, ekzistencës dhe organizimit të shtetit shqiptar, ndër të tjera renditet edhe trashëgimia kombëtare, çka tregon pozicionin e saj të rëndësishëm që merr ajo për shtetin tonë. Gjithashtu nga këto dispozita evidentojmë qartë rëndësinë që i është kushtuar zhvillimit dhe mbrojtjes të trashëgimisë kulturore nëpërmjet nismave dhe mjeteve ndihmëse që shteti disponon.

▪ Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"

Ndonëse i miratuar relativisht vonë për historinë e zhvillimit të shkencës së arkeologjisë në vendin tonë, legjislatori me anë të ligjit specifik nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" arriti të plotësojë vakumin ligjor që ekzistonte prej vitesh në këtë drejtim. Miratimi dhe hyrja në fuqi e një ligji të tillë, luan rol të jashtëzakonshëm jo vetëm në parandalimin e shkeljeve që mund të jenë të pranishme për objektet e saj⁷, por gjithashtu luan edhe funksion mbrojtës nëpërmjet parashikimeve, rregullimeve apo specifikimeve të posaçme⁸ që kërkohen për realizimin e kësaj veprimtarie specifike, duke mos lënë vend për rezerva ligjore apo abuzime të çdolloj natyre.

⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar, 2017, neni 59.

^{7 7} Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 133- Veprimtaria Arkeologjike, neni 136 kërkon patjetër licencën për subjektet që realizojnë veprimtari arkeologjike.

⁸ Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 133- Veprimtaria Arkeologjike.

➤ Funksioni parandalues

Nga analizimi i detajuar i dispozitave të poshtëshënuara në ligjin nr. Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", mund të evidentojmë funksionin parandalues që luan ai mbi veprimtarinë arkeologjike, të cilat nuk lëne vend për devijime në zbatimin e tyre.

Neni 260 - Kundërvajtjet administrative të lidhura me hulumtimet arkeologjike dhe gjetjet

"Kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 4 000 000 lekë: a) gërmimi i paautorizuar,.....b) kryerja e veprimtarisë arkeologjike nga subjekte të palicencuara, në kundërshtim me parashikimet e nenit 136 të këtij ligji; c) kryerja e veprimtarisë arkeologjike nga subjekte të licencuara ose çdo subjekt tjetër në kundërshtim me parashikimet e nenit 139 të këtij ligji; ç) mosdeklarimet ose mosruajtja e gjetjeve në përputhje me nenin 145 të këtij ligji; d) mosruajtja e gjetjeve rastësore nga ana e personit dhe drejtuesit teknik, që i kanë konstatuar gjetjet, deri në momentin e vendimit të KKTKM-së, në zbatim të parashikimeve të nenit 145 të këtij ligji. dh) mosraportimi në organet kompetente dhe mosruajtja e përkohshme e gjetjeve rastësore në territor, në kuptim të nenit 146 të këtij ligji".

➤ Funksioni mbrojtës

Neni 132- Pasuria kulturore arkeologjike

"Objekte arkeologjike janë të gjitha objektet e luajtshme e të paluajtshme të veprimtarisë njerëzore të epokave të kaluara, mbi 100 vjet, të vendosura mbi dhe nën shtresat e tokës dhe nën ujëra, për të cilat burim informacioni janë hulumtimet dhe kërkimet arkeologjike".

Neni 133/6- Veprimtaria arkeologjike

"Hulumtimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë ekskluzivitet i institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore ose subjekteve të licencuara sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat që hartohen nga institucionet e specializuara shtetërore. Procedura për hulumtimet arkeologjike rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të IKTK-së".

Neni 136- Licencat për veprimtarinë arkeologjike

"1. Veprimtaria arkeologjike kryhet nga institucionet e specializuara, për shkak të funksionit të tyre të parashikuar në këtë ligj, nga persona fizikë ose juridikë të licencuar për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji....."

Neni 139- Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike

"1. Institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara mund të kryejnë hulumtime arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike vetëm pas marrjes së lejes nga KKTKM-ja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij....."

❖ Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Ndër masat e tjera me karakter mbrojtës që legjislatori ka ndërmarrë për mbrojtjen e arkeologjisë në Shqipëri, është edhe ngritja dhe funksionimi i institucionit të **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore**⁹, i cili u formua nga bashkimi i dy institucioneve të mëparshme në varësi të Ministrisë së Kulturës, përkatësisht nga Instituti Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale. Ajo ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, harton kriteret e hulumtimeve arkeologjike, shqyrton dokumentacionin teknik në lidhje me to, si dhe kryen mbikëqyrjen e proceseve arkeologjike dhe ecurisë së projekteve zhvillimore, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale.

Në mbështetje të informacionit të siguruar nga veprimtaria e tij, nga institucionet e specializuara që kryejnë veprimtari të kërkimit arkeologjik, si

⁹ Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i krijuar nga Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe

Muzetë", dhe Vendimi Nr. 364, datë 29.5.2019 "Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore".

dhe nga subjektet e licencuara në fushën e arkeologjisë, harton, përditëson dhe publikon platformën digjitale për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë. Institucionet dhe subjektet e sipërpërmendura kanë detyrimin të depozitojnë, rregullisht, pranë IKTK-së të dhënat në formën digjitale, pas çdo aktiviteti nga veprimtaria e kërkimit arkeologjik¹⁰.

IKTK-ja, në përmbushje të funksioneve të veta, monitoron dhe bashkërendon punën me drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet publike dhe private, vendase apo të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale. Pranë IKTK-së funksionon Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim (QRKR), që kryen këto funksione:

1. a) formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
2. b) harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

IKTK-ja funksionon në bazë të dispozitave të këtij ligji, si dhe statutit të miratuar me urdhr të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

▪ **Strategjia Kombëtare për kulturën 2019-2025** nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë

Ndërsa, ndër reformat dhe nismat institucionale të ndërmarra nga ana e shtetit shqiptar, mund të përmendim **Strategjinë Kombëtare për kulturën 2019-2025, miratuar** nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, qëllimet e së cilës janë:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore.
- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore.
- Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të
- Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë

(materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira.

- Promovimi i vlerave të artit, trashëgimisë kulturore dhe fondeve muzeore.
- Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike.
- Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike.
- Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar.
- Zhvillimi i audiencave¹¹.

5. Legjislacioni ndërkombëtar mbi mbrojtjen e arkeologjisë

Duke njohur faktin që trashëgimia kulturore dhe veprimtaria arkeologjike, e cila është dëshmi e qartë e historisë së lashtë e historisë njerëzore, shtete të shumta në botë kanë ndërmarrë nisma për krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit apo miratimit të akteve të ndryshme me rëndësi ndërshtetërore në mbrojtje të këtyre zhvillimeve arkeologjike.

Europa, si një ndër kontinentet më të vjetër në botë, e përbërë nga shtet, të cilat pothuajse të gjitha mbartin pasuri të zbulimeve arkeologjike të lashta në kohë, i ka kushtuar rëndësi të madhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore, sidomos nëpërmjet miratimit të akteve ligjore me rëndësi ndërkombëtare në fushën e arkeologjisë.

Me qëllim krijimin e një të drejte me fuqi ndërkombëtare, shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe Shtetet e tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane, nënshkrues të kësaj kanë miratuar "Konventën Europiane Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore".

Sipas kësaj Konvente Arkeologjia dhe zbulimet e saj përfaqësohen nga objekte të cilat rrezikohen seriozisht nga shkatërrimet në kohë, për shkak të numrit në rritje të skemave të mëdha planizuese, rreziqeve natyrore, gërmimeve të paligjshme dhe joshkencore dhe ndërgjegjësimi publik të

¹⁰ Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 29.

¹¹ <https://www.kultura.gov.al/programi-i-kultures-2019-2025/>

pamjaftueshëm¹². Për këtë arsye, ka lindur nevoja të zhvillohen procedura mbikëqyrjeje të përshtatshme administrative dhe shkencore nga ana e çdo shteti përkatës dhe se nevoja për të mbrojtur trashëgiminë arkeologjike duhet reflektuar në planifikimin dhe në politikat e zhvillimit të kulturës globale.

Duke theksuar se përgjegjësia për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike nuk duhet të jetë vetëm i shtetit drejtpërdrejt të interesuar, por i të gjitha vendeve në botë, ku qëllimi është zvogëlimi i rrezikut të shkatërrimeve dhe promovimi i konservimit, nëpërmjet nxitjes së shkëmbimeve të ekspertëve dhe krahasimit të përvojave, janë miratuar një sërë aktesh me fuqi ndërkombëtare, të tilla si:

- Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike, nënshkruar në Londër, më 6 maj 1969¹³;
- Konventa Kulturore Europiane, e nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954;
- Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturore të Europës, nënshkruar në Granada, më 3 tetor 1958;
- Konventa Europiane mbi veprat penale në lidhje me pasurinë kulturore, nënshkruar në Delfi, më 23 qershor 1985;
- Rekomandimet e Asamblesë Parlamentare mbi arkeologjinë dhe në veçanti rekomandimet 848 (1978), 921 (1981) dhe 1072 (1988);
- Rekomandimet nr. R (89) 5, në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë arkeologjike, në kuadër të operacioneve planifikuese të qytetit dhe fshatit;

Duke qenë se trashëgimia kulturore është vlerë e përbashkët e njerëzimit, përveç aspektit ligjor, në nivel ndërkombëtar me qëllim mbrojtjen e kësaj vlere të përbashkët të njerëzimit, janë krijuar disa organizma me shtrirje dhe fuqi ndërshtetërore, të cilat ndër të tjera, në objektin e veprimtarisë së tyre kanë si qëllim kryesor edhe mbrojtjen apo zhvillimin e trashëgimisë kulturore botërore, të tilla si:

¹² "Konventa Europiane Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore", Hyrje.

¹³ Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë nëpërmjet ligjit nr. 9806, datë 17.9.2007 Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane "Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike" (të rishikuar)

➤ Këshilli i Europës

Qëllimi i krijimit dhe organizimit të Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me synim, veçanërisht mbrojtjen dhe përmbushjen e idealeve dhe parimeve, të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët. Një komitet ekspertësh, i ngritur nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, bazuar në nenin 17 të Statutit të Këshillit të Europës, monitoron zbatimin e Konventës (të rishikuar) dhe veçanërisht:

i) raporton në mënyrë periodike te Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mbi gjendjen e politikave për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike në Shtetet Palë të Konventës (të rishikuar) dhe mbi zbatimin e parimeve të mishëruara në Konventë (të rishikuar);

ii) i propozon Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës masa për zbatimin e dispozitave të Konventës (të rishikuar), duke përfshirë veprimtaritë shumëpalëshe, rishikimin apo amendimin e Konventës (të rishikuar) dhe informimin e opinionit publik rreth qëllimit të Konventës (të rishikuar);

iii) i bën rekomandime Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në lidhje me ftesat për shtetet, të cilat nuk janë anëtare të Këshillit të Europës për të hyrë në Konventë (të rishikuar)¹⁴.

➤ OKB

Organizata e Kombeve të Bashkuara ose ndryshe OKB, është themeluar pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim forcimin e bashkëpunimit midis shteteve të botës, zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e paqes në botë. OKB është organizata më e madhe në botë e cila për qëllim ka sigurinë ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale. Ajo u formua në vitin 1945 me iniciativën e shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore (ShBA, Kina, Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Franca).

Ndër strukturat kryesore të funksionimit të saj, ndër të tjera¹⁵ përmendim **Këshillin Ekonomik dhe Social**, i cili është përgjegjës për problemet ekonomike, sociale, kulturore, humanitare për të

¹⁴ Konventa Europiane "Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike" (e rishikuar), neni 13.

¹⁵ Organet kryesore përbërëse të funksionimit të OKB-së janë: Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Nju Jork; Këshilli i Sigurimit të OKB-së në Gjenevë; Këshilli i Mirëbesimit i OKB-së; Sekretariati i OKB-së; Gjykata Ndërkombëtare e

gjithë komunitetin botëror. Veprimtaria e tij zhvillohet për vendet më pak të zhvilluara përmes organeve të specializuara të OKB, si: UNDP (Program për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara), UNHCR (Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët), UNICEF (Fondacioni Ndërkombëtar i Fëmijëve në nevojë) dhe **UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën e Kulturën).**

➤ UNESCO

Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO)¹⁶ është një agjensi e specializuar e Kombeve të Bashkuara, e themeluar më 16 nëntor 1945, me seli në Paris, me mbi 50 zyra në terren dhe shumë institucione të specializuara dhe qendra në të gjithë botën. Qëllimi i kësaj organizate është të kontribuojë për paqen dhe sigurinë në botë duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes arsimit, shkencës dhe kulturës.

UNESCO ndjek objektivat e saj nëpërmjet pesë programeve të mëdha: arsim, kulturë, shkenca natyrore, shkenca sociale dhe shkenca e njeriut, komunikimi dhe informacioni. Projekte të sponsorizuara nga UNESCO përfshijnë programet ndërkombëtare shkencore, projektet rajonale dhe kulturore historike, avancimin e kulturës; marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar për të siguruar në botë trashëgiminë kulturore dhe trashëgimimë natyrore, si dhe për të ruajtur të drejtat e njeriut.

Edhe pse një vend i vogël për nga popullsia dhe sipërfaqja, Shqipëria njihet për pasuritë e saj të shumta natyrore, shpirtërore dhe kulturore, të cilat UNESCO i ka pozicionuar në listat e vendeve të trashëgimisë botërore¹⁷. Lista mirëmbahet nga Programi i Trashëgimisë Botërore ndërkombëtar i administruar nga **Komisioni i Trashëgimisë Botërore i UNESCO**, i përbërë nga 21 shtete anëtare të UNESCO-s. Këtu përmenden pasuritë kombëtare shqiptare, të tilla si:

- Butrinti

U shpall si Vend i Trashëgimisë Botërore nga UNESCO në vitin 1992.

- Gjirokastra

I njohur si një nga vendet e shpallura Trashëgimi Botërore e UNESCO-s, ky qytet i veçantë është ndërtuar në shpatet e pjerrëta, me shtëpitë prej guri, në rrugët me kalldrëm të këtij qyteti ku gjendet kalaja më e vjetër e gjithë Ballkanit.

- Berati

Është arkitektura e veçantë e qytetit që e ka pozicionuar Beratin si një nga vendet e Trashëgimisë Botërore UNESCO në Shqipëri.

- Kodikët e Beratit¹⁸

Vlen të përmenden këtu këto dorëshkrime me rëndësi të veçantë historike për fillimet e letërsisë biblike të cilat quhen zyrtarisht "Kodiku i Purpurt i Beratit."¹⁹

- Liqeni i Ohrit

Me një thellësi prej 285 m, Liqeni i Ohrit është më i thelli në Ballkan dhe lag në pjesën më të madhe të tij Maqedoninë (Ohër, Strugë), dhe Pogradecin në Shqipëri. "Liqeni i dritës" u shpall pasuri natyrore nga UNESCO në vitin 1980 dhe, që prej korrikut të vitit 2019, është pjesë e listës së UNESCO-s edhe pjesa shqiptare e liqenit.

- Lumi i Gashit

Lumi i Gashit është një prej dy rezervateve natyrore shqiptare të pëfshirë në listën e trashëgimisë botërore të natyrës të UNESCO-s.

- Rrajca

E dyta në listën e trashëgimisë botërore të natyrës të UNESCO-s është Rrajca, pjesë e European Green Belt të pyjeve të ahut si edhe një prej vendeve të pakta ku gjendet rrëqebulli ballkanik.

6. Konkluzione

Në kuadër të mbrojtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore në Shqipërisë, sfida kryesore lidhet me përmirësimin e kuadrit ligjor, nismave institucionale dhe aspekteve rregullatore në mënyrë që kjo fushë të reflektojë situatën aktuale, si dhe të çojë në krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin e sektorit të

Drejtësisë në Hagë dhe Këshilli Ekonomik e Social.

¹⁶ United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization.

¹⁷ **Vend i Trashëgimisë Botërore** është një vend (siç është një ndërtesë, qytet, kompleks, shkretëtirë, pyll, ishull, liqeni, monument, ose mal) i cili është listuar nga Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të

Bashkuara (UNESCO) si i një rëndësie të veçantë kulturore ose fizike.

¹⁸ Dy kodikët e Beratit, të botuar në vitin 1887, janë pjesë e grupit të "shtatë kodikëve të purpurt" të shkruar në 13 vende të ndryshme në Europë midis shekullit VI-të dhe VIII-të.

¹⁹ Kodiku u regjistrua në listën e veprave më të rëndësishme të njerëzimit, të ashtu quajturën Kujtesën e Botës të UNESCO-s, në vitin 2005.

arkeologjisë si degë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të vendit.

Në mënyrë specifike, duhet të rishikohen aspektet menaxhuese dhe bashkërenduese të institucioneve dhe organizatave të lidhura me funksionimin e arkeologjisë, si Ministria e Mirëqenies Kulturës dhe njësitë e qeverisjeve vendore të çdo qyteti, në mënyrë që ata të jenë sa më gjithëpërfshirës për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e kësaj dege apo për mbrojtjen e saj. Duhet të punohet me qëllim bashkërendimin e përpjekjeve në nivel qendror dhe vendor në lidhje me parandalimin e abuzimeve dhe krijimin e nismave zhvilluese.

Një tjetër sfidë përbën krijimi i një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe institucional mbështetës për njësitë e qeverisjes vendore në mënyrë që ato të krijojnë kushte favorizuese dhe të zhvillojnë programe me natyrë kërkimi për të përmbushur zhvillimin e mëtejshëm të kësaj dege.

Ligji i ri shqiptar Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" ka marrë vlerësime pozitive nga ana e partnerëve ndërkombëtarë në këtë drejtim. Përmbajtja e tij pasqyron se kemi të bëjmë me një kuadër ligjor solid dhe përparimtar. Mirëpo, një vend si Shqipëria më së shumti problematikën nuk e shfaq tek ligji në përmbajtje, por tek zbatimi i tij. Të ecësh paralelisht me zbatimin e ligjit i mundëson strukturave kryesore të marrin masat për zbatimin konkret të tij edhe në praktikë, pasi arkeologjia dhe zhvillimi i saj mund të mbështetet dhe të realizohet vetëm me aspekte të lidhura me praktikën e zhvillimit të kërkimeve.

7. Literatura

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017;*
- *Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), 1950;*
- *Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike, nënshkruar në Londër, më 6 maj 1969;*
- *Konventa Kulturore Europiane, e nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954;*
- *Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturore të Europës, nënshkruar në Granada, më 3 tetor 1958;*
- *Konventa Europiane mbi veprat penale në lidhje me pasurinë kulturore, nënshkruar në Delfi, më 23 qershor 1985;*
- *Ligji nr. 9806, datë 17.9.2007 Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane "Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike" (të rishikuar);*
- *Ligji nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";*
- *Vendim Nr. 364, datë 29.5.2019 "Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore";*
- *Rekomandimet e Asamblesë Parlamentare mbi arkeologjinë dhe në veçanti rekomandimet 848 (1978), 921 (1981) dhe 1072 (1988);*
- *Rekomandimet nr. R (89) 5, në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë arkeologjike, në kuadër të operacioneve planifikuese të qytetit dhe fshatit;*
- *Cultural heritage policy - history and resources Getty Museum - list of major international cultural heritage documents, charters, and treaties;*
- *UNESCO World Heritage Centre – Official website of the United Nations cultural heritage body*
- *International Council on Monuments and Sites;*
- *International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property;*
- *Inventory of Heritage Organisations in Europe (English, French, German and Dutch language);*
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar (1985);*
- *Ceka, N., & Korkuti.M., "Arkeologjia", Tiranë 1998;*
- *<https://iktk.gov.al/site/>- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.*
- *Prendi Frano-Bunguri Adem, Studime mbi Prehistorinë e Shqipërisë, viti 2014*
- *Prendi Frano-Bunguri Adem, Studies in the Prehistory of Albania, Tiranë 2018*

GJUHËSI-ALBANOLOGJI

Karakterizimi i personazheve kadareane përmes regjistrave gjuhësorë e stilistikorë

Dr. Ermira Ymeraj

ermira.ymeraj@unishk.edu.al

Prof.Dr. Klodeta Dibra

klodeta.dibra@unitir.edu.al

Abstract

Characterization of Kadarean characters through linguistic and stylistic registers

The work of Kadare is a linguistic universe that reveals an entire psychological world and artistically enlivens the mentality of the Albanian people. His word creation is original, universal, and unparalleled among other writers. Our analysis will focus on the linguistic and stylistic registers of the main characters in Kadare's novels such as "The Palace of Dreams," "Broken April," "The Three-Arched Bridge," to examine their language, which appears as lexical richness, lexeme wealth, expansion through neologisms, use of figurative language, as well as a narrative tint of the ethnography of speech expressed in the character's language, gender, origin, culture, revealing the spiritual wealth of the Albanian language.

Most notably, we will scrutinize the linguistic registers in function of the psychology of the characters or extralinguistic elements that are obtained and influence their relationships, especially in modeling the language according to the situation. This more clearly demonstrates the relationship between the Kadarean language and the ethnopsychology of the Albanian, deepening our understanding of Kadare's stylistic mastery and the diversity of its nuances through a natural syntax. The crafting of sentences, idiomatic expressions, and phrases reflects a language with new forms.

Key words: *linguistic register, stylistic register, characters, culture, mentality, lexical richness*

Abstrakt

Vepra e Kadaresë është një univers ligjërimit që zbulon një botë të tërë psikologjike dhe jetësor artistikisht me shumë ndjenjë mendësinë e shqiptarit. Fjalëkrijimi i tij është origjinal, i

gjithëkohshëm dhe i pa ndeshur ndër shkrimtarët e tjerë. Punimi ynë do të ndalet në regjistrat gjuhësorë e stilistikorë të personazheve kryesore të romaneve kadareane "Pallati i ëndrrave", "Prilli i thyer", "Ura me tri harqe" dhe, për të analizuar gjuhën e tyre që vjen si begati leksikore, pasuri leksemash, zgjerim përmes neologjizmave, përdorimi i figurshëm, si edhe si ngjyrim ligjërimit i etnografisë së të folurit që shprehet në marrëdhëniet e vetë gjuhës me mendësinë e personazhit, gjininë e tij, prejardhjen, kulturën, duke zbuluar kështu pasurinë shpirtërore të shqipes.

Fjalë kyç: *regjistër gjuhësor, regjistër stilistik, personazhe, kulturë, mentalitet, pasuri leksikore*

Hyrje: Gjatë punimit do të shqyrtojmë regjistrat gjuhësorë në funksion të psikologjisë së personazhit apo të elementeve jashtëgjuhësorë që përftohen e ndikojnë në marrëdhëniet mes tyre, e posaçërisht në modelimin e gjuhës sipas situatës, (regjistri do të varet nga konteksti i tekstit), që sjell më dukshëm marrëdhënien e gjuhës kadareane me etnopsikologjinë e shqiptarit, na thëllon në njohjen e mjeshtërisë stilistikore të Kadaresë, larminë e ngjyimeve të saj përmes një sintakse të natyrshme. Variacionet gjuhësore komplekse dhe me nuanca të ndryshme të Kadareja si narrator, ndryshojnë përgjatë përdorimit sipas përkatësisë sociale, kontekstit të komunikimit dhe shprehjes personale. Prandaj, regjistri gjuhësor i personazheve për lexuesin është një variacion gjuhësor që tregon nivelin e formalitetit dhe të marrëdhënieve që narratori vendos mes tij si folës dhe lexuesit (për t'a futur brenda komplotit të veprës), temës, qëllimit dhe vendodhjes, këto katër elemente ndikojnë në modifikimin e regjistrit gjuhësor. Kadare është shkrimtari që

flet bukur (1) e thellë dhe kjo është një e dhënë estetike që vlen për prozën dhe vetë fjalësin e shqipes të cilën ai e pasuron së pari përmes formimit parashtesor e prapashtesor, prej ku zë fill një leksik i veçantë kadarean.

Diskutimi: Kadare te "Pallati i Ëndrrave" zgjedh të kodojë e të kalojë ndërmjet regjistrave të shumtë për efekt letrar. Vetë përpunimi i thënieve, frazeologjive, shprehjeve idiomatike janë pasqyrë e një gjuhë me trajta të reja. Ndërrimi i regjistrit të personazhi Mark-Alem kur flet, apo kur flitet për të është një formë e ndërrimit të kodeve, të cilat i identifikojmë duke parë **zgjedhjet e drejtshkrimit, gramatikës dhe fjalorit**.

Kadare është shkrimtari që përdor teknika të ndryshme për të përcjellë regjistrin gjuhësor të Mark - Alemit, dhe në aspektin sociolinguistik (2), na lejon të kuptojmë mënyrën se si përdoret gjuha në kontekste të ndryshme shoqërore dhe se si ajo formësohet nga faktorët socialë dhe kulturorë, duke fituar njohuri për marrëdhëniet e gjuhës me shoqërinë, për të përcjellë fuqinë, identitetin dhe kuptimin, përkundër vetë përdorimit gramatikor që na tregon se sa formal apo joformal është e folura e personazheve, ndërsa shenjat e pikësimit të përdorura ndikojnë në ndryshimin e tonit. *Pikëçuditësja* (3) e bën Mark - Alemin të duket i emocionuar aty në Tabir - Saraj. *Elipsa* (4) e vetë Mark - Alemit, sugjeron zhgënjimin e tij. *Pikëpyetja* (5) që është shenja e pikësimit më e përdorur nga Kadare në të folurën e personazheve konsiderohet si gërryeje, frikë, kërshtëri, tepri. *Pika* si shenjë në shumë fjali konsiderohet neutrale.

Mbi gjuhën e narratorit dhe personazheve, do të vëzhgojmë dhe veçojmë mënyrat e zgjerimit dhe pasurimit të gjuhës.

Pyetje hulumtuese: **A ndikon gjendja e trazuar emocionale në ndryshimin e regjistrin gjuhësor?**

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e lidhur me figurën (karakterin) dhe gjuhën. Figura - personazh ndërtohet sipas logjikës e bashkimit zinxhir të çdo fjale, çdo veprimi, çdo mendimi. Kadareja krijon një sistem të ri, mjaft të pasur të mekanizmit të figures (6). Ndërsa "gjuha është një visar, një repertor mundësish." (7)

Personazhet shihen nga lexuesi, dhe kjo lidhet me kodin e autorit, si tërësi kombinimesh midis lëndës gjuhësore dhe aftësive imagjinare, kjo lidhet edhe me kodin personal të lexuesit, me aftësitë e tij përfytyruese, me situatën

emocionale, me momentin e leximit të romanit (8).

Kodi përcakton rregullat e komunikimit, vetë rendi i paraqitjes së këtyre kodeve do të rrëfejë diçka (9).

Në tabelën e mëposhtme Mark-Alemi është në tri gjendje të ndryshme emocionale, secila prej tyre zbulon regjistrin gjuhësor ironik, alegoriko-simbolik dhe joformal.

Përballë vetes.

Kishte përshtypjen që në fytyrë e kishte ende nënqeshjen shpotitëse, me të cilën i qe dukur se ishte zgjuar atë mëngjes. Ishte ngritur nga gjumi për t'u nisur me ngut në Tabir - Saraj, zyrat e famshme që merreshin me gjumin dhe ëndrrat, dhe kjo mjaftonte që cilitdo në vendin e tij, bashkë me hutinë, t'i shkaktohej ajo nënqeshje. Kishte qenë nata e tij e fundit kur kishte shijuar gjumin e mirëfilltë njerëzor. Këndeje e tutje, gjithçka do të ishte ndryshe. Ishte gjithsesi e çuditshme, veçse ai kishte shumë ankth për të nënqeshur vërtet. (f. 262).

Në atë çast nisi të ndodhte diçka që Mark Alemit po i dukej e tmerrshme, madje më tepër se kaq, ishte një lloj llahtarje e gropshme e ngjashme me atë që shkaktohej prej lëkundjeve të tokës...kishte humbur shpresën....do të parazbulonte diçka Mënyra e njëtrajtshme e tmerroi Mark Alemin...ishte gati të thërriste "Mjaft, nuk dua të hyj në punë"...klithma e tij e brendshme u ndërpre ... mori frymë thellë, lehtësimi ishte i parakohshëm ... nuk ishte mirë me nervat kohët e fundit... për herë të parë vështroi me guxim sytë e një njeriu tjetër ... Mark Alemin ishte rrëqethur para kohe përpara këtij nëpunësi...lëkura e fytyrës së tij ishte e aftë të pille madje edhe një buzëqeshje, sikur të mos ndodhte diçka mizorisht e papritur...Mark Alemin u drodh ... zyrtari bëri një hap drejt prushanës dhe i hodhi copat e saj drejt në të...nuk dinte ç'të bënte, të rrinte ende aty, të ikte në çast, të zemërohej, apo të kërkonte ndjesë ... Mark Alemin dëgjonte i mahnitur fjalët e nëpunësit të lartë. (f. 269).

Përballë ngrehinës.

Mark Alemin i erdhi rrotull një sheshi gjysmë të shkretë, ku ngrihej një xhami me dy minaret, çuditërisht të holla. Ngrehinës së madhe të dy krahët i humbisnin në sqotë, kurse pjesa e saj qendrore ishte e tërhequr përbrenda, sikur të qe zmbursur përpara diçkaje. Mark Alemin ndjeu ankthin t'i rritej me shpejtësi përbrenda. Një rresht i gjatë hyrjesh ngriheshin të barabarta përkaj njëra tjetrës, por, kur Mark Alemin u afrua, pa se ato

nuk ishin hyrje, por flegra të lagura, të përhapura prej kohësh. (f. 263)

Hyri në një mesore të ftohtë (qerthulli i ferrit), sipërfundi jashtëzakonisht i lartë i së cilës e bënte të dukej si një fund grope. Nga të gjitha anët kishte dyer ... prapa një qelqnaje dalloj më në fund njerëz ... mbanin ca veshje me ngjyrë të kaltër të zbehtë, të përafërt me ngjyrën e kulmoreve të pallatit ... (f. 264).

Ky pallati i ëndrrave nuk është ëndërr, por një nga bazat e shtetit. Këtu më mire se nga çdo hulumtim, (ndryshim regjistri të narratorit), procesverbal, kumtesë ose raport policie apo guvernatorësh të pashallëqeve, kuptohet gjendja e vërtetë e Perandorisë. Sepse, në kontinentin e përnatshëm të gjumit gjenden drita dhe terri i njerëzimit, mjalti dhe helmi, madhështia dhe mjerimi i tij. Gjithçka që është e turbullt dhe e rrezikshme, apo që do të jetë e tillë pas disa vitesh apo pas disa shekujsh, e jep shestimin e parë në ëndrrën e njeriut. Asnjë pasion apo mendim i mbrapshtë, rrebesh apo katastrofë, rebelim apo krim, nuk është e mundur të mos dërgojë hijen e vet shumë kohë më parë se të shfaqet a vetë në botë. (f. 274) Shumë njerëz dhe shumë rryma kanë dashur të depërtojnë këtu, por Tabir Saraji s'ka rënë kurrë në grackë. I vetmuar, ai qëndron midis zallahisë njerëzore, i veçuar, jashtë krahamave dhe grindjeve për pushtet, i mbyllur, për këdo dhe i papërzier me askënd. Kjo s'është porosi. Ky është urdhri i madh i Tabir Sarajit. (f. 275)

Përballë Fisit

Mesorja ishte e gjatë dhe e zyrtë. Dyert dilnin në të me dhjetra, të larta dhe pa numra ... Dreqi ta marrë, tha me vete. Ndërmend solli shtëpinë e tij të madhe në Rrugën Mbretërore, fisin e tij të fuqishëm që mbledhesh shpesh pasdarke në dhomën e madhe të miqve. Atë ditë, para se të hynte në dhomën e bukës, ishte futur në kthinën e madhe të bibliotekës, sixhadja ngjyrë qielli e së cilës kishte qenë përherë qetësuese për ankthet...në mbulesën e së cilës, nën një "Q" të madhe të praruar ishte shkruar "Qyprillinjte denbabaden". Nën të, me një shkrim të lakuar si prej dore ojnatare, nga ato që unazat e shumta e pengojnë të mbajnë penën, ishte shkruar fjala frënge "Cronique". (f. 265).

Shkrimtari realizon me shumë mjeshtëri përdorimin e regjistrit ironik, përmes përzgjedhjes së fjalëve, që përshkallëzohet deri në ankth, duke përmbysur gjendjen emocionale të personazhit Mark -Alem. **Ironi** (nënqeshje shpotitëse) - **Ankth** (humbje e nënqeshjes).

Përdorimi i dy enumeracioneve shpreh qartë gjendjen e trazuar emocionale e psikologjike të Mark Alemit, duke i ndërruar kështu edhe

regjistrin nga ironik në simbolik: *e tmerrshme – llahtari // rrëqethur – u drodh*.

Si nga jashtë ashtu edhe nga brenda, Pallati shkaktonte te Mark - Alemi gjendje angështie, që shoqërohet me ndërrim dhe përzgjedhje fjalësh e njëkohësisht dhe me një regjistër tjetër të të folurit. Mjafton përzgjedhja e fjalëve që shkrimtari bën për të kuptuar trazimin e brendshëm psikologjik të personazhit: sheshi i gjysmëshkretë, krahët që *humbisinin*, pjesa qendrore e *zmbropsur*, pra, një mjedis aspak miqësor që i shton ankthin edhe më shumë personazhit. **Në brendësi:** një mesore e ftohtë, sipërfundi i lartë, veshje ngjyrë të kaltër të zbehtë, çiftet antonimike (*dritë-terr // mjaltë-helm // madhështi-mjerim*, çiftet sinonimike: *rrebesh-katastrofë // rebelim-krim*, krijojnë një atmosferë, sa të zymtë aq dhe të ankthshme që ndikon dhe në sasinë e fjalëve që përdor Mark-Alemi.

Interes përbën ndërkallja e informacionit dhe vendosjes përballë dy mjedisëve që lidhen ngushtësisht me regjistrin gjuhësor të Mark-Alemit, **Pallati-Shtëpia**. Me nota dramatike, shkrimtari i vë përballë këto dy mjediset, shtëpia e Vezirit (xhaxhait të Mark-Alemit) është:

shtëpi e madhe, që gjendet në *Rrugën Mbretërore*, *fis i fuqishëm*, *dhomë e madhe e miqve*, *dhoma e bukës*, *kthina e madhe e bibliotekës*, *sixhadja qetësuese*, "*Q*"-ja e praruar, shkrimi "*Qyprillinj denbabaden*", fjala frënge "*Cronique*", duke e vënë përpara një alternative personazhin:

Po ç'dreqi të solli te Pallati i hirtë e i zyrtë?

Shumë njerëz dhe shumë rryma kanë dashur të depërtojnë këtu, por Tabir - Saraji s'ka rënë kurrë në grackë. **I vetmuar**, ai qëndron midis *zallahisë* njerëzore, **i veçuar**, jashtë *krahamave* dhe grindjeve për pushtet, **i mbyllur**, për këdo dhe **i papërzier** me askënd. Kjo s'është porosi. Ky është urdhri i madh i Tabir - Sarajit (10).

Vetë Pallati përmes analogjisë do të vizatohet si një hyrje në Ferr, pamja e zyrtë shoqërohet me një regjistër të lartë simbolik, Kadare me katër mbiemra na e shfaq Tabir - Sarajin një institucion: **të vetmuar – të veçuar – të mbyllur – të papërzier** (11). Kur forcat lëvizëse vihen përballë dhe nis përleshja midis dy mjedisëve, nis dhe përleshja edhe në stil, ritmi shpejtohet në kulm, lëvizjet shpejtohen, situata gjithashtu, tablotë, karakteret ndeshen. Stili në këto raste është telegrafik, nuk kemi fraza por fjali. Gjuha shpreh kështu mendim, botëkuptimin e karakterit, idealin që e shtyn të bëjë një veprim. Përdorimi i fjalës 'xhybe' (12), si shprehje e **elementit kulturor**, ndikon në krijimin e një regjistri të ri gjuhësor. Shprehja e habitës por

edhe pakënaqësisë së Mark-Alemit (*O Zot, ende me këtë veshje!*), kujtojmë se 'xhybja' është një veshje e gjatë deri afër këmbëve, që e mbajnë disa popuj të Lindjes dhe hoxhallarët e dervishët, këtu në roman perceptohet si një ironi e hollë e Mark-Alemit, dhe si përdorim i regjistrit folklorik.

Kadare njihet si shkrimtar që zgjedh regjistrin gjuhësor të lartë e të përpunuar nga pikëpamja sintaksore, ndryshe i quajtur regjistër i lartë gjuhësor. Tek "Pallati i Ëndrrave" ndeshim sintaksën e thjeshtë, siç edhe atë shumë komplekse. Aftësia e Kadaresë qëndron te ruajtja me shumë kujdes e *Kohezionit* dhe e *Koherencës* të fjalisë apo periudhës brenda vetes, por edhe me paratekstin dhe pastekstin.

(1) *Kati i parë nga e djathta, dera njëmbëdhjetë (f. 4) // Megjithatë këtu nis gjithçka. Këtu... (f. 19) // Dukesh. (f. 24).*

(2) *Ndërsa vazhdonte të bënte të njëjtën gjë me fletët e tjera, ndiente një gëzim hakmarrës për ata trutharë të panjohur që, të sëmurë nga barku apo dhëmbët e prishur, e kishin munduar dy ditë me ëndrrat e tyre të marra, të cilat, ndoshta, as i kishin parë fare, por i kishin dëgjuar nga të tjerët.*

(3) *Atje flitej për ndjekje të hatashme nëpër bjeshkë, për dyluftime, rrëmbime vajzash e grash, karvanë dasmorësh që udhëtojnë drejt dasmash të rrezikshme, krushq të ngrirë e të kthyer në gur, sepse kanë bërë faj gjatë ecjes, kuaj të dehur me verë, kreshnikë të verbuar tradhtisht mbi kuaj, gjithashtu të verbër, që enden bjeshkëve si në makth, qyqe që paralajmërojnë fatkeqësi, trokitje në porta të çuditshme, thirrje në dyluftim makabër e të gjallit ndaj të vdekurit, tek i vërtitet mbi varr me dyqind qen, rënkimet e këtij të fundit që s'ngrihet dot nga gropa për t'u ndeshur me armikun, njerëz e hyjni të përzier bashkë, që zemërohen, goditen, martohen me njëri tjetrin, klithma, kacafytje, mallkime ngjethëse dhe, mbi të gjitha këto, një diell i ftohtë që më shumë ndrit se nxehtë (13).*

Gjatësia e fjalive të Kadaresë prek të gjithë spektrin e gjatësisë së fjalive, nga ato më të thjeshtat (fjali një kryegjymtyrëshe tek ato më komplekse siç shembulli 3 ku kemi: - shumësi fjalish (kryesore e të varura); - shumësi gjymtyrësh kryesore (kryefjalë e kallëzuesi); - shumësi mjetes lidhëzore; - rimarrje anaforike; - gjymtyrë homogjene; - enumeracion; - shumësi raportesh brenda periudhës: lidhore, kohore, qëllimore, shkakore.

Kadareja llojin e regjistrit e jep që në fillim të romanit (14). Nëse e lexojmë me kujdes si fillimin ashtu dhe fundin e romanit, duket sikur ka rimarrje konceptuale të fillimit të romanit, por me ndryshim të regjistrit stilistikor. Nëse në

fillimin e romanit regjistri stilistikor i përzgjedhur është më i drejtpërdrejtë dhe duket se shkrimtari e përgatit lexuesin se ngjarjet që do të rrëfejë do të jenë të mbuluara nga një tis i zymtë i hirtë, në fundin e romanit regjistri stilistikor shfaqet më alegorik e ironik dhe shkrimtari luan me imazhin dhe gjendjen psikologjike të Mark-Alemit përmes një hipoteze: Mark-Alemi e dinte se moti ishte i çelur e i ngrohtë, se lejlekët e dashuria ishin aty rrotull tij, por ai kishte parapëlqyer mos t'i shihte, nga frika se mos humbte magjinë e Pallatit të Ëndrrave, të asaj ngrehine hijerëndë që shkrimtari na paraqet në rreshtat e parë të romanit.

Fillimi i romanit

Mëngjesi ishte i lagët dhe me sqotë. Ndërtesat hijerënda, që çoheshin drejt e mbi lëvizjen e rrugës, me porta e me flegrat e mbyllura, e bënë edhe më të hirtë fillimin e ditës.

Mark - Alemi mbërtheu edhe kopsën e fundit të qafëzës së palltos, atë që e shtrëngonte zakonisht te gryka, vështroi fenerët e hekurt të rrugës me sqotën e rrallë që u vërtitej përreth dhe ndjeu një drithërimë në trup.

Fundi i romanit

Çeljen e motit, ngrohjen e reve, lejlekët dhe dashurinë, ai i kishte ditur që ishin aty, dy hapa larg, por kishte bërë sikur s'i kishte parë, i trembur se mos ato e nxirrnin nga magjepsja e Pallatit të Ëndrrave. I qe dukur se ishte strehuar aty për t'u mbrojtur dhe, në çastin kur i joshur prej jetës do të dilte nga ai strehim, pra në çastin e tradhtisë, trulllosja do të merrte fund, do të vinin ta merrnin, kur era të frynte kundër Qyprillinjve ...

Personazhi i Mark-Alemit, zbërthehet më së shumti përmes zërit të narratorit, mjedisit dhe psikologjisë së kohës. Shkrimtari i drejtohet ndjesive, duke u larguar nga realja për te bota e ëndrrave, dukjeve, krijon kështu imazhe dhe vizione, stili bëhet më i zhdërvjelltë, ritmi përshpejtohet, ka më intensitet, fraza bëhet më e shkurtër, më e figurshme. Regjistri gjuhësor te dialogët që ndërton Mark Alemi si brenda Tabir – Sarajit (15) ashtu edhe me njerëzit jashtë ngrehinës (shtëpi), pëson autocensurë (16), për shkak të temës që trajton dhe fjalitë janë pa ngjyrim, të thata, të ftohta, të shkurtra, formale (përdorimi i vetës së dytë shumës), pa emocione dhe neutralë. Dialogu është i paktë, kjo në përshtatje me Tabir-Sarajin, është pallati ku mblidhen, siten, peshohen, studiohen, përshkruhen, arkivohen, kthehet në i vlefshëm, absurdi - vetë nënvetëdija e njeriut, ndaj fjalitë janë të shkurtra e koncize që prodhojnë dhe një regjistër formal.

Mark - Alemi është i prirur të shohë, të vëzhgojë, të dëgjojë. Ai flet më shumë me sy e mimikë sesa me fjalë (17).

Regjistri stilistikor i Mark-Alemi zbulohet përmes imazheve të forta figurative dhe ekspresive (18) të paraqitura po me gjuhë shprehëse e therëse e mendimeve të brendshme të personazhit.

Së pari, **ëndrrat me shtysë vetjake**, që s'kanë asnjë lidhje me shtetin. Së dyti, **ëndrrat** e shkaktuara nga uria, mbingopja, të ftohtit, të nxehtit, etj. Me një fjalë, **që kanë lidhje me mishin e njeriut**. Së treti, **ëndrrat e rreme**, domethënë ato që s'janë parë vërtet, por që janë stisur prej njerëzve... një gabim në gjykimin e ëndrrës dhe gjithçka shkon së prapthi, më kupton? Me një fjalë, **kjo që bëjmë ne s'është aspak punë e trashë grahësish**, siç mund t'i duket ndokujt (19).

Përdorimi i këtij regjistri krijon një stad tjetër për gjuhën si mjet komunikimi, ajo gjeneron aftësinë për të qenë simbolike, sugjestionuese (20) përmes ëndrrës, ritmi i ngjarjes duket se shpejtohet, fjalitë nga koncize, të shkurtra vijnë e bëhen më përshkruese dhe regjistri alegorik (21).

ç'më polli, i shoi me kujdes shkronjat dhe e klasifikoi të vlefshme...kur vrulli i zemërimit i ra...i pa me qetësi: "Një mace e zezë kishte kapur me gojë hënën dhe po vraponte e ndjekur nga turma. Gjithë udhës nga ikte, dukeshin gjurmët e hënës së plagosur" (22).

Pasuria leksikore e frazeologjike (23) e Kadaresë rrok fjalë të reja: emra të rinj me parashtesim e prapashtesim, mbiemra të rinj të nyjshëm e të panyjshëm, ndajfolje e ndërtime frazeologjike që i japin ngjyrimet dhe njëkohësisht pasurojnë regjistrat gjuhësorë të rrëfimit i cili bëhet edhe më metaforik e simbolik.

Emra: *shkimëza flokësen, akullsirë, ndezulli, tymtarët, çajhanet, nimet, bajamishtja, qyqnaja, korbëri.*

Mbiemra: *të merimangshëm, lagatershëm, i lemerimshëm, cytanike, herak, zbërdhlyët, e kërthenezhtë, e përfushta, e paskaj, të stërthella.*

Kompozita, përngjitje: *ëndërrparësi, gjithkahnajë, shtijekeq, gjithkah, zëngjiruri shkelbaltësit, gjithsa herë, thirravajë, jetëvdekja, vdekjejeta.*

Ndajfolje: *diellisht.*

Shprehje: *-u fola pa lesh në bark; -të futur rras e plas; -djalli me brirë është; -qeveria e zë lepurin me qerre; -vij rrotull si kali në lëmë; -unazat ranë, por gishtat janë.*

Fjalëformimi është tipar dhe vlerë gjuhësore që shërben për të kuptuar ngjyrimet kuptimore, gjuhësore, leksikore, ngarkesat emocionale që mbart personazhi. Dobia e këtij fjalëformimi qëndron në faktin se Kadare, mënjanon fjalët e huaja, shfrytëzon të njëjtin burim gjuhësor në rrjedha të reja, të thella, të fuqishme nga ana semantike *'thirravajë; çajhanet'*.

'Shkelbaltësit', fjalë e krijuar me bashkëngjitje, që është elementi letrar përmbajtësor i fjalëformimit të Kadare. Ajo vjen si vlerë gjuhësore dhe vlerë letrare (si mjet i teknikës letrare për të paraqitur personalitetin e personazhit), etiketimin e tij në këtë rast, duke i letrarizuar, përmes përdorimit të gjuhës sipas kuptimit negativ.

Në veprën e dytë **"Prilli i thyer"**, të marrë për analizë do të ndalemi te marrëdhënia e gjuhës kadareane me etnopsikologjinë e shqiptarit dhe krijimi i regjistrave gjuhësorë përgjatë paraqitjes së dokeve zakonore, të drejtës juridike dhe të gjuhës së koduar në nyje ligjore. Regjistrat gjuhësorë të Gjorg Berishës, do të jenë të lidhura ngushtë me dy elementë psikologjikë e emocionalë, me **pritën** dhe **vrasjen**. Përballja e tij me kodet zakonore prodhon një regjistër simbolik, metaforik që shoqërohen me një pasuri të vyer të gjuhës me mjete stilistikore dhe me një ndërtim sintaksor të pasur.

Që në faqet e para të romanit, shkrimtari e përfshin lexuesin në gjendjen e trazuar psikologjike dhe emocionale të Gjorgut, në pritë gati për të kryer një vrasje.

(f. 9) **i trembur** e gati **me frikë**; (f. 9) **të ikte me vrap** nga kjo **pritë e nëmur** // **s'ishte në gjendje të mendonte** (zëri narrativ i autorit); (f. 9). Te këmbët ndjeu prapë **ftohtë** dhe prapë lëvizi gjunjët, si për ta ndaluar të ftohtë të ngjitej lart. Megjithatë **e ftohta ishte ngjitur prej kohësh në barkun e tij, në gjoks e gjer në kokë**. Madje në kokë ajo dukej sikur e **kishte ngrirë trurin copa-copa**, si ato copërat e dëborës matanë udhës. (f. 10) E ktheu mbarë, **i vinte për të vjellë** dhe thoshte me vete **"Më ka zënë gjaku"**; (f. 17) Vijat e tirqve të tyre ishin fare pranë vijave të tirqve të tij, gjarpërinjtë e zi me kokat plot helm (e folur simbolike), që ishin gati të kafshoheshin. Në ecje e sipër ato gati sa nuk prekeshin. Por ai ishte krejtësisht i qetë, ishte **i mbrojtur nga besa 24 orëshe** më mirë se nga çdo frëngji kulle apo kështjelle. (f. 20) (gjendja psikologjike nga zëri i narratorit) Gjorgu vazhdoi të rrinte si **i mpirë** në një kënd të kullës. I mbeteshin ende tridhjetë ditë

jetë pa rrezik. Pastaj qenien e tij do ta mbështillte nga të gjitha anët prita e vdekjes. (f. 20) Si lakuriqi i natës, do të lëvizte prore nëpër terr, **i trembur** nga dielli, nga hëna e plotë dhe nga flakadanët. (e shtëna e pushkës e ndau jetën e tij në dy pjesë: në pjesën tridhjetëditore që po fillonte sot, shtatëmbëdhjetë mars gjer më shtatëmbëdhjetë prill. Më tutje ishte endja e lakuriqit të natës...

Përmes një regjistri të pasur gjuhësor e një përzgjedhjeje të kujdesshme të fjalëve, shkrimtari arrin të përçojë të lexuesi mjedisin ku ruhet kultura etnojuridike e kanunore, Udhë e Madhe në fshatin Brezftohtë (24), është mjedisi i pritjes për të bërë vrasjen, fusha përjeton gjendjen e trazuar psikologjike e shpirtërore të Gjorgut nga fillimi deri në fund të romanit, duke e mbajtur lexuesin të vëmendshëm përgjatë gjithë kurbës së ndryshimeve që pëson gjendja e tij ndjesore e shpirtërore.

Tri pyetjet simbolike të bëra në momente të ndryshme të përballjes me ankthin, krijojnë shkallëzimin e përdorimit të gjuhës nga ku zë fill dhe regjistri gjuhësor e stilistikor i Gjorgut.

Pyetja e parë: *Çdo të bënte në këto tridhjetë ditë që i mbeteshin?* (25) *Jam vallë i lirë?* (f. 45). Mekanizmi i gjakut ishte i tillë që, edhe kur të lëshonte së jashtmi, të mbante shpirtin peng. (f. 47). Aktivizon **fjalorin etnografik**.

Pyetja e dytë: *Si ishin krijuar vallë kaq të plota dhe zotëruese?* Prej kujt dhe kur? (26) Aktivizon **fjalorin etnojuridik**.

Pyetja e tretë: *Jashtë gjakmarrjes. ... Si ishte vallë jeta në ato familje?* (27) Ku jam? (f. 146).. Kulmin e druajtjes e provoi kur hyri në këtë kthinë. (f. 192). *Me sy të ngrirë* vështronte përreth. (f. 56). Aktivizon **fjalorin metaforik**.

"Prilli i thyer" është roman me regjistër dominant etnografik. Shkrimtari rrëfen artistikisht ngjarje e njëherazi e përfshin lexuesin në botën e një kulture dokesorë me norma, ligje e rite që rregullojnë marrëdhënie dhe përcaktojnë fatet e njerëzve.

Rregulli etnojuridik i Kanunit për të vrarin. Kanuni parashikonte tronditjen nga vrasja dhe e lejonte vrasësin të porosiste kalimtarët për të bërë atë që nuk kishte bërë dot, kurse, ta lije të vrarin përmbys dhe me pushkën larg trupit, ky ishte turp që s'falej.

- *Atje, te bërryli i Udhës së Madhe, kam vrasë një njeri, — tha me një zë pothuajse të ngjirur. - Kthejeni mbarë dhe vendosjani pushkën te koka, o njerëz të mire.* (f. 13)

Kanuni për vrasjen e gruas. *Gjatë një grindjeje me të shtëna armësh kishte vdekur një grua, e gjendur rastësisht mes grindësve. Gruaja kishte*

qenë shtatzënë, me një fëmijë mashkull, siç qe vërtetuar pas hapjes. Pleqtë e katundit e kishin të vështirë, siç duket, të vendosnin mbi kë rëndonte gjaku i fëmijës. (f. 39).

Rregulli etnojuridik i Kanunit për familjen. *Në shtëpi s'hyhej pa thirrur e pa u përgjigjur kush.* (f. 26)...

Rregulli etnojuridik i Kanunit për udhën e udhëtarin. *Në udhë kalon njeriu, kalon dhe bagëtia, kalon i gjalli, kalon dhe i vdekuri.* (f. 26).

Rregulli etnojuridik i Kanunit për mikun. (f. 32). *Dihej se në qoftë (1) se ti e përcolle mikun dhe miku tu vra në sytë e tu, gjaku i tij bie mbi ty. (2) Në qoftë se e përcolle, i ktheve shpinën dhe në atë çast miku u vra, ti je i larë nga gjaku...* (f. 32). *miku ishte i shenjtë dhe, ata qysh nga fëmënia e kishin ditur se, shtëpia e malësorit, përpara se të ishte e njerëzve të shtëpisë, ishte e Zotit dhe e mikut. Rituali etnojuridik dhe etnografik i pritjes së trupit të të vrarit.* (f. 15.) *I ati i të vrarit priste në këmbë te porta e kullës. Kur njerëzit që po e sillnin trupin ishin 40 hapa larg, ai thirri: Ç'më keni sjellë? Plagë apo mort? Përgjigjja qe e shkurtër dhe e prerë: Mort*

Rituali para marrjes së besës. *Gjithë fisi i Berishajve po merrte masat e mbrojtjes. Aty këtu dëgjoheshin zëra burrash, - Eja shpejt në shtëpi. - Qe, vuri shilin portës. - Ku është Prenga?* (f. 15).

Po mbylleshin portat e shtëpive dhe të gjithë farefisninë, të afërtat dhe të largëtat, sepse ashtu siç njihej brez pas brezi, vrundulli i parë i shtrëngatës dihej se kjo ishte koha e rrezikshme fill pas vrasjes, kur familja e të vrarit nuk kishte dhënë ende asnjërin prej besave, kështu që kryeqytet, të verbuar nga gjaku i porsaderdhur, e kishin të lejuar të shtinin mbi cilindo pjesëtar të fisit të Berishajve.

Riti kanunor për gjëmëtarët. *(Gjëmëtarët erdhën nga larg (rit zakonor) duke grisur fytyrat e duke shkukur flokët sipas dokeve.* f. 16). *Zakoni e kërkonte që ata të mos i lanin fytyrat as në katundin ku kishte ndodhur vdekja e as udhës. Mund ta bënin këtë vetëm kur të mbërrinin në fshatrat e tyre.*

Riti kanunor në shtëpinë e të vrarit. f. 18. *Ja kulla e të vrarit. Në dritaren e ngushtë sipër qemerit të portës kishin vënë coha të zeza.* f. 18.

Poshtë, në oborr të kullës, te filli i rrobave qe nderur një këmishë e vetme. nëna e kishte larë më në fund këmishën, që orëligu e kishte veshur atë ditë. ... kishte qëndruar e varur, siç e kërkonte kanuni, në katin e sipërm të kullës, duke pritur që të lahej veç pas marrjes së gjakut. f. 23.

Riti kanunor për vrasësin. (Gjorgu merr pjesë në varrim se e do zakoni). *Gjithkush mund të*

mungojë sot në varrim a në drekë të mortit, veç ti jo. f. 16.

Besëtytni. *Thoshin se, kur njollat e gjakut mbi këmbë nisin të zverdheshin, kjo ishte shenjë e sigurte se i vrari po pezmatohet për vonesën e marrjes së gjakut.* f. 23.

Kanuni për mikun: *Dihej se (1) në qoftë se ti e përcolle mikun dhe miku tu vra në sytë e tu, gjaku i tij bie mbi ty. (2) Në qoftë se e përcolle, i ktheve shpinën dhe në atë çast miku u vra, ti je i larë nga gjaku...* f. 32. *Miku ishte i shenjtë dhe, ata qysh nga fëmënia e kishin ditur se, shtëpia e malësorit, përpara se të ishte e njerëzve të shtëpisë, ishte e Zotit dhe e mikut.* f. 32.

Kanuni për shtëpinë besëprerëse. *Kur pa se gurët e themeleve në të katër cepat ishin të shkullur, e kuptoi se ndodhej përpara rrënojës së një shtëpie besëprerëse, dhunimi më i madh i kanunit: prerja e mikut në besë.* f. 41.

(Dënimi: Vrasësi ishte grirë katundisht, duke shkuar gjakhupës. Shtëpia ku miku ishte prerë, pavarësisht se njerëzit e saj nuk ishin fajtorë, u dogj. Vetë i zoti i saj printe me urë e me sëpatë, duke klithur sipas zakonit: *"I marrsha të ligat katundit dhe flamurit"*. Pas kësaj të zotit të shtëpisë për vite me radhë gjithçka duhej t'i jepej me dorë të majtë e për nën gju, për t'i kujtuar se duhej të hakmerrte mikun.)

Kanuni mbi martesën. *...ishte vendosur prej prindërve të vajzës "fisheku i pajës", me të cilin, sipas dokeve, dhëndri kishte të drejtë të vriste nusen, në qoftë se ajo përpiquej të ikte.* f. 28.

Dita e martesës nuk shtyhej kurrë, thoshte kanuni. Krushqit do të mbërrinin, edhe sikur nusja të ishte duke vdekur, zhargas e rrëshqanthi do ta çonin te shtëpia e dhëndrit. krusheve s'u ndalej udha as prej mortit. I vdekuri në shtëpi, krushqit do të nisen. Nusja hyn në shtëpi, i vdekuri del shtëpie. f. 29.

Kanuni për kishën. *Prifti s'binte në gjak.* f. 29.

Haraç e ndëshkime. *Çdo plagë paguhet veç e veç, dhe çmimi i plagës varet nga vendi ku ndodhet. Plagët e kokës zhëdmtohen, dy herë më shtrenjtë se ato të trupit, që gjithashtu ndahen dy faresh, nga brezi e lart e nga brezi e poshtë, e kështu me radhë.* f. 177.

Ndëshkimet ishin të shumta: veçimi ose lëçitja, siç quhej në kanun, kur njeriu veçohej përjetë prej të gjithëve. (I ndarë për mort, për dasmë e për miell hua.) Lënia e tokave djerr, shoqëruar me prerjen e drurëve të kopshtit. Lënia pa ngrënë (në familje). Heqja e armëve të krahut a të brezit për një apo dy javë. Lidhja dhe burgimi në shtëpi. Rrëzimi i të zotit apo zonjës së shtëpisë prej gjindjes së familjes. f. 43.

Të shtjellosh artistikisht jetën zakonore, doket, ritualet, normat e ligjet është një aftësi e jashtëzakonshme e Kadaresë. Nëpërmjet një regjistri të pasur me fjalë të fushës kanunore, me **strukturë fjalie urdhëruese, imponuese, detyruese, zbatuese**, me shprehje e ndërtime frazeologjike shumë të pasura e që shpesh revokojnë një të shkuar shumë të largët, shkrimtari e mban lexuesin nga fillimi deri në fund në gjendjen që përjeton vetë personazhi kryesor i romanit, Gjorgu.

Leksiku (28) i pasur me fjalë të reja të krijuara me parashtesim, prapashtesim, foljet, kompozitat e fjalët me përngjitje, ndajfoljet, Frazeologjizmat, përdorimi i fjalëve të rralla, përdorimi metaforik e simbolik (29) i fjalëve të kontekstin e rrëfimit e pasurojnë regjistrin gjuhësor të Kadaresë.

folje: *kishte trokëllitur, të çuriste (shi), karfoste, gjumësitej, nismëton.*

emra: *pllangash, pleqnarët kësolltarësh, bokërimat, carani, bukurezat, vargor, këmborkat, lëkurçe, bujtinar, rrogeç, dorërasët, hirnoshjes, qiellzimit.*

mbiemra: *ngrehaluc, të palëndët, hutaq, shtrembanik, të hekuremtë, tymtor, zhdehës, betarë, të patëzonë, i përhënur.*

kompozita, përngjitje: *kryeqyqëve, gjëmëtarët, kanunshkelësit, orëligu, krushkaparin, e tjetërfarshme, vetëcheroizoheshin, vëllavogli, motërvetmja, mikpreri, Gjakmarrjeloggia, çartabesës.*

ndajfolje: *prore, hamendthi, kryengulthi, zhargas, rrëshqanthi.*

Ndërtime e shprehje frazeologjike: - *më mirë të mos shkojë plumbi hup, - ti pushkë e pafsh, ti e vrafsh! malit si t'i thërrasësh ashtu të përgjigjet - shqiptari e merr gjakun veç me pushkë, - fytyrën e vruguar në daç laje, në daç zezoe dhe më, - je i lirë të mbash burrinë tënde, je i lirë të zhburrërohesh, - dy gisht nder në lule të ballit, - pushkë të bukur paska qitë! - pushkë të pabukur paska qitë! - mos e thani lisi! - me hangër bukën e gjakut të paqtuar, - me jetë të gjatë e ta vraftë pushka! - morti në fis, krushqit s'ndalen, - të gjallët s'janë veçse të vdekur që kanë ardhur me leje në këtë jetë, - gjakun po zuri vitin e dymbëdhjetë, është si lisi, nuk e shkul dot më, - ç'donte mielli yt në thes të huaj?*

Për një referencë më të mirë për regjistrin gjuhësor na ndihmon sintaksa.

(1) *Ishte një histori e zakonshme me njëzet e dy varre nga secila palë, gjithsej dyzet e katër varre, me fjalë të shkurtra, të thëna para vdekjes, por më tepër me heshtje, se me fjalë, vetëm me gulç, me grahamë të rëndë, përmes së cilës s'del dot porosia e fundit, me tri këngë të një lahutari, njëra prej të cilave ishte shuar më pas, me një varr*

femre të vrarë gabimisht dhe të larë **me gjobë**, sipas të gjitha rregullave, **me mbyllje** të burrave të të dyja palëve në kullën e ngujimit, **me një përpyetje** pajtimi të gjakut, që kishte dështuar në çastin e fundit, **me dhënie** bese të vogël e bese të madhe, **me drekë** të mortit, **me thirrje** "filani i Berishajve shtiu mbi filanin e Kryeqyqëve", ose anasjelltas, **me flakadanë**, ecejake nëpër katund, e kështu **me radhë** gjer te mbasditja e shtatëmbëdhjetë marsit, kur, për t'u futur në vallen makabër, i kishte ardhur radha Gjorgut (30).

(2) Atje ishin shënuar me rrënjë e me themel **gjaqet** e gjithë Rrafshit, huatë e vdekjes, që familjet apo fiset i kishin njëri – tjetrit, shlyerjet nga të dyja palët, **gjaqet** e pashlyera, që përtëritnin **gjakmarrjen** pas dhjetë, njëzet, disa herë njëqind e njëzet vjetësh, njehsimet e pafundme prapë me hua e me shlyerje, breza të tërë njerëzorë **të zhdukur, lisi i gjakut**, siç thirrej **gjaku** nga i ati, dhe lisi i tamblit, siç thirrej **gjaku** nga nëna, **vrasja** e larë me **vrasje**, filani për filanin, një për një, krye për krye, **mort** që ndiqet përherë nga të tjetër **mort**, një i **vrarë** që bëhet një palë **të vvarësh**, pastaj katër palë, katërmëdhjetë, njëzet e katër dhe përherë **një gjak** i tepërt në krye, **një gjak** vetmitar, që, si dashi përçor që i prin tufës, i prin turmave të reja të **të vdekurve**. (31)

Dy shembujt e sjellë më lart dëshmojnë qartësisht mjeshtërinë sintaksore të Kadaresë. Edhe pse në shembullin (1), kemi përdorim të shpeshtë të parafralës 'me', nuk cënohet aspak rrjedhshmëria e leximit. Rrëfimi me vetëm një periudhë të gjatë, Kadare na rrëfen një histori, rite e rituale, doke e zakone, rregulla e norma, historinë e Kanunit e të gjakmarrjes. Edhe shembulli (2), në pak rreshta, të përfshin në vorbullën e gjakmarrjes, të vrasjeve të njëpasnjëshme, të Vrasjeve me Kanun. **Sintaksë komplekse dhe shumë e thyer**: - shumësi fjalish (sidomos të varura); - përdorim i dendur i parafralës 'me' në shembullin (1); - rimarrje anaforike; - gjymtyrë homogjene; - enumeracion. Atmosfera e fillimit dhe fundit të romanit ka tension, ankth shembull i regjistrit metaforik. Gjorgu flet i gjallë në fillim të romanit, por Gjorgu flet edhe i vdekur në fund të romanit, regjistri simbolik.

Fillimi i romanit:

Sa herë që ndiente ftohtë nga këmbët, ai lëvizte pak gjunjët dhe atëherë diku poshtë vetes dëgjonte guralecët që zhurmonin ankueshëm. Në të vërtetë

ankesa ishte brenda tij. Asnjëherë në jetë nuk i kishte qëlluar të rrinte kështu i ngulur, një kohë kaq të gjatë, pas një ledhi, tek udha e madhe, duke pritur të kalonte dikush. (f. 9)

Fundi i romanit:

Dëgjonte ende hapat që po largoheshin dhe dy-tri herë pyeti veten: Të kujt janë vallë? Ju dukën si hapa të njohur. Ah, po, ata ishin krejt të njohur, ashtu si edhe duart që e kthyen mbarë ... Janë të miat, tha me vete. Në 17 mars, udha pranë Brezftohtit ...një grimë e humbi ndërgjegjen, pastaj prapë dëgjoji kumbimin e hapave dhe përsëri iu duk se ato ishin hapat e tij dhe ishte ai vetë e askush tjetër, që po ngarendte kështu, duke lënë pas, të shtrirë midis rrugës, trupin e vet, që porsa e kishte vrarë.

(Gjorgu flet edhe i vdekur)

Rrëfimi te romani "**Ura me tri harqe**" (32) është në vetë të parë. Murgu Gjon, rrëfyesi i ndërtimit të urës, flet në vetë të parë duke u vetëvizatuar si personazhin e duke transmodeluar baladën e murimit në murim literal (33).

Shkrimtari, që në nisje të romanit ("... vazhdojnë të thuren **gojëdhëna** e **histori të paqena** e **gjithfarë dokrrash**...") e përgatit lexuesin me regjistrin gjuhësor e stilistikorë përmes të cilit do të shtrijë rrëfenjën. Duke zgjedhur fjalët e përshtatshme 'gojëdhënë', 'histori e paqenë', 'gjithfarë dokrrash', e fut menjëherë lexuesin në botën mitologjike, në botën e legjendave e të gojëdhënave përmes një regjistri simbolik (34) e metaforik.

Edhe në këtë roman, Kadare shpalos mjeshtërinë e tij krijuese, duke përdorur një regjistër të lartë gjuhësor që shoqërohet me pasuri leksikore, simbolikë, metaforë, sintaksë shpeshherë komplekse por gjithherë e kuptueshme. I gjithë romani për shkak dhe të temës (35), qëllimit (36) dhe vendodhjes (37) së ngjarjes, priret drejt regjistrit simbolik mitologjik.

Në fund vetëm të tri romaneve pasuria leksikore (38) është në kufijtë e një fjalori xhepi, çka të mahnit për lëvrimin e gjuhës nga Kadare.

emra: *pllangash, pleqnarët kësolltarësh, bokërimat, carani, bukurezat, vargor, këmborkat, lëkurçe, bujtinar, rrogeç, dorërasët, hirnosjes, qiellzimit.*

folje: *kishte trokëllitur, të çuriste (shi), karfoste, gjumësitej, nismëton.*

mbiemra: *ngrehaluc, të palëndët, hutaq, shtrembanik, të hekuremtë, tymtor, zhdehës, betarë, të patëzonë, i përhenur.*

kompozita: kryeqypqëve, kanunshkelësit, orëligu, krushkaparin, vëllavogli, motërvetmja, mikpreri, gjëmëtarët, e tjetërfarshme, vetëçheroizoheshin, Gjakkarrjelogjia, çartabesës

ndajfolje: prore, hamendthi, kryengulthi, zhargas, rrëshqanthi

ndërtime e shprehje frazeologjike: - më mirë të mos shkojë plumbi hup, - ti pushkë e pafsh, ti e vrafsh! malit si t'i thërrasësh ashtu të përgjigjet, - shqiptari e merr gjakun veç me pushkë, - fytyrën e vruguar në daç laje, në daç zezroje dhe më, - je i lirë të mbash burrërinë tënde, je i lirë të zhburrërohesh, - dy gisht nder në lule të ballit, - pushkë të bukur paska qitë! - pushkë të pabukur paska qitë! - mos e thani lisi! - me hangër bukën e gjakut të paqtuar, - me jetë të gjatë, e ta vraftë pushka! - morti në fis, krushqit s'ndalen, - të gjallët s'janë veçse të vdekur që kanë ardhur me leje në këtë jetë, - gjakun po zuri vitin e dymbëdhjetë, është si lisi, nuk e shkul dot më, - ç'donte mielli yt në thes të huaj?

Kadareja është mjeshtër i fjalës dhe i gjuhës. Është, pa asnjë mëdyshje, një nga lëvruesit dhe pasuruesit e shqipes. Kadare krijon fjalë të reja me brumë të shqipes dhe duke ndjekur rregullat e fjalëformimit. Kështu, krijon folje të reja, emra të rinj me parashtesim e prapashtesim, mbiemra të rinj të nyjshëm e të panyjshëm, ndajfolje të reja. Shumë interesante janë kompozitat me kombinim të kategorive të ndryshme gramatikore (emër+emër, folje+emër, folje+mbiemër, emër+mbiemër). Përdorimi i një leksiku të pasur në fjalë, kombinime e ndërtime shprehjesh e pasuron shumë regjistrin gjuhësor të shqipes. Krijimi i fjalëve të reja, ringjallja e fjalëve pak të përdoruar apo shumë pak të njohura, përdorimi i frazeologjisë, veshja e fjalëve me kuptime të reja kontekstuale e bëjnë gjuhën e Kadaresë edhe më metaforike e alegorike.

Sintaksa

(1) *U gëzuan se s'do të kishin më punë me trapaxhinjtë e pafytyrë, që gjendeshin gjithmonë në anën tjetër, kur ti i kërkoje në këto anë, që nganjëherë s'gjendeshin fare, madje dhe më keq, që i gjeje të dehur, me përjashtim të trapaxhiut të fundit, të gërmuqit, që as gratë s'i ngacmonte, as dehej, por që ishte aq i zymtë në fytyrë, saqë të dukej se po të çonte në mbytje të sigurt.*

(2) *Filluan të flisnin të tre, duke ndërprerë njëri-tjetrin, për të shpjeguar se mjaftonte të shikojë fuçitë e mbushura me atë llahtarë, për t'u bindur se vetëm shtriganët mund ta kishin për zemër atë punë, se mjerë ai që do të lejonte të kalonin nëpër tokën e tij qerret e ngarkuara me këto fuçi, të cilat nga vapa pikojnë serën pikë-pikë, duke spërkatur rrugët, ç'them duke spërkatur, duhet thënë: duke përgjakur rrugët me gjakun e zi të djallit.*

Edhe në këtë roman dallojmë stilin karakteristik të Kadaresë me sintaksë komplekse, por mjaft mirë të strukturuar. Kadareja parapëlqen që brenda një periudhe me fjali kryesore e të varura të ndërtojë raporte të ndryshme kohore, shkakore, qëllimore, lidhore, pa e cenuar kurrë Koherencën dhe Kohezionin si brenda periudhës ashtu edhe me paratekstin dhe pastekstin.

Fillimi i romanit

Unë, murgu Gjon, i biri i Gjorg Ukcames, tue u kujtuam se në gluhën tonë ende s'ka gja të shkruam për urën mbi Ujanën e Keqe, ... (f. 11.)

Fillimi i Mesharit

(U doni Gjon, biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herrë se gluha jonë nukë kish gj~ të ëndigluom ën së shkruomit shenjëtë, ën së dashunit së botësë s'anë, desha me u fëdigunë, për s~ muja me ditunë, me zhdritunë pak mendetë e atyne qi të ëndiglonjinë... "Ëndë vietët M.D.L.IV. njëzet dit ëndë mars zuna ënfill, e ënbarova ëndë vietët një M.D.L.V., ëndë kallënduor. (Gjon Buzuku, Meshari, 1555).

Fundi i romanit

Të kthehesha ta kryeja sa më shpejt, sepse koha është e turbullt, së shpejti mund të bjerë nata e gjatë dhe atëherë shkrimi i kronikave të tilla shqipe mund të paguhet me kokë. Ky ishte mesazhi i të muruarit. Dhe kjo kronikë, ashtu si ura vetë, mund të kërkojë një fli, dhe këtu i flijuaris'ka kush të jetë veçse unë, unë murgu Gjon, biri i Gjorg Ukcames, ...

Ashtu si e fillon romanin, duke marrë shkrimin e traditës të Buzukut të "Mesharit", ashtu edhe e mbaron Kadare. Madje krejt zishëm. Shkrimtari, nëpërmjet regjistrit simbolik, kujton se këndej pari përbindëshi Ura, do të kërkojë fli dhe kjo është mynxyra që po i vjen Arbërit. Ndaj dhe para se të ndodhte murimi për herë të dytë, kronika e urës duhej shkruar.

Si përfundim: Regjistrat gjuhësorë të personazheve bashkërenditen në mënyrë logjike në kohë dhe hapësirë, veprimet shprehin gjendje emocionale të heroit. Shtjellimi i ngjarjeve në kohë, shpreh rritjen e fuqisë të së njëjtës ndjenjë si shprehje e ndryshimit të gjendjes shpirtërore dhe njëkohësisht të regjistratit të tij.

Referenca

¹ Sinani Sh, Për prozën e Kadaresë, studime dhe artikuj, Naimi, Tiranë, 2009, f. 129-130. *Një gjuhë për të arritur te ky stad, që të shprehë gjendjen e vet aktive përjashtimisht në ligjërimin e një folësi, i duhet të presë jo vetëm një shkallë përtëritjeje tërësore të pasurive të veta, por edhe protagonistin e virtutshëm që i jep asaj plotninë dhe hijeshinë e letrarësisë së saj. Sepse mendësia e një gjuhe për të bindur një zots të fjalës së saj të fisme deri tek përmasa e një gjendjeje të tillë të re cilësore, si Ismail Kadare, për nga shkalla e*

aftësive, shijes, intuitës, teknikës për të lëvruar, kuptuar, interpretuar, pasuruar, krijuar, kalkuar, ringjallur dhe kumtuar fjalë, shprehje, frazeologji, leksema të reja të shumëfarshme dhe mbi të gjitha gjedhe funksionale fjalëformuese, mund të quhet njëherësh edhe fat.

² Sinani Sh, Për prozën e Kadaresë, studime dhe artikuj, Naimi, Tiranë, 2009. f. 130. *Gjuha nuk bëhet e gjallë vetvetiu. I. Kadare shkroi letërsi cilësore dhe në këtë proces e sipër pohoi pjekurinë e shqipes letrare kombëtare.*

³ Kadare I, Pallati i ëndrrave, Onufri, 2004. f. 291 *Me një ndjenjë të turbullt faji, ai i hoqi sytë andej dhe uli kryet mbi dosje, por, para se të niste përsëri leximin, psherëtiu thellë: O Zoti Perëndi!*

⁴ Po aty., f. 323. *Gjithçka e mendonte qetësisht. Kjo ishte një pagjumësi pa vuajtje, e rregullt, e ftohtë.*

⁵ Po aty., f. 432. Çfarë? – pyeti Mark - Alemi me një fije zëri. A thua? Po përse ... përse? Në fije shprese nisi të përpëlitej dobët përbrënda Mark - Alemit. - Si? Si? - pyeti Mark - Alemi. Ndihej menjëherë që ai po bëhej nervoz.

⁶ Dado F, Intuitë dhe vetëdije kritike, Onufri, Tiranë, 2006. f. 146

⁷ Lloshi Xh, Stilistika dhe pragmatika, Toena, Tiranë, 1999, f. 75

⁸ Dado F, Intuitë dhe vetëdije kritike, Onufri, Tiranë, 2006, f. 145

⁹ Eco U, Struktura të pranueshme, Dukagjini, Pejë, 1996, f. 46

¹⁰ Kadare I, Pallati i ëndrrave, Onufri, 2004, f. 275.

¹¹ Po aty., f. 323. Gjithçka e mendonte qetësisht. Kjo ishte një pagjumësi pa vuajtje, e rregullt, e ftohtë. Dhe s'ishte vetëm pagjumësia e tij që kishte ndryshuar. ***Gjithçka në jetën e tij kishte pësuar një trandje.***

¹² Po aty., f. 262. Mënga e ***xhybes*** së tij ishte aq e gjerë, sa që ajo nuk mori aspak pjesë në tregimin e krahut. ***O Zot, ende me këtë veshje...***

¹³ Po aty., f. 320.

¹⁴ *Gazeta Drita* 23.11.1986. Gabriel Garcia Marquez-i pohon se: "*Fraza e parë mund të jetë laborator ku përpunohet stili, struktura madje dhe gjatësia e librit*".

¹⁵ Kadare I, Pallati i ëndrrave, Onufri, 2004, f. 312 Pallati i ëndrrave është ai që qëndron më jashtë vullneteve njerëzore se gjithë të tjerët. Më kuptoni ç'dua të them? Ai është më i jashtëarsyeshmi i të gjithëve, më i verbri, më fatali, pra, edhe më shtetërori.

¹⁶ Po aty., f. 287 Habitej edhe vetë me guximin e tij. ... por frika se mos e tepronte ***e pengoi***.

¹⁷ (*Mëngjesi*) f. 267 Një psherëtitje e Mark Alemit // f. 272 Një pyetje e Marka Alemit bërë vetes // f. 276. - A mund të më thoni si shkohet në Seleksionim? (pyet Marka Alemi) // f. 277

¹⁸ Po aty., f. 274. Regjistri metaforik. ***si mulliri pa ujë ... salla e qiqrave***; drita - terri // mjalti - helmi // madhështia - mjerimi; rrebesh -

katastrofë // rebelim - krim (f. 274) // ferr - tmerr // parajsë - mrekuili // i kurrëfartë - i humbur.

¹⁹ Kadare I, Pallati i ëndrrave, Onufri, 2004, f. 280
²⁰ Po aty., f. 301

²¹ Po aty., f. 311. Bota atje dyzohej, shumë shpejt fillonte e ***mosrrokshmja*** ...

²² Po aty., f. 302

²³ Po aty., f. 290 ... por kurrësi kaq ***të merimangshëm*** // f. 302

²⁴ Kadare I, Pallati i ëndrrave, Onufri, 2004, f. 51. Mjedisi. Qysh nga fëmijëria kishte dëgjuar për kullën princërore ...

²⁵ Po aty., f. 21

²⁶ Po aty., f. 29

²⁷ Po aty., f. 30

²⁸ Kadare I, Prilli i thyer, Toena, 2009. f. 9 grumbull ***pillangash*** dëbore // 16. Familja e ***kryeqyqëve*** e celi besën (24 orëshe) besa e madhe është 30 ditëshe.

²⁹ E folura simbolike. f. 56. ... gojë e sidomos nofullat e tyre, nën ndriçimin e zjarrit të kujtonin ca trajta drynash të vjetër.; f. 68. Të marrësh ditët e ejtës me metrin e vdekjes, është në radhë të parë një dhunti.

³⁰ Kadare I, Prilli i thyer, Toena, 2009, f. 31

³¹ Kadare I, Prilli i thyer, Toena, 2009, f. 128

³² Kadare I, Ura me tri harqe, Onufri, 2015

³³ Po aty., f. 17 ... më thirrën me ngut te konti, f. 50. Pyeta gati me zë: pse?

³⁴ Po aty., f. 12. Hijet e minareve të tij po mbërrijnë gjer këtu (lindja). Kryet i ka në vdekje dhe bishtin me vdekje, dhe dihet se fjala ose tingulli i ngjizur me brumin e vdekjes, më pak se çdo gjë tjetër, i trembet asaj. f. 14.

³⁵ Po aty., f. 12. Shpresoj ta shkruaj këtë kronikë, sepse ***kohët janë të vrugëta***, dhe e ardhmja është errur si asnjëherë tjetër; f. 12. ... ***të shkruaj gënjeshtren ashtu siç nuk dukej***, dhe ***të vërtetën ashtu siç nuk dukej***.

³⁶ Po aty., f. 54. çdo shenjë që të kesh, të mirë ose të keqe, duhet së pari t'ua tregosh maleve. f. 70. ***Uji s'harron kurrë. Toka është zemërgjërë, të fal më shpejt, kurse uji jo.***

³⁷ Po aty., f.12. Nuk ishte një fli kushtuar orëve të ujit, por thjesht një krim i zakonshëm, dëshmitar i të cilit ...unë do të bëhem ... është ***gojëdhënë*** e theorisë që kinse u bë në këmbët e urës.

³⁸ Po aty., f.11. ***Zvargëj*** // 12. kohët janë ***të vrugëta*** // 12. ***karvanarët, fqinjëronim*** // 13. ***trapari***, mbështjellë me ***bërruce*** të zinj.

Bibliografi

1. Dado F, Intuitë dhe vetëdije kritike, Onufri, Tiranë, 2006
2. Eco U, Struktura të pranueshme, Dukagjini, Pejë, 1996
3. Lloshi Xh, Stilistika dhe pragmatika, Toena, Tiranë, 1999

4. Sinani Sh, *Për prozën e Kadaresë, studime dhe artikuj*, Naimi, Tiranë, 2009

5. *Gazeta Drita* 23.11.1986

Vepra

1. *Kadare I, Prilli i thyer, Toena*, 2009

2. *Kadare I, Pallati i ëndrrave, Onufri*, 2004

3. *Kadare I, Ura me tri harqe, Onufri*, 2015

SEMANTIKA FJALËFORMUESE E ZIJA ÇELËS NË ROMANET "ORA E ZOOPARKUT" DHE "GJYSMA E XHOKONDËS"

Dr. Evis Hudhëra

evishudhera@gmail.com

evis.hudhera@univlora.edu.al

Departamenti i gjuhë- letërsisë

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Abstrakt

Metodat e përdorura: *Së pari*, Programi i Konkordancave leksikore në kompjuter (SCP) na shërben për të krijuar listën e fjalëve të dy romaneve, dosjet kompjuterike me neologjizmat, arkaizma, fjalët e huaja apo të huazuara. *Së dyti*, Lexim i imtësishëm me shënime për të identifikuar njësitë frazeologjike pasi programi i Konkordancave nuk i njeh këto njësi. *Së treti*, Analiza përshkruese dhe vlerësuese e tipareve semantiko-gjuhësore të leksemave në romane. **Rezultatet:** Fjalëformimi i neologjizmave dhe kuptimet që fitojnë brenda kontekstit. Fjalët dialektore e krahinore meveçoritë semantike e strukturore të tyre. Arkaizmat e fjalët e huaja dhe semantika e tyre. Vështrim leksikometrik mbi njësitë frazeologjike me fjalët me dendurinë më të madhe.

Fjalët kyçe: *neologjizma, fjalë dialektore, njësi frazeologjike, fjalë të huaja, veçori semantiko – strukturore, ndarje leksikometrike, etj*

Abstract

Methods used: *First*, The Computer Lexical Concordance Program (SCP) serves us to

create the word list of the two novels, computer files with neologisms, archaisms, foreign or borrowed words. *Second*, Close reading with notes to identify phraseological units as the Concordance program does not recognize these units. *Third*, Descriptive and Evaluative Analysis of the semantic-linguistic features of lexemes in novels.

Results: Word formation of neologisms and the meanings they acquire within the context. Dialectal and provincial word and their semantic and structural features. Archaisms and foreign words and their semantics. Lexicometric overview of phraseological units with the words with the greatest density.

Key words: *neologisms, dialect words, phraseological units, foreign words, semantic-structural features, lexicometric divisions, etc*

Hyrje

Të flasim për shkrimtarin Zija Çela, jetën dhe veprën e tij nuk është objekt i studimit tonë, pasi objekt i këtij referimi bëhet leksiku i Zija Çelës

në dy romanet se veprat artistike janë tekste gjuhësore. Në veprat letrare mund të studiohet gjuha dhe dukuritë saj semantiko – gramatikore. Ndaj, një vepër letrare duhet vlerësuar për thesarin gjuhësor, përzgjedhjen dhe përdorimin e kujdesshëm të fjalës. Pra duke hulumtuar dy romanet kemi arritur të identifikojmë mekanizmat gjuhësore të neologjizmat, fjalët dialektore e krahinore, arkaizmat, fjalët e huaja dhe njësitë frazeologjike.

A Neologjizmat në dy romanet

Një nga burimet shprehëse në letërsinë artistike është krijimi i fjalëve dhe kuptimeve të reja. Kjo dukuri haset edhe në veprën e Zija Çelës. Me anë të fjalëkrijimit ai emërtion nocione të reja me prapashtesat përkëdhelëse, por edhe me nënkuptim tallës ose me nocione të njohura, por në mënyrë të re¹. Kështu p.sh.shkrimtari përdor prapashtesat: **-të, -kë, -(i)më, -(i)në, -ëm, -oj** jo vetëm me kuptim zvogëlues/lartësues ose përkëdhelës, por edhe nënvleftësues. Mund të përmendim fjalë të tilla si: **i midistë, i hynueshëm, konkë, vogëlimë, ballinë, i tokëm, mashkullonte** etj. Gjithashtu shkrimtari i përdor fjalët **matrapazllëk, birboja, sevdalli, lojçak** etj, mes personazheve të tij. Kjo është një mënyrë mjaft e njohur dhe karakteristike për ligjërimin bisedor të shqipes, të cilën Çela e fut duke emërtuar nocione të reja me prapashtesat që marrin nënkuptim tallës ose me kuptim keqësues si: **avashllëk, akraballëk, anadollëk** prapashtesën turke-**llëk**, Le të rendisim disa prej neologjizmave të të dy romanet: **shpatullore, kërkëllima, hamuliti, këmbësore, rrojtore, piktoral, kaçirbuja, bishtnuar, ufma, antiskeptik, hapërroja, buthonte, avancë, lojëcaku, mbrëmësoren, thëllitëse, murrëtyer, shtupec, tallazitje, ballinë, gazmonin, erëmonte, akullimë, kartelizuar, përhihej, shprushur, zhgrapur**, etj.. Të gjitha këto neologjizmat autori i krijon nëpërmjet parashtesave e prapashtesave, të cilat i japin karakter fjalës së autorit. Fjala e re është aq e fuqishme e individuale të Z. Çela sa që mund ta identifikosh lehtë veprën e tij por nga ana tjetër e bën edhe më interesante veprën për lexuesin.

Duke i parë me vëmendje neologjizmat në këto dy vepra fare lehtë mund të dallojmë, duke u mbështetur edhe në funksionin teorik të neologjizmave se: a) *autori ka spastruar gjuhën shqipe nga çdo fjalë e huaj e panevojshme si p.sh: mbrëmësore, këmbësore, rrojtore, shpatullore, e kurrëfartë, shurdhan, thëllitëse, kishte luluar, vogëlimë, isha kotuar, kafsharëve, qenërisht, grimherë, tasheparë, hamuliste* etj. b) *autori ka pasur për qëllim edhe ta pasurojë shqipen me fjalë, thënie apo shprehje, që burimin e kanë po në gjuhën shqipe p.sh: nisi të hamuliste për nisi të lehte, torbë për çantë, zilkat për zilet e vogla, i midistë për i dyanshëm, këmbësore në vend të trotuar, mbrëmësore në vend të lokal nate* etj. c) *“Me ndihmën e dialektit gegë” ai formon ndajfolje me prapashtesën geqe -shëm, si: përkohshëm, përbindshëm, përgjakshëm, hutueshëm, përzishëm, pashqitshëm, kobshëm, hatashëm, shpërfillshëm, volitshëm, etj..* d) *Po ashtu ai formon ndajfolje dhe emra përmes prapashtesës geqe- najë: qiellnajë, mbledhnajë, shkruhnajë* etj..

B Dialektizmat

Z. Çela ka përdorur edhe fjalë tipike geqe, si: **kryet, vëllam, nënkresa, thi, ajamin, pasha këtë ujë, rrenë, bane vetë, kallëzoj, kam ndigjue, po brente, e kremte, hangër, temjanë, ballinë, ronitur, uzdaja, shestim, hajni, amshimit, malcimin, gjakhupës, shtaga, balusha e diellit, portiku, pancir, baleci i zgjebosur, odave** etj..

Pikërisht kjo ka thyer kufirin dhe paragjykimin se gegërishtja është një dialekt i varfër dhe, për këtë arsye, standardja është formuar në bazë të toskërishtes. Ai përmes përdorimeve të tilla njëjtëson gegërishten dhe toskërishten si pjesë e shqipes dhe si domosdoshmëri tingullore dhe gjuhësore për t'u përdorur². Tingëllimi hundor dhe shkronjat e trasha të gegërishtes sjellin në veshin dhe në syrin e lexuesit funksionalitet tingullor-artistik. Konkretisht, Z. Çela nuk thotë lartësitë por ngrehinat, ose jo ka pasur vëlla por ka pasur vëllam, jo një i vrarë që nuk ka kush t'i marrë gjakun (sipas gjakmarrjes) por gjakhupës,

¹ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008; 134

² Gjovalin Shkurtaj, *Dialektet e shqipes*, Morava, Tiranë, 2012; 27

jo shpresë por *uzdaja*, jo *përjetësim* por *amshim*, për të sjellë te lexuesi shoqërizime gjuhësore-fonetike-artistike për të zhurmuar onomatopeikisht.

C Fjalëformimi

Fjalët e reja autori i krijon sipas gjedheve të ngulitura tashmë në gjuhën shqipe, duke përdorur mënyra të ndryshme krijimi. Pra mekanizmi gjuhësor themelor te neologjizmat është **fjalëformimi**. Fjalëformimi është një nga rrugët më prodhimtare të neologjizmave në veprën e Zija Çelës.

1. Vendin kryesor e zënë fjalët e krijuara me kompozim dhe me përngjitje.

a. *Kompozita bashkërenditëse*: Kompozita mbiemërore me strukturë mbiemër +mbiemër: **kulturoro-edukativ; arsimor-shkencor, kërkimor-shkencor, letrar-gjuhësor, ekonomiko-shoqëror, ekonomiko-sociale, psikologjiko-estetike, fetaro-filozofike, liriko-patetike, filozofiko-letrare, politiko-ideologjike, kulture-artistike, kulture-masive, etj..**

b. *Kompozita nënrenditëse*: **bojëçeliku, bashkëbiseduesi, vendndodhjes, shtypshkronjë, shkumëdeti, tjetërkush, dykëmbëshet, varavingon, vendbanimi, lejetakim, fletëthirrja, buzëgjak, ballafaqe, trulakror, syshqerrë, gjakftohtësine etj..**

2. **Parashtesat** a. **Formimi i fjalëve me parashtesën sh-/ç-/zh-** : Parashtesa **sh-/ç-** është parashtesë e shqipes me funksion privativ, si: **shfiguron, shtrajtim, e shprushur, shkokëruar, shkokërruar, e çmprehur, etj..** Shumica e fjalëve tema janë të vetë krijuara prej Zija Çelës si njësitë leksikore: **e ronitur, zbulimore, kishte luluar, peliçeri, mashkullonte, i midistë, lemzim, për mbrëmësoren, zhumbriat, dalëngadalshëm, qenërisht, murmuritëse etj.**

b. **Formimi i fjalëve me parashtesën nën-**: Këto ndërtime kanë kuptime dhe funksione të

kundërta dhe luajnë rolin kryesor për kundërvenien e kuptimeve të fjalëve përkatëse me temë të njëjtë. Ato mund të formojnë fjalë antonime folje, e mbiemra. Fjalë të formuara me parashtesën **-nën**, në vepër hasim të tilla si: **nënkresës, nëndhoma, nëntoka, nënçmim, nënbishti, nënqesh, nënshtrimin, nëntavanit, nënshkruante, nënqeshje, i nëndheshëm etj..**

c. **Formimi fjalëve me parashtesën super-**: **superdrita, superharmoni, superprodhim, superpastrim, superhumani etj..**

d. **Formimi i fjalëve me parashtesën kundër-**: Fjalë të formuara me parashtesën kundër kemi hasur në formime të tilla si: **kundër + emër p.sh. kundërveprim, kundëratdhe, kundrapostë, kundërsulm, etj..**

e. **Fjalë të formuara me parashtesën ndër-**: Kjo ndajshesë u ngjitet emrave të caktuara dhe foljeve si p.sh.; **ndërqytetase, ndërshtetas, ndërdyshej, ndërmendjet, ndërdalja, ndërmerrja, i ndërveproj etj..**

f. **Fjalë të formuara me parashtesën pa-** : të **panatyrshme, e papritur, të pabërën, i pathyeshëm, e paprovuar, padashur, papritur, i pakënaqur, i pafuqishëm, të pandreqshëm, të pagabueshme, të papërgatitur, të pandryshueshme, të pazakontë, i pafytyrë, e pambërritshmja, e pavend, të pasgjësueshme, i paligjshëm, pashoqërueshme, i paudhë, e pashërueshme, pavarësish, panumërtat, e pakontrolluar, e pavend, pafundme, i papushimtë etj.** Kryesisht parashtesa pa- i paravihet mbiemrit ose në ndonjë rast edhe pjesoreve të foljeve.

g. **Fjalë të formuara me parashtesën për-**: Ndajshesa për- është relativisht prodhimtare në gjuhën shqipe. Ajo është shfrytëzuar sidomos në formimet foljore³. Kjo tendencë e fundit vihet re edhe tek autori ynë, por ai e ka përdorur me mjeshtëri edhe përpara emrave apo mbiemrave prejpesorë të formuar prej saj si:

³ Shaban Demiraj, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe. 1, Tiranë, 1961; F. 89.

përбетим, përлотур, përmbajnë, përskuqe, përskuq, përбrenda, te përmbushej,, të përparonin, përkushtim, i përkulur, përgjatë, e përskuqur, përмendnin, përqëndrohesha, m'u përshkuan, përdhunuar, përmatanë, përфle, përkundruall, përcakton, përparim, përjetoja, përulësi, përвуajtje, përземërsi, përмendnin, përdorte, u përmbajta, t'u përshëndetur, i përndjekur, e përkthyer, përpilij etj..

gj. Fjalë të formuara me parashtesën ri-, stër-, anti- : Parashtesa ri- bashkohet me emra foljorë ose folje: ripërtëritjen, rigrumbullim, riprodhim, rifantazoi, ripësëritjen, u rigjetëm; parashtesa -stër- bashkohet me emra: stërgjyshi, stëkëmbësin; me folje: stëpyetur, të stërlodhur, paraфjala - anti- bashkohet me mbiemra dhe u jep fjalëve kuptim të kundërt: antiskeptik, antifeministët, antinjerëzor, antifamiljar, antiinflamatorin etj.

h. Parashteso-prapashtesore: përvëlueshëm, përballoj, përмend, përhumбur, përлотim, përмалloj, i përkohshëm, përhumбshëm, të përkequr, përmatanë, pazgjidhshëm, pashqitshëm etj.

3. Fjalët me prejardhje prapashtesore

Në materialin e vjelë gjejmë fjalë leksikore të krijuara me këto prapashtesa:

- a. Ka prapashtesa që formojnë emra: Voglima, uffma, shkundullim, vetullor, këmbësore, rrapëllima, bulërima, hapërim, (kjo folje është formuar nga emri hap), vetmo/ vetmim, buzëto/ buzëtim, fëlliqëso/ fëlliqësim, varësohet/ varësim, grinëso/ grinësim, balbëzo/ balbëzim, koketoj/ koketim, lagështoj/ lagështim, errëtoj/ errëtim, hovno/ hovnim, shurdhëro/ shurdhërim, këngëto/ këngëtim, hakërro/hakërrim etj. Nga prapashtesat o-; to-; (ë)so-; zo-; janë formuar emrat prejfoljorë me prapashtesën im- në të gjitha rastet e tyre, ndaj ne i kemi paraqitur si një varg sinonimik folje/ emër i derivuar prej saj. Hungëro(hungëronin), sokëlllo(sokëllinin),

buhas(buhasnin), kërris(kërrisnin), mek (mekërinin), bulëro (bulëronin), etj..

b. Me prapashtesën- kë ose -ca(t) Kjo prapashtesë u jep fjalëve një nuancë zvogëlimi të cilat i japin ngjyime fjalorit të Z. Çelës psh: zhumbricat, rrugicat, belbacuk, tokicë, pakicë, copkë, vajzkë, marroke, cironkë, copkë, hundka, deriçkë, etj.

c. Me prapashtesën -shëm: ethshëm, mistershëm, vrullshëm, hatashëm, dukshëm, hershëm, volitshëm, rëndshëm, thekshëm, rrezikshëm, kobshëm, rëndshëm, i ndritshëm, i ujshëm, përvëlueshëm, tmerrshëm, i sjellshëm, etj..

ç. Me prapashtesën or/e;tor/e: shitore, kançelatore, këmbësore, rrojtore, thashetheminor, fushator, mbrëmësore, dashurore, imitator, gjellëtoe, parimore, bujqësore, verore, burimore, gjakësore, bashkëshortor, fjalëtor, shurdhëtoe, inatçore etj.. Z.Çela është mjeshtëtr i krijimit të neologjizmave nëpërmjet prapashtesave me prapashtesën or- ose tor- ka krijuar vendin në të cilin gjallojnë gjak, mbrëmje, shëtitore, fjalët.

d. Me prapashtesën-ëz; -th; -tinë ose -inë; -imë: Si prapashtesë zvogëluese ose që i japin fjalës ngjyime përkëdhelëse edhe kjo gjendet dendur në fjalësin e Çelës, si: pakëz, sharrëz, kafshëz, zakonth, shpirth, çapth, atyparthi, zgupthi, këmbëngulthi, shalthi, cikërrimë, rrokëllimë, thurimë, flakërimë, drithërimë, akuarinë, etj..

e. Me prapashtesën -të: Me anë të kësaj prapashtese Z.Çela emrat e tipit: mish, zall, kërcunj, flak, çelik ka krijuar mbiemra të tipit e mishtë, zallishtë, e kërcunjtë, e flaktë, i çeliktë, të mjaftë, i behtë, i ngadaltë, i mizortë, i mizortë, i vrulltë, të njëllotë etj.

f. Me prapashtesën - ëri ose -i: Tipat gramatikorë që autori u vendos këtë prapashtesë janë të ndryshëm emra, mbiemra, folje, ndajfolje por që të gjithë formojnë emra abstraktë: shenjtëri, qelqëri, përpikëri,

foshnjëri, kafshëri, varfërii, shtrigëri, fajlëri, qelqëri, flakëri, zhurmëri etj..

g. Prapashtesa të ndryshme -osh; mendosh, kodosh, barkosh, trëndafilosh etj.

-arak; fusharak, dredharak, bredharak, qesharak, pusharak etj.

-ajë; gjethnajë, akullnajë, bërtajë, etj.

-ist/e; humaliste, sjellje drejtoriste etj.

-ash ose -shan; kafsëshaz, këmbëzash, egërshan, etj.

-anë; përgjëranë, çoraphanë, etj.

-adë; fasadë, bllokadë etj.

-ane; verbane, nargjilane etj.

-ak; frikacak, lojëcak etj.

-tar; vdekatar, ëndërrimtar, vrastar etj.

-isht; besnikërisht, qenërisht, përkohësisht etj

Pra: Ndihej si të reja emrat **gardhim, krrokatja, hamullitja, buhatja, hungërima, vringëllima, rrapëllima, zhurmërima, hapëro, mastero, buzëto, babëzo, etj..** Autori ndërton fjalë origjinale, si: **rrojtore, nënkresa, mbrëmësore, këmbësore, kafsharësore, kafsharëve, mashkullarizuar, kafshërisht etj.** Nuk është e vështirë të arrish në përfundimin se fjalëkrijimi zë një vend të rëndësishëm në fjalësin e Z. Çelës, i cili është i pasur me shtresa të ndryshme leksikore. Grupin e fjalëve e përbëjnë kompozitat, të cilat i gjejmë si epitete, por edhe si emra apo metafora gjuhësore p.sh. **zemërdhembshur, kokëgdhë, gojëndyer, dritëshkurtër, keqbërësi, peshëlehtë, gjaknxehtë, trup- e shpirtshprishur,**

rrumbadumbat, uffebuffet gjithëfarëgjënë, gjakhupës, këmbëzbathur, keqbërës, vramendës, etj.. E veçantë në fjalëkrijimet e Z.Çelës është se ato tingullojnë si të njohura, mjeshtëria shfaqet në efektin që shkakton mjeti i ri. Përmbajtja kuptimore e kompozitave mbiemërore nuk është e kuptimeve të fjalëve përbërëse, por është përfutur një kuptim i ri, i cili i jep mundësi autorit të plotësojë kërkesat e veta estetike me të madhe.⁴

Shumë kompozita kanë marrëdhënie metaforike, kështu që fjala e re ka kuptim të figurshëm, psh: **këmbëmbarë, syqorrësia, mbamendjes, faqeb ardhë, rrokaqiell, bjerraditë, gjithologu, buzmbake, mendjelehtë, etj.**

Neologjizmat **sypatrembur, buzëqeshjeftohur, bashkëatdhedashësit, moralhumbur, gjithëfarëgjënë, gjysmëxhokonda, fantazmëndjellës, gjysmëkërkimi etj.** kanë hyrë në marrëdhënie me njëra-tjetrën jo në kuptimet e tyre të para. Te romani "Gjysma e Xhokondës" gjejmë disa neologjizma të krijuara me përbërje, të cilat i përkasin stilit zyrtar administrativ si: **fjalëshkëmbimi, raportshkruesi, karakterdobëti, moralprishur, miradashësit, paqedashës, dhehapësit, internacionalizmi, daktilografisti, zëvendësministra etj** të aktualizuara në fjalëkrijimin e autorit. Çela iu jep shumë rëndësi përdorimit të onomatopeve, të cilat i përdor për funksione të ndryshme brenda frazave. Disa prej tyre, të cilat nuk i kemi hasur më parë janë: **fapfupet, kuakin, kuakitje, kërkëritje, mërmërita, dërr-dërr, buburiste, hamuliste, buluronte, rumba-dumba, kërkëllitën, krakavitën, shrrap-krrap, uffebuffet, fërshëllima, hungëronin, buhasnin, lehnin, flaaapp-flaaapp, trak-truk, gam-gam, ha-haa hi-hii-hiii hu-huuu, etj..**

Kemi veçuar fjalë ose kuptime fjalësh që nuk pasqyrohen në FGJSSH, Tiranë, 1980 dhe 2002, 2006. Fjalë të kësaj kategorie janë: **shkrimëria,**

⁴ Shefkie. Islamaj, *Gjergji Fishta, Gjuha dhe stili II*, Prishtinë, 2012 ; f. 265.

çoraphanë, famëpërhapur, fantazorësh, falëpërgjues, follorinas, rrojtore, gjatovini, dhehapësit, keçtores, fantazmandjellës, mendimshkurtër, pilivricka, laurishës, torsis, morebra, pashpirtësi, pekineze, pijetari, kuplaratë, njeri i lamizuar, ajamin, punëduruar, punëpazgjidhur, beditjen, gjeneraleske, trulakror, gjojaeksperti, etj., (të gjitha fjalët që kemi dhe shembuj janë fjalë të pagjendura nëpër fjalorët e gjuhës shqipe). Nga gjithçka që trajtuam më sipër mund të themi se krijimtaria e Zija Çelës liston fjalë që nuk hasim në fjalorët e gjuhës shqipe, apo në leksikun e shkrimtarëve të tjerë shqiptarë. Çela evidentohet në letrat shqipe si një nga individualitetet krijuese që ka ndikim të dyanshëm si te lexuesi ashtu dhe në gjuhën shqipe. Neologjizma ndryshe autori ka përdorur me disa fjalëformime për të tipizuar personazhet aq sa i shërbejnë qëllimit të tij si fjalë të tilla, të cilat lidhen me sferën administrative, me emërtime postesh administrative dhe qeveritare si: **deputetllëkshëm, ministrokërkues, politikanoletrari**, etj..

C. Arkaizmat që Çela përdor në prozë janë të tilla: **kuplara, katoq, aksham, cimbis, lëngatë, amshim, fanitje, nënkresë, dyll i brydhët, fanepset, u gjegj, xhikë** etj.. Këto përdoren në stile të ndryshme për të paraqitur më me vërtetësi epokën dhe njerëzit e asaj epoke. Sidoqoftë, arkaizmat përdoren më rrallë në veprën sesa historizmat.⁵ Autori nuk ngurron të përdorë edhe fjalë të ligjërimit bisedor që shërbejnë për karakterizimin e stileve gjuhësore, si: **xhagajduri, jatak, sokak, hamall, çapraze, ledh, rrëmet, muhabet, rrezatimi prafullues, çfarë ploje, soj, bash, esëll, gëlltisja, të kokolepsura, çakërrqejf, krusmë, teveqel, hyzmeqar, begenis, rrenat, xhahil, shkartisja, ulok karroce, dafrunga, kisha xanxa, babloku, berihaja, gafil, sevdalli, jaran, dëngla, fodull, esëll, xhanëm, batërdis, qerrata** etj.

Leksiku popullor në veprën e Çelës zë një peshë të veçantë, paraqitet shumë i pasur në sasi dhe në tipologji. Autori zotëron shumë mire jo vetëm potencialin gjuhësor të dialektit verior,

por edhe atë të dialektit jugor, etj dhe nuk ngurron t'i përdorë ato në ligjërimin e vet gjithmonë në varësi të temës, subjektit, kulturës, profesionit të personazhit. Fjalët dialektore janë të shumta sidomos për të dy dialektet: **vëllam, gjitonia, lukthi, lazdran, tranon, apet, balec, mandall, odë, setër, vajzushka, çupëlinkat, katoq, sokak** etj..

D Shtresa leksikore me burim të huaj

Në prozën e Zija Çelës hasim shtresa leksikore me burim nga turqishtja e italishtja. Gjithashtu bie në sy përdorimi i shtresës leksikore me burim të huaj, denduria e sllavizmave dhe fjalët me burim neolatin.

Turqizmat- përdoren më tepër në sfera të tilla, si: lufta, petkat, jeta shtëpiake, administata.⁶ Fjalë të tilla Çela përdor në gojën e personazhit për të treguar mendësinë e tij, por gjithmonë në masën e duhur, si psh: **karllash, zeherliu, hende, aksham, nursëz, tepsis, hambar, kafe, haber, xhezve, anadollak, pazar** etj.

Greqizmat- në prozën e Çelës janë përdorur këto fjalë të tilla, si: **farmak, hir, farmakos, feks, oreks, pleks, stolis, avlli, lakër** etj.

Sllavizmat- Në veprën e Çelës kemi një numër relativisht të vogël të huazimeve sllave, si **killapi, kopaç, kovë, trup, grabit, oborr, habi, padit**, etj.

Kurse huazimet me burim neolatin që hasim te Çela janë: **qen, faqe, fëmijë, mik, shok sugjestionuese, vanitet, vanitoz, vitalitet, sentence, sesion**, etj.

E Njësitë frazeologjike dhe fushat e tyre konceptore

a. Që të arrihet një ligjërim figurativ, folësi (shkrimtari në këtë rast) duhet të përdorë

⁵ Jani Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2008; 234

⁶ Tahir Dizdari, Hyrja te Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005; 7-8

shpesh e domosdoshmërisht edhe njësi frazeologjike si në rastin e prozës së Z. Çelës. Ato janë një pasuri jashtëzakonisht e madhe e gjuhës shqipe edhe si pjesë përbërëse e strukturës leksiko-semantike të saj marrin pjesë në procesin ligjërimitor me funksionin e tyre shënues, dale si barasvlerë e fjalës.⁷ Frazelogjinë e gjejmë të pranishme në prozën e Zija Çelës në mënyrë të tillë: *Të vdekurit me të vdekurit, -tha Burona,- të gjallët me të gjallët/njësi frazeologjike me strukturë fjalie*; Ngrihu, *more egoist i moralit, rrufeja nuk bie në hale/ njësi frazeologjike me strukturë fjalie*; Vdiq mëshira!/ *njësi frazeologjike me strukturë F+E*; I zuri vendin,/ *njësi frazeologjike me strukturë F+E(e paraprirë nga një trajtë e shkurtër)*; frynte erë e thatë dhe e zhurmshme/ *njësi frazeologjike me strukturë F+MB+MB*; kokë shkëmb/njësi frazeologjike me strukturë E+E; baleci i zgjrbosur/ *njësi frazeologjike me strukturë E+MB*; dykëmbësh skërfyell/ *frazelogji me strukturë E+MB*; mos e vrit mendjen/ *njësi frazeologjike me strukturë pjesëz mohuese mos +F+E*; I qëndroja afër/njësi frazeologjike me strukturë F+NDJF, I rri pranë/ *njësi frazeologjike me strukturë F+NDJF*, vrima e fundit e kavallit/ *njësi frazeologjike me strukturë E+MB+E*; sevdalli i pjergullës/ *njësi frazeologjike me strukturë E+E*; dackë flakëruese/ *njësi frazeologjike me strukturë E+M*; ia thyente turinjtë/ *njësi frazeologjike me strukturë F+E*; e shkurtër është jeta/ *njësi frazeologjike me strukturë MB+F+E* etj karakteristika e veçori dalluese.

1. **Fusha konceptore dhe frazeologjike që lidhet me hapsirën:** autori këto fusha konceptore i përdor në njësi frazeologjike si me ngjyrim pozitiv lartësues: **M'u duk se fluturova në hapsirë e u ktheva prapë** (emocion aq i fuqishëm sa që duket sikur të shkëput nga realiteti), por edhe me ngjyrim negative p.sh Më ra qielli në kokë kur Fiona më tregoi moshën e tij.. autori përshkruan tronditjen që pëson personazhi kur merr vesh se sa vjeç është i dashuri i mamasë së tij, duke futur frazeologjinë më ra qielli në kokë lexuesi arrin të kuptoj dhe përfytyroj se si ndihet personazhi.

⁷ Jani Thomai, Fjalor Frazelogjik i Gjuhës Shqipe, ASHSH,Botimet EDFA, 2010; 20

2. **Fusha konceptore dhe frazeologjike që lidhet me zooparkun:** Ja disa shembuj të fushës konceptore dhe frazeologjike të zooparkut: **Ujku u bë njeri apo njeriu u bë uj?** (pyetje retorike); **Ujku ha larg nuk e prek tufën e tij**; **Gorilla që kisha në rah më tha....(njeriun që ka pranë presonazhi e quan gorillë)**; **Midis luanëve dhe njeriut ai zgjodhi të qëllonte njeriun**; **ç'duan xhevahiret në atë putër, pyeta veten, një ari do të parapëlqente më shumë shtatë llokma mish, se sa shtatë gurë të çmuar**; **...njeriu -majmun pësëriti gjestin e gorillës, rrahu gjoksin me putra**; **Një luan smund të lideroj pa qenë mosmirënjohës, dinak dhe arrogant. Më mirë qen bir qeni se njeri**; **Por kishte nga ata që rrin in sus, si të ishin rrahur qysh këlysh**; **Zebrat bënin sfilatë mode**; **S'do ti bënte zemra të hakëmerrej ndaj një gomari**; dhe **piu gjakun e ftohtë të një gjarpri**; **Me gripin në gojë**; **Shtatin njeri e mendjen thi, thi i egër madje**; **Ora Zoo**; **Po sikur këo të mos jenë egërsira të vërteta, por njeri-shtazë?!**; **Qenka si dielli i mesditës ky luan**; **Atë syphilivesën zgjodhi...** (përshkrim me konotacion negativ); **Pse e humb si lepuri para zagarit?!** (pse hutohesh); **Kur zgjaste dorën edhe milingonat shtireshin si të ngordhura**, **Fjona u fliste me zë, unë sjam budallaqe nuk ma hidhni dot!** ; **Vrit miza, mama, vrit miza**; **Dykëmbëshe me pupla (pulë)**; **Mjaullima e maçokut mund të sprapsë vetëm macet, por jo felinë (ngritja e zërit nuk më tremb)**; **Ai ngulmoi se ishte në gjendje të zbulonte edhe gjurmën që lë zogu në ajër (zbulues i zoti)**; **Tomi Domi po shihte me sytë akull, si të ishte e mundur që po ashtu si peshk, edhe vështrimi të ftohej në frigorifer (shihte pa lëvizur)**; **Qafë sorrë (qafë hollë)**; **Paska ngordhur baleci i zgjebosur**; **filloi të hamuliste si një qen**; **qen i zgjebosur**; **çdonte të tregonte me atë mjekrën e gjatë si cjaq malesh?; etj.**

3. **Fusha konceptore dhe frazeologjike që lidhen me mallkimet:** Në prozën e Z.Çelës kemi dhjetra njësi frazeologjike që shprehin një mallkim. Ajo që vihet re te këto njësi është që mallkimi shkon deri në ekstrem dhe shumica e tyre lidhet me fjalën vdekje si: **Thefsh qafën! mallk. Vdeksh!**- **Më tha thefsh qafën;të vënça në arkë! mallk, vdeksh!** – **Më çmëndi me këto fjalë që e vënça në kuti, e vënça!** ; **mos u bëftë të bëhet! mallk.vdektë!** **Mos u rritë a mos jetoftë gjatë!(mallkim i nënës për djalin)- Po çtë bëra, mor i mallkuar, që mos u bëfsh të**

bëhesh! Apo se të rrita një llokmë mish! ; Të mbledhshin me çarçaf ! mallk. vdektë! – E mbledhshin me çarçaf, o Zot! Ma bëri jetën ferr. haram qumështi i gjirit! mallk. (për dikë që tregohet mosmirnjohës ndaj atyre që e kanë rritur a që janë përkujdesur shumë për të).

4. **Fusha konceptore që lidhet me sharjet:** Fusha konceptore dhe frazeologjike që lidhet me sharjet është goxha e gjerë në prozën e Z. Çelës dhe ne do të listojmë një pjesë të tyre: **Dhi arrakate shar. vajzë që nuk mblidhet në shtëpi, që bredh poshtë e përpetë, vajzë e egër, e pashtuar në punë a në shkollë; dhi e egër. Po ti dhi e egër ke qenë që e vogël, dy gurë bashkë nuk lije., (Let. art.). Sevdalli i pjergullës; Ia ka sevdanë (dikujt a diçkaje) vjet. e shikon me zili, do që ta ketë për vete; e pëlqen, e do; ia ka qejfi (dikë a diçka) me sevdalli i pjergullës donte të thoshte se ishte pijanec....**
5. **Fusha konceptore dhe frazeologjike që lidhet me vdekjen dhe botën e nëndeshme:** Si fillim ndeshemi me varrin e varrimin ku autori zgjedh ti përshkruaj këto procese sipas traditës sonë kur ai thotë: **e mbuluan arkivolin me një velenxë ngjyrë jeshile me xhufka; U nisëm në varreza duke u çapitur në radhën e dytë, menjëherë pas njerëzve të Talan Bicit. Në krye fare shkonin ata që mbanin në supe arkivolin.; Ja hëngrën bukën; Nuk i qajmë natën të vdekurit; Mbaroi thërrisni priftin.etj...**

Në veprën "Gjysma e Xhokondës" vjen një moment kur lexuesi nuk di a po zhvillohen ngjarjet nën apo mbi tokë por shumë shpejt ai mund të qartësohet në rreshtat: **"Hyra dhe dherat prapë u mbyllën pas meje".** Dhe një përmbyllje :**" Pandeha se po më thyheshin dhëmbët, por hiç, kishin qenë grimcat e dheut."** Lexuesi e kupton që tashmë ngjarjet janë zhvilluar nëntokë.

Përfundimet:

1. **Zija Çela** formon mjaft neologjizma me parashtesa e prapashtesa të ndryshme, ku vendin kryesor e zënë mbiemrat e formuar me kompozim: **gojëndyer, trulakror,**

dhëmbëhapuri, qafecungu, marrafrymëse, çakërrqejf, etj..

2. Edhe fjalët e përngjitura nuk mungojnë në fjalësin e prozës së shkrimtarit tonë. Të tilla janë: **pakmëparshëm, pushkatarësh, atëbotë, gjakftohtësinë, caditore, ditënata, gjakhupës, njëditzaj, gjithëfarsojë, askush, dhomëndenjjen, drejtpërsëdrejti, e atypëratyshme etj..**
3. Si mjeshtër i vërtetë i ringjalljeve Z. Çela gjallëron fjalë krahinore e dialektore për qëllime artistike. Fondi leksikor i veprave të Çelës përfshin fjalë nga të gjitha fushat tematike. Shembujt janë të shumtë si : **vëllam, odave, cimbis, sumbullat, dofarë, baleci, setra, blinj, çardak, njëditzaj, gërvinë, buluronte, katoq, kaçirubja, hafije, isharet, pantofël, bahçe, shpatullorte, gërmuq, verbane, të marroftë, ahti,nëmtë, sevdalli, mënjollë, kërthingla, shuplaka, bumballë, t'ia grahim, zdërhallje, kafjallin, shajninë, derdimen, leskër, thi, grigja etj..**
4. Njësitë frazeologjike i përdor të fushave të ndryshme konceptore si: Fusha konceptore dhe frazeologjike që lidhen me mallkimet, sharjet, zooparkun, me botën e nëndeshme, etj..

Literatura

- 1Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008; 134
2Gjovalin Shkurta, *Dialektet e shqipes*, Morava, Tiranë,2012; 27
3 Shefkije Islamaj, *Gjergj Fishta, Gjuha dhe stili II*, Prishtinë, 2012 ; 265.
4 Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë,2008; 234

5 Tahir Dizdari, *Hyrja te Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005; 7-8

6 Jani Thomai, *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, ASHSH, Botimet EDFA, 2010; 20

Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe*. 3, Tiranë, 2017; 76

Idriz Metani, *Studimi i leksikut të shqipes dhe teoria e fushave leksikore e semantike, në "Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë", Tetovë-Shkup, 2009; 23-8*

John Lyons, *Semantics*, 1, 2, Cambridge, 1977.

Kol Ashta, *Neologjizmi dhe vëzhgimi i tij në leksikografinë tonë*, "Buletin i Institutit

Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës", 1970; 9

Shefkie Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985; 44

Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*. 1, Tiranë, 1961; 89

Analizë e funksioneve të hyrjes në ligjërime ceremoniale të Nolit

Dr. Albana Shijaku

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

albana_shijaku@yahoo.com

Abstrakt

Ligjërimi në publik është një nga sfidat me të cilën çdokush herët a vonë do të përballë në çdo fushë të jetës. Gojëtaria ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve ndër vite për të zbërthyer nga ana komunikative funksionet e saj dhe ndikimin e tyre mbi publikun. Në këtë artikull do të diskutohen disa nga funksionet më kryesore të hyrjes së fjalimeve. Materialet për të konkretizuar analizën janë përzgjedhur nga fondi i çmuar i krijimtarisë Noline. Gojëtaria shqiptare ka shumë oratorë, vepra e të cilëve ka lënë shenjë në kontekstin kohor në të cilin kanë ndodhur. Por ajo që spikat mbi të gjitha është gojëtaria noline. Noli ishte një erudit i cili la gjurmën e tij në shumë fusha të krijimtarisë dhe një ndër to është dhe gojëtaria. Fjalimet e tij me tematikë të gjerë, tekstet e ngarkuara me figura letrare dhe stilistikore, ligjërimet me pathos dhe elokuencë të lartë janë një burim i çmuar, prej të cilit ka gjithmonë diçka të re për të studiuar dhe aplikuar.

Nëpërmjet analizës së disa prej ligjërimeve Noline, ky artikull synon të vërë në pah mënyrën mjeshtërore të përdorimit të funksioneve të hyrjes për të ndikuar publikun. Duke vënë në pah disa prej shembujve të përdorur në ligjërimet e Nolit, kjo analizë gjithashtu synon të ndërgjegjësojë ligjëruesit për rëndësinë e studimit dhe aplikimit të këtyre funksioneve në fjalimet apo prezantimet e tyre.

Fjalët kyç: *ligjërim, hyrje, funksione, gojëtari, publik*

Abstract

In all aspects of life, public speaking is one of the challenges that every individual will inevitably confront. Over the years, numerous scholars have been intrigued by oratory to analyse its communicative functions and the resultant public impact. Certain critical speech input functions will be examined in this article. The resources utilised to implement the analysis have been meticulously chosen from the invaluable work of Nolian ingenuity. There are numerous orators in Albanian oratory whose contributions influenced the era in which they performed. However, the most notable aspect is the Nolian oratory. Noli, an erudite, made significant contributions to numerous domains of artistic expression, including oratory. Deliveries imbued with pathos and eloquence, texts overflowing with literary and stylistic figures, and speeches with expansive themes constitute a priceless source from which something novel is perpetually accessible for analysis and application. This article analyses several of Nolian's speeches to demonstrate how deftly he employed introduction functions to persuade and influence his audience. By expanding on several instances cited in Noli's speeches, this analysis further attempts to engage speakers in the critical nature of studying and implementing these functions when delivering speeches or presentations.

Key words: *delivery, introduction, function, oratory, audience*

Noli si figurë shumëdimensionale, gjithmonë ngjall kureshtje studimore pasi vepra e tij është një burim i pashtershëm njohurish gjuhësore, letrare, estetike, historike, politike dhe shumë të tjera. Në këtë punim do të analizohet vetëm një pjesë e vogël nga gjithë trashëgimia Noliane dhe më saktë disa prej fjalimeve ceremoniale të tij, për të parë se si një ligjërues përdor funksionet e hyrjes për të arritur qëllimin e tij komunikativ me publikun. Nga fondi i gjerë i trashëguar prej tij, u përzgjedhën disa ligjërime të periudhës me temë patriotike. Kjo periudhë, e viteve 1906-1920, ndryshe nga periudhat e tjera të ligjërimeve të tij, karakterizohet nga krijimi i fjalimeve ceremoniale me natyrë frymëzuese ose bindëse për popullin. Në periudhën e dytë, që shtrihet respektivisht në vitet 1920-1930, Noli ligjëron fjalime të natyrës politike kryesisht në foltore kombëtare dhe ndërkombëtare. Më pas në periudhën e tretë, 1930-1965, kur ai tërhiqet nga jeta aktive politike dhe patriotike, tematika merr një natyrë më informuese dhe të përgjithshme, mbi të mirat dhe cilësitë e jetës së përditshme.[1] Fjalimet ceremoniale janë të shumtë ashtu si dhe llojet e tjerë ndikues me natyrë politike apo parlamentare, të cilat i përkasin më së shumti kohës kur ai zhvilloi funksione me natyrë politike.

Noli si ligjërues përdor shumë teknika dhe funksione të trashëguara nga Greqia e lashtë ku gojëtaria kishte kulmin e saj. Ligjërimet e tij kanë një densitet të lartë figurash e mjetesh stilistikore, të cilat ka raste që mbivendosen në text. Në to përdoren teknika të larta të të shprehurit dhe të komunikimit. Si lëvruet i panegjirikeve, elegjive, fjalimeve motivues patriotike, Noli me stilin e tij unik komunikon me publikun nëpërmjet figurave letrare të shtrira në text si metafora, personifikimi, paralelizmi etj. Përveç elementëve stilistikore, ligjërimet kanë dhe organizim që i bindet ligjësive të trekëndëshit klasik Ethos-Pathos-Logos [2] të përshkruara në Retorika nga Aristoteli. Në hyrjet e fjalimeve gjen të mishëruara të gjitha funksionet e hyrjes, të gërsheturara me strategji dhe figura letrare. Noli ishte njohës shumë i mirë i teknikave të ligjëritimit sikurse edhe i publikut, më së shumti atdhetarë në mërgim për të cilët ligjëroi kryesisht në periudhën e parë të krijimtarisë së tij, periudhë nga e cila janë përzgjedhur edhe fjalimet për të studiuar funksionet e hyrjes.

Hyrja në një fjalim publik ashtu si edhe në tekste të tjerë zë normalisht 10 deri në 15 përqind të të gjithë fjalimit.[3] Në formate tekstesh të tjerë rëndësia e hyrjes është e padiskutueshme në të gjitha funksionet e saj, por në ligjërimin e folur hyrja merr përmasa të tjera. Shumë gojëtarë të afirmuar pohojnë se një hyrje e organizuar dhe e prezantuar mirë është një nga elementet vendimtarë të fjalimit, pasi është koha kur merret vendimi më i rëndësishëm nga ana komunikative. Publiku gjatë hyrjes vendos nëse do të vijojë t'i kushtojë vëmendje pjesës tjetër të ligjëritimit ose jo, të krijojë një ide të qartë se si

fjalimi vijon dhe se si ai do të mbyllet. Fjalimi si formë e folur, ndryshe nga format e tjera të shkruara të teksteve ku lexuesi ka mundësi t'i kthehet dhe rikthehet në lexim një pjesë të caktuar, ofron mundësi më të limituara për dëgjuesin, pasi është një akt i vetëm komunikimi, që ndodh në kohë reale i ndikuar nga të gjitha kompleksitetet unike të kontekstit ku dhe kur ndodh.

Ndër funksionet më kryesore të një hyrjeje që gjejmë të aplikuara në fjalimet e Nolit janë: ai i tërheqjes së vëmendjes dhe interesit të publikut, fitimi i besimit të tyre duke dëshmuar kompetencat dhe përfshirjen në temën e zgjedhur, përcaktimi i qartë i qëllimit të ligjëritimit dhe ideja kryesore e tij, si dhe i paraprihet strukturës në vijim të fjalimit, funksione që përkojnë me teoritë e prezantuar nga Sokrati, Aristoteli, Quintilian, Cicero [4] dhe të zhvilluara ndër vite nga shumë gojëtarë e teoricienë si Adams Sherman, John Rippingham, Noah Webster, Thomas Sheridan e shumë të tjerë.[5]

Noli përdor teknika të shumëllojshme për të tërhequr vëmendjen e publikut. Ndër më të spikaturit janë thirrmoret si ata të thjeshtë dhe ata të përsëriturit:

"Shqiptarë! Shpesh nuk është asfare nevojë të flasësh, po arrin të tregosh me gisht dhe të heshtësh..."

"Vëllezër dhe motra, besnikë të shumtë që merrni pjesë në këtë meshë sot..."

"Ja jetë e Apostullit, o vëllezërit e mi, e shkruar prej atij që e vuajti..."

"E lumtur qoftë udha që barite..."

E lumtur, me dafina e trëndafile të paçmueshme le të jetë shtruar udha që barite, o shpirtndritur atdhetar, o trim me fletë, o bir i shtrenjtë i nënës Shqipëri. ..." [6]

Po ashtu ai dallohet për përdorimin pyetjeve retorike të shtrira, pyetje që nuk kërkojnë përgjigje të drejtpërdrejta, si një prej teknikave më të suksesshme të përdorura që nga lashtësia.

"Përse dëfrejnë sot tërë bota? Përse gazi derdhet nëpër udhëra posi rrëke që zbret nga mali? Përse gjithë bota, të ndrruar e të stolitur, baresën me zemër të hapur dhe me faqe të ndritur? Përse trokëllejnë në tërë anët dyfegjet? Mos u ngjall ndonjë Krisht i ri dhe i duallë përpara ta presin vashëzat e mveshura me rroba të bardha?..." [7]

Teknika e përdorimit të pyetjeve retorike në hyrje shpesh vjen dhe në kombinim me mbylljen ku pyetjet marrin përgjigje. Ndërkohë publiku përfshihet në ligjërim pasi automatikisht ai kërkon përgjigjet e pyetjeve mes njohurive të tij dhe përfshihet në çështjen që Noli do të ndajë me të.

Një prej strategjive të veçanta të tij është dhe përdorimi i thënieve të marra nga autorë të mëdhenj si Dante, Shekspiri, Bibla e të tjerë. Këto përzgjedhje nuk janë rastësore për Nolin si njohës i thellë i krijimtarisë botërore, por dhe i atdhetarëve të tij. Ai zgjedh autorë të mirënjohur për të hequr vija

paralele mes historive të rrëfyera prej tyre dhe historisë shqiptare. Ai gjithashtu zgjedh dhe citime nga Bibla duke ditur se publiku ishte besimtar dhe praktikant.

"...Po ja si gjëmon kundër këtyre Profeti Isaia: 'Perëndia është me ne. Dijenë o kombe, dhe munduni. Veni vesh gjer mbanë të dheut, o të fortë do të dërrmoheni, se dhe në u forcofshi, prapë do të mundeni, dhe çdo këshillë që të merrni do ta përndajë Zoti dhe fjalën që do lithni, do mos qëndrojnë nër ju, se Perëndia është me ne.'" [8]

"Nessun maggior dolore che ricordarsi del tempo felice nella miseria..." Dante Inf. C.V.121-123

"S'ka më të madh hidhërim se sa të kujtosh kohën e bardhë në mjerësi..." [9]

Përkthimi me inversion i strukturës mbiemër-emër, strukturë e përmbytur në gjuhën shqipe, i bërë me mjeshtëri prej tij, zgjon gjendjen emocionale të dëgjuesit që në hapjen e fjalimit, për të vijuar me paralelizmin me kohët e bukura dhe të bardha të Gjergj Kastriotit.

Pjesa më e madhe e ligjërimeve të Nolit kanë ardhur në formën e shkruar të tyre, formë jo natyrale e ligjërimeve. Vetëm pak janë në formën e folur ku përveç analizës gjuhësore, stilistikore dhe komunikative mund të bëhet dhe analiza fonetike, pjesë shumë e rëndësishme kjo për ligjërimin. Në regjistrimin [10] e ardhur deri në ditët e sotme të ligjërit të mbajtur me atdhetarët në Boston për përvjetorin e shoqatës Vatra në 1963, Noli zgjedh t'i drejtohet dëgjuesve me dy histori gazmore e plot humor, me ligjërim të stilit bisedor, ton të qetë dhe të qeshur, për të fituar vëmendjen e tyre. Ritmi i qetë dhe pauzat e gjata, që i lënë mjaftueshëm kohë publikut të qeshë dhe të shijojë humorin e hollë të Nolit, janë në funksion të përfshirjes së tij në ligjërim. Veçori e Nolit është se të gjitha teknikat e përdorura më lart nuk kanë thjesht qëllimin e tërheqjes së vëmendjes, por ato gjithashtu me shumë mjeshtëri përcjellin si pjesë të hyrjes edhe idenë kryesore të ligjërit dhe janë tërësisht në funksion të saj.

Psikologjia e dëgjuesit tregon se publiku është egoist. Që të ndjekë një fjalim ai duhet të kuptojë se tematika e prek atë, është çështje interesante për të dhe se ligjëruesi është i besueshëm dhe i përfshirë në tematikë.[11]

"... nuk është e mjaftueshme të vlerësojmë si të krijojmë një fjalim informues dhe bindës, por edhe që ligjëruesi të tregojë vetveten personazh të përfshirë... që dëgjuesit e tij të besojnë se ligjëruesi është i dedikuar disi kundrejt tyre; dhe kështu, edhe ata vetë, dëgjuesit, t'i dedikohen disi ligjëruetit." [12]

Në ligjërimet e Nolit vihet re një strategji e veçantë për të përmbushur këtë funksion të hyrjes; përdorimi

i përemrit të vetës së parë njëjës dhe shumës 'Unë'- 'Ne' dhe foljeve në vetën e parë njëjës dhe shumës.

"Ky mejtim plot dhembje na bie plot herë ndër mend, kur godit shpirti ynë të qëndronjë gjunjazi përpara kujtimit tënd të shenjtë, o mbreti ynë i dëgjuar, o trim mbi trimat, Gjergj Kastriot"

"...Dhe atje tej përgatitja lahutën që të tonisja për kujtimin tënd një këngë trimërore të padëgjuar dhe shtrëngoja kordat që të nxjerrin zënë e tyre më të lartë, ky mejtim më ra ndër mend dhe m'u pre fuqia, zëri më qëndroi në grykë si thëngjilli prej zjarri dhe lahuta më ra prej dorës. ..."

"Le t'i biem pas, le të fluturojmë në kohërat e lumtura që patën fatin e bardhë të kenë në gji të tyre një të këtillë trim."

"Pra, po ne, a na rrëfyn nënërat tona gjëkafshë të tillë? Jo, po ne na mirrin për dore dhe na shpinin në kishë ose në xhami të dëgjonim priftërinjtë dhe hoxhallarët dhe të mirrin uratën e tyre." Ndjeni këtu edhe ironinë e mprehtë Noline pasi Noli ishte vetë prift. Ironia dhe sarkazma, jo vetëm për elementin fetar, por edhe atë politik, qeverisës sidomos në nivelin ndërkombëtar është një nga tiparet dallues dhe të veçantë të ligjërimeve të Nolit që tërhiqte më së shumti vëmendjen e dëgjuesve të tij. Ai po ashtu tregon shumë histori dhe anekdota nga jeta e tij personale, siç është ajo me nënën e tij që mburrej për vetullat e Nolit, apo refleksime mbi çështje të rëndësishme për atdheun.

Identifikimi i funksioneve të pjesëve të ndryshme në ligjërimet ceremoniale është disi më i vështirë pasi ato dominohen nga Pathosi dhe qëllimi i tyre kryesor është të përcjellë një çështje të caktuar apo të trajtojë një temë përmes ngarkesës emocionale, e cila arrihet me përdorimin e shumtë të figurave stilistikore. Për rrjedhojë identifikimi i idesë kryesore si një fjali e mëvetshme dhe qartësisht e identifikueshme dëftore dhe e parashtrimit paraprak nëpërmjet lidhorëve[13], bëhet relativisht më sfidues në procesin e analizës pasi ato janë të trupëzuara në njësinë e madhe të hyrjes dhe vishen nga figurat letrare. Kjo gjë krijon thyerje në ligjësitë e të shprehurit të idesë kryesore si pjesë e hyrjes në ligjërimet në publik.[14]

Në ligjërimet e trashëguara në audio identifikimi i funksioneve të hyrjes, është më i thjeshtë pasi përveç strukturave gjuhësore në ndihmë vijnë edhe ato fonetike, ku përmes intonacionit dhe theksit të fjalisë dëgjuesi arrin të identifikojë lëvizjen nga një pjesë në një tjetër gjatë ligjërit. Si për shembull në ligjërimin e mbajtur në 1963, ku pas historisë gazmore me nënën e tij, Noli i jep kohë publikut ta shijojë dhe të qeshë, me një pauzë të mjaftueshme dhe më pas vijon me një parashtrim të qartë gjuhësor dhe intonativ duke siguruar kështu interaktivitet me dëgjuesit e tij.

"... Tashi mund të vimë në themën e ditës. Shumë nga shqipëtarët na qahen me këtë menyrë; ore ç'kini bërë që lëvdoheni aq shumë?! Edhe kur ta thonë në këtë mënyrë, sikur ta presin gjuhën..."[15]

Në këtë punim u pa shkurtimisht sesi Noli përdor funksionet e hyrjes në ligjërimet e tij, kryesisht në ato ceremoniale të periudhës 1906-1920. Ndër funksionet më kryesore të hyrjes sipas studiuesve,[16] janë ato të tërheqjes dhe zgjimit të interesit të publikut, krijimit të besueshmërisë, prezantimit të idesë kryesore dhe parashtrimit të pjesës në vijim të fjalimit. Pjesa më e madhe e ligjërimeve të mbërritura nga Noli deri në kohët e sotme është në dorëshkrime, formë jo natyrale e ligjërimit. Një pjesë e vogël ka ardhur në formën origjinale audio të vetë Nolit si ligjërues. Identifikimi dhe analiza e funksioneve të hyrjes në dorëshkrime është sfidues, por shumë shpërblyes, pasi për nga natyra fjalimet ceremoniale mbizotërohen nga gjendja e lartë emocionale. Për të ngritur lart shpirtin patriotik, Noli me mjeshtëri të lartë përdor një tekst të ngjeshur figurash stilistikore dhe letrare. Në këto ligjërime, tiparet funksionale të hyrjes njehtësohen me vetë tekstin dhe anën emocionale të tij. Në ligjërimet audio analiza fonetike e ligjërimit ofron disa veçori thelbësore që nuk i ka teksti i shkruar. Në ligjërimet audio mund të dallohen qartë pauzat e gjata, intonacioni rritës apo zbritës i fjalive, theksi mbi fjalë të caktuara, për të kuptuar më qartë lëvizjet nga një moment në një tjetër gjatë fjalimit si dhe për të kuptuar rëndësinë që Noli i jep çështjeve të caktuara.

Në përfundim mund të themi se Noli dhe thesari i tij i ligjërimeve janë një mundësi e shkëlqyer për të analizuar nga ana teorike dhe praktike funksione të hyrjes dhe të ligjërimeve në përgjithësi. Në veprën e tij unike dallohen elementë të trashëguar nga retorika e lashtësisë, por edhe kombinime origjinale të tij me vlera studimore.

Bibliografi e konsultuar

1. Jorgaqi N(2002) *Ligjërime* Dudaj
2. Aristotle (2010) *On Rhetoric* RenadaClassic. Com.,USA
3. Lucas, L. S. (2009) *The Art of Public Speaking*, 10 th ed. The McGraw-Hill Companies
4. De institutio oratoria (2.17.6) The Institutio Oratoria of Quintilian. With an English translation bz H.E.Butler, London;William Heinemann New York:GP.Putnam's sons
5. Sproule, J. M., Cope, E. M., & Sproule, J. M. (2012). Inventing Public Speaking: Rhetoric and the Speech Book, 1730-1930. *Rhetoric and Public Affairs*, 15(4), 563-608. <https://doi.org/41940622>
6. Jorgaqi N(2002) *Ligjërime* Dudaj
7. Po aty.,
8. Po aty.,
9. Po aty.,
10. <https://www.youtube.com/watch?v=1XHKrwAjHrs>
11. Lucas, L. S. (2009) *The Art of Public Speaking*, 10 th ed. The McGraw-Hill Companies
12. Aristotle (1982). *The art of rhetoric*. (J.H. Freese, Trans.). Cambridge, MA: Harvard University Press
13. Lucas, L. S. (2009) *The Art of Public Speaking*, 10 th ed. The McGraw-Hill Companies
14. Pearson, J.C., Nelson, E.P., Titsworth, S., Harter, L., Human communication 4 th ed. McGraw-Hill Companies
15. <https://www.youtube.com/watch?v=1XHKrwAjHrs>
16. Lucas, L. S. (2009) *The Art of Public Speaking*, 10 th ed. The McGraw-Hill Companies

SHKENCAT INXHINIERIKE DHE MATEMATIKORE

Trajectory prediction using Machine Learning

MSc. Anila Duka

anila.duka@univlora.edu.al

Dr. Ndricim Sadikaj

ndricim.sadikaj@univlora.edu.al

University of Vlora

Vlora, Albania

Abstrakt

Machine Learning është shumë e përdorur në parashikimin e trajektoreve, si të mjeteve detare, ajrore e tokësore. Ajo përdor metoda të të dhënave për të parashikuar sa më mire lëvizjet. Këtu do të shohim disa nga metodat më të përdorshme për parashikimin e trajektoreve, si dhe drejtimet e kërkimit për të ardhmen.

Fjalë kyçe: *Machine Learning, trajectory prediction, artificial intelligence, Deep Learning*

Abstract

Machine Learning is very used in the prediction of trajectories of sea vessels, air vessels and earth vessels. It uses the data methods to do the best prediction. Here we will see some of the most popular methods involved in trajectory prediction, also the future research direction.

Key words: *Machine Learning, parashikim trajektoreje, intelijenca artificiale, Deep Learning*

Hyrje

Parashikimi i trajektoreve ka të bëjë me përcaktimin e pozicionit të ri të mjetit duke u bazuar në të dhënat e kaluara të mjetit dhe të mjeteve të tjera pranë tij. Kjo ka për qëllim evitimin e përplasjeve, rritjen e sigurisë dhe marrjen e vendimeve të duhura. Me kalimin e kohës metodat kanë evoluar shumë në këtë drejtim. Disa nga metodat më popullore për parashikimin e trajektores janë: Metodat tradicionale të Machine Learning të bazuara në

After I reached a theoretical understanding of the topic, I went into practice. The study was conducted between observing the lesson clock during which notes were kept. Talk to 5 different teachers in the manner of a focus group and interview. I focused on keeping notes that related to how the student was evaluated during these hours I attended. By observing the supplementation of the reporting materials of these assessments that are: the evidence of the continuous assessment and the register. As well

as most importantly, I observed with the eye of a future teacher, the effectiveness of this method, recalling the previous method, which had accompanied me during high school.

The study lasted 3 weeks, which was accompanied by the attendance of several classes of social subjects: language and literature, citizenry and history. The classes lasted 45 minutes during which teachers combined the explanation of the new lesson with the assessment of the student's knowledge. The conversation with the 5 teachers occurred along 3 lines during the big 15 minute break. They spoke about the new assessment policy and their role in assessing the pupil. They also emphasized the importance of the student in this new policy, and compared, reminding me, with the method of evaluation 3 years ago.

II. Comparative aspects – Assessment in the curriculum before and after 2015.

As a future teacher I must always be in the process of educating the education policies that affect not only the teacher but also the student. On the other hand as an alumni and I am interested to understand whether these educational policies are just for the eyes or are really affecting the student's life for the better.

That's exactly what the education policies I took into this case study were for this.

What are these educational policies?

How are they affecting the student's life? What about the teacher's life?

Are they successful? Are they worth it?

My study focused mostly on the way students are evaluated, as this part leaves the most impact on the student and is the most important part of making the teacher understand how he is doing as a teacher. The main differences between systems before and after 2015 I tried to summarize them by a table by highlighting the most important ones:²

BEFORE 2015	AFTER 2015
4 years span	3 years stretch

² G.Dibra, E.Halluni "Methodology and Teaching"
Tirana 2013

Evaluation divided into two semesters	3 semester
Evaluation with average annual grade	Rating by grade (quarterly: ned, test, portfolio)
Goals according to Blum theory	Competence
Scientific-social division	Class: a) Core b) with choices
Selected 11 times (in 11th grade)	Three times (at the beginning of each year)
Mathematics 5 times a week	Mathematics 3 times a week and 4 times (12th grade)
Traditional subjects (same science-society)	New textbooks, unqualified teachers
The Rigid Plan	Teacher Freedom (10% change of subjects)
Extracting notes in a traditional way	Extracting the fatty note
Student overload within a profile (natural profile such as mathematics, physics, chemistry, biology etc.)	The best specialization of students Fore: chemistry, biology
Less time in profiling	More time for common issues
The teacher in the center, where the teacher explains for a long time	The student in the center, who emerges in the main role, interacts, cooperates and brings information
Based on academic subjects and guided by them	Based on learning fields and cross-curricular methodology
Focus on knowledge and school needs	Focuses on competence, enabling lifelong learning
Supports mechanical learning, enabling students less for practical life	Encourages logical learning for students to develop intelligence and develop their knowledge of life
Overstuffed texts	Less busy texts with more hours of practice
Lack of logical connection between programs	Coordination between programs
Based on academic orientation	It is based on orientation to the real needs of students
Solid in structure and time distribution	Flexible in structure and time distribution
Focus on general assessments	Focus on evaluating content format and progress

Notes on the registering	Only absence in the register, grades in the teacher's notebook
--------------------------	--

But how has the change been before? What was the policy of these changes? These questions accompanied me during the assessment research not only before 2015, but beyond. How was the 2015 assessment and techniques? **Thus, presented as a necessity and success, in 2013 the Ministry of Education took a new approach to the curriculum based on competences, borrowed from Kosovo.**

But what has happened? How is this model applied in Albania? Was there a preliminary assessment of the curriculum? Were the teachers trained? Were the results piloted and evaluated? Is the budget for education and the budget for schools to be implemented?

Many other fellow questions followed my questions about the curriculum in general and the assessment in particular. The changes happened very quickly and very radically.

CONCLUSIONS

In general, new innovations always scare the individual. When we are in a new situation, we ask ourselves if:

Will I be able to apply this innovation? Can I understand it enough and apply it?

What is true change takes time to happen and we cannot wait for things to change overnight. In this study, some truths were revealed that in comparison, which I wanted to make initially, I could find more similarity than differences. When I was a high school student I remembered the active teaching that teachers gave us, the table for voice assessment and tests for each chapter closing. Today, as I observe the teaching class of literature, I look again at the active teaching of the teacher, the rise in the student's chart (now for continuous evaluation) and the anxiety of the student next door for the next hour's test in biology.³

So where's the difference?

The assessment today is conducted according to: continuous assessment containing 40% of the final grade, assessment with test/summary task with 40% of weight and assessment of the student's subject portfolio with 20% of the weight of the final grade. Against the three years' evaluation that included: oral assessment containing 40% of the weight of the final grade, assessment with summary test/task containing 50% of the weight and evaluation of projects with 10% of the weight of the final grade, which came out of the arithmetic calculation of the arithmetic average of each. The first change in sight is constant evaluation. Continuous evaluation is based on the teacher's observations and judgments on oral or written responses, quizzes, teamwork, teacher discussions with students, student self-esteem, student-by-pupil assessment, participation in activities and classroom debates, assessment of home or class assignments over a period of time.

It is done by the teacher with marks or symbols which are accompanied by comments in the personal register or evidence. Here the student is evaluated for various written oral responses, participation in discussions, etc.

This assessment is also accompanied by the relevant evidence where the teacher keeps notes on the preparation of the student, evaluates his knowledge based on competences and comments on any assessment of the student. While compared to the assessment of three years ago, continuous boiling did not exist in an official sense. The teacher raised the student in the lesson, asked and evaluated with a note that was thrown into the register, without comment under the name of a voice note.

The truth is that the teacher is a teacher who is a teacher. Concrete case: me, 11th grade, biology class, 5 hours of lesson. The teacher had asked me constantly during these 5 hours from a question about different teaching topics we had received, at the end of the 5th hour I assess my answers with one grade. The note was placed in the register, under the name of the voice note. Today the teacher follows the same procedure, but the assessment is not placed on the register, in which only dates, teaching topics and absences

³ The Magazine Teacher "Albanian Excellence"
Tirana 2017

are met, but in the evidence of continuous evaluation where it is accompanied by a commentary. In the introduced innovations we also distinguish the protofoil, a new concept at first glance.

Portfolio evaluation controls individual work or teamwork in a field or several fields, where the student displays his individuality with creativity, reflections, etc. This assessment is reflected in the file with: written tasks, projects, research, thematic work etc. The portfolio evaluation can also be planned as a special hour at the end of each 3 month period for each subject.

While the assessment of 3 years ago only had projects that included research, thematic work and presentations of students. When I first interviewed the deputy headmaster of the school, she addressed me, "The lesson clock continues to be as it was in your time. The teacher asks the students, explain the lesson, set the grades. The only difference is where you put those notes."

As I attended classes, I realized that not much has really changed since I was sitting in those banks. Not because the change wasn't happening, but because it wasn't practical. The lesson class makes the teacher with his teaching methodology. It motivates the student, controls his achievements, evaluates him so that the student understands where he is, and guides the student to the best.

During the focus group with the 5 school teachers I managed to draw some views that they had on the new assessment method: The main purpose of the assessment is to support learning and progress in students.

This goal is accomplished by combination:

- Assessment of learning
- Reporting student achievement and progress
- Reporting of learning achievements is done by the teacher once every three months and is provided in writing to the parent.

Reporting student achievement and progression has two main goals:

- ❖ First provides comprehensive and consistent information about students' learning and progress, serving as the basis

for comparing achievement with expected learning outcomes

- ❖ Second, creates a platform that serves teachers and parents to support students in the next steps of learning, as well as to develop students themselves in this process. In theory reform requires a teacher who is always in the advancing for every student's comment. A teacher who constantly uses teamwork and quiz method for assessing the pupil.

In problematic classes, the teacher reduces himself only to the realization of quiz and the raising of the student in the lesson. In large classes, the teamwork cannot be developed efficiently because it takes a lot of time and in some subjects it is difficult to compress it in 45 minutes.

Ideally, this reform for the students is very efficient because the way of getting the finishing grade in a regression way is very favorable. The main problem in this circle did not emerge as the teacher as the implementer of this reform but the drafting of the reform, not considering the school environment and the teacher as an individual.

REFERENCE

1. G.Dibra, E.Halluni "Methodology and Teaching" Tirana 2013
2. The Magazine Teacher "Albanian Excellence" Tirana 2017
3. "Guide to the development of the new curriculum" Tirana 2017

Strategjite dhe metodat e te mesuarit te gjeografise ne arsimin 9-vjecar

MSc. Anila LULA

Faculty of Human Sciences
University "Ismail Qemali", Vlorë
lula.anila@gmail.com

Abstrakt

Abstrakt: Në kuadër të teorisë së mësimdhënies apo didaktikës së gjeografisë përfshihen edhe aspektet metodologjike menaxhuese e motivuese për zhvillimin e një ore mësimore. Kjo ka qenë arsyeja e zgjedhjes së trajtimit të kësaj teme. Ky trajtim teorik përfshin, strategjitë, metodat dhe detyrat e metodikës së gjeografisë në ciklin 9-vjeçar. Një studim i tillë ka të bëjë me tipet e orëve të mësimit në lëndën e gjeografisë si dhe kriteret për zgjedhjen e tipit të mësimit, strategjitë dhe metodat e të mesuarit, formimin e koncepteve në gjeografi, teknikat e hartimit dhe drejtimit të pyetjeve etj. Strategjitë, teknikat dhe metodat e mësimit të gjeografisë synojnë të realizojnë dy anët kryesore të procesit të të mesuarit:

a) mësimdhënien

b) dhe të nxënës

Nëpërmjet këtij studimi synohet të tregohet puna e mësuesit, menaxhimi, metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies që mësuesi vë në përdorim në klasë, për të motivuar nxënësit dhe për të patur një mësimnxënie efektive.

Fjalë kyce: metodologji, mësimdhënie, menaxhim, motivim, strategji

Abstract

In the framework of the theory of teaching or didactics of geography, the managerial and motivational methodological aspects for the conduction of a teaching class are also included. This theoretical treatment includes the strategies, methods and tasks of the methodology of geography in the 9-year cycle. Such a study has to do with the types of lessons in the subject of geography as well as the criteria for choosing the type of lesson, learning strategies and methods, the formation of concepts in geography, the techniques of designing and directing questions,

etc. Geography teaching strategies, techniques and methods aim to fulfil two main aspects of the learning process:

a) Teaching

b) Learning

This study will demonstrate the teacher's work, management, methods, techniques, teaching strategies that the teacher uses in the classroom in order to motivate the students and realise effective learning.

Key words: methodology, teaching, management, motivation, strategy

HYRJE

Mësuesi ka qenë dhe mbetet figura qendrore në shkollë. Për mësuesin ideal është folur që nga koha e Sokratit, Aristotelit, Pestalocit etj. Por çfarë është mësuesi ideal sipas këtyre autorëve? Ai mësues që konsiderohet si mësues ideal është vëzhgues, eksplorues, njohës i shpirtit, lexues i mirë, tregimtar i hollë, një njeri me horizont të gjerë, është gjithmonë një hap para të tjerëve çka është e nevojshme të përmbushë imazhin e çdo mësuesi, mbi të gjitha të jetë humane.

Përcaktimi i marrdhënieve mësues-nxënës është një çështje themelore në të cilën ndërthuren koncepte, norma e parime kryesore të pedagogjisë, psikologjisë dhe didaktikës. Mësuesi dhe nxënësi janë dy bashkëpunorë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin gjatë gjithë viteve të shkollimit, ku mësuesi është drejtues dhe nxënësi duke punuar nën drejtimin e mësuesit do të përvetësojë njohuri, shkathtësi dhe shprehje që do të përcaktojnë programet mësimore, përvetësimin që varet nga puna e mësuesit dhe përkushtimi i nxënësit. Përmes punës së tij mësuesi duke krijuar një partneritet të suksesshëm ndërmjet shkollës, nxënësit dhe

familjes bën të mundur përgatitjen e nxënësve për sukses gjatë procesit mësimor.

Të japësh mësimë kërkon mjeshtëri menxhuese dhe organizuese. Menaxhimi i suksesshëm i mësimi kërkon prej mësuesit të jetë, vazhdimisht i vëmendshëm dhe në veprim, për t'u siguruar se nxënësit mësojnë normalisht. Problemi kryesor me të cilin ndeshen mësuesit është të mbajnë të përfshirë nxënësit gjatë gjithë mësimi, për të realizuar në mënyrë të suksesshme objektivat e parashikuara. Në çdo kohë mësuesi ka kërkesa të ndryshme e bashkëveprime të shumta, që e shtojnë perpara një veprim. Situatat mund të shfaqen nga më të ndryshmet. Për shembull; mësuesi është duke i dhënë një detyrë një nxënësi, por në të njëjtën kohë, një nxënës tjetër kërkon një mjet ndihmës, gjithashtu vë re se një nxënës i tretë është duke vështruar nga dritarja dhe në të njëjtën kohë i tërheq vëmendjen një nxënës tjetër që kërkon t'i kontrolloj detyrën.

• Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij punimi është identifikimi i punës së mësuesve në shkollat e ciklit 9-vjeçar, cilat janë metodat, strategjitë, apo mënyrat që ato përdorin për të mbajtur sa më aktiv procesin e të mësuarit, motivuarit të nxënësve në klasë, në orën e gjeografisë. Problematika e gjerë e ka zanafillën në ndërveprimin mësues-nxënës, lidhjen e ndërsjelltë shkollë-familje, detyrimet e përgjegjësitë që ka secila palë në skemën e edukimit dhe arsimimit të fëmijës. Së fundi dhënia e këshillave për mësuesit në mënyrë që të jenë sa më efektiv dhe motivues në punën e tyre për të çuar nxënësit drejt arsimdashjes.

• Rëndësia e hulumtimit

Rëndësia e hulumtimit ka të bëjë me faktin se nëpërmjet intervistave të bëra nëpër shkollat e ciklit 9-vjeçar, me nxënës dhe mësues arrijmë të marim informacion konkret, dhe real në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien në lëndën e gjeografisë. Si ndjehen në ambientin shkollor, si është klima që mbizotëron brenda klasës së tyre. Sa të mbështetur e ndiejnë veten nga mësuesi etj.

Strategjitë dhe metodat e të mësuarit të gjeografisë në ciklin 9-vjeçar

Një orë mësimi realizohet me pafundësi mënyrash. Pavarësisht nga modeli që zgjidhni, mënyrën se si e trajtoni planifikimin e orës së mësimi, ka disa parime të përgjithshme didaktike që zbatohen në planifikim, si:

- Objektivat t'i shpërbejnë drejtpërdrejt kapitullit dhe lëndës në tërësi.
- Objektivat të jenë të qartë për nxënësit.

- Çdo objektivi të jetë edhe një përfundim i saktë që del nga mësimi.

- Mësimi të jetë i realizueshëm. Nuk ka kuptim që t'u mësoni nxënësve diçka që është shumë e vështirë e që nuk mund të realizohet. Përpikuni të mos jepni shumë. Është më mirë pak dhe saktë.

- Veprimtaritë e mësimdhënies të jenë në përputhje me objektivat që keni caktuar.

- Të dini të realizoni veprimtaritë që keni zgjedhur, si dhe të siguronit metodat, teknikat, mjetet

dhe burimet e informacionit që lidhen me to.

- Të caktoni kohën e duhur për çdo veprimtari.

Në shkollë, të mësuarit e sotëm, në qendër ka nxënësin dhe në këtë proces mësuesi:

- Udhëheq të mësuarit dhe u ofron nxënësve rrugët për kërkimin e pavarur të informacionit.

- Në vend të zgjidhjeve të gatshme u krijon nxënësve mundësinë për të gjetur shumëllojshmëri zgjidhjesh për të njëjtin problem.

Mësuesi para se të ndërtojë një strategji duhet të dijë mirë parametrat e fillimit të këtij objektivi dhe të përcaktojë drejt indikatorët e pritshëm në përfundim të një ore mësimi, grup temash, kapitulli, viti, lënde etj.

Njohuritë, shprehjet, aftësitë, qëndrimet, vlerat janë parametrat e objektivit **NXËNËS** që duhen njohur. Paracaktimin se sa do ta ngrejë nivelin e tyre në një njësi mësimore, mësuesi e bën me anën e objektiveve në kuadrin e objektiveve të përgjithshëm.

- Gjatë zhvillimit të mësimi ka rëndësi ecuria mësimore, e cila varet nga strategjia që do të ndiqni, ndërveprimi i elementëve strategjikë që keni zgjedhur për të qenë i suksesshëm në hyrje, zhvillim dhe në përfundim të mësimi.

- Duke zbatuar parimet e mësipërme, mund të ndërtoni mësimë model të ndryshme.¹

- Nuk ka rëndësi modeli. Ju mund të përdorni atë që është më i përshtatshëm për ju dhe që nga përvoja juaj, lënda, veçoritë e temës, kushtet, burimet e informacionit etj.

Pra, strategjia që përdor një mësues është e ndryshme nga një mësues tjetër. Kësisoj lind nevoja të kemi një kuptim të përgjithshëm për strategjinë e mësimdhënies, paçka se çdo mësues ka strategjinë e vet.

... Nëse i përcakton drejt këto parime dhe i koordinon mirë në situata konkrete pedagogjike, atëherë rezultati i pritshëm do të jetë i suksesshëm.

... Por a ndodh gjithmonë kështu?

Pse ndodh që dështojmë, kur jemi të bindur se elementët strategjikë që kemi zgjedhur kanë qenë të suksesshëm për një koleg, apo për një tjetër klasë, ku ju keni zhvilluar atë mësim?

Të gjithë e dimë se si reflektojmë ndaj punës sonë dhe të kolegëve, si vjelim dhe mbrojmë opinione, marrim dhe japim eksperiencë dhe përsëri çdo orë mësimi nuk i ngjan tjetrës. Dhe e gjithë kjo ndoshta ngaqë mësimdhënia është aplikim i njo profesioni krijues në kushte të caktuara dhe në rrethana që nuk mund të parashikohen.

Ç'është atëherë një strategji e mësimdhënies?

Së paku mund ta përkufizojmë kështu:

"Një tërësi elementesh që bashkëveprojnë e që koordinohen me njëri-tjetrin për të arritur një objektiv të caktuar, pra një nivel më të lartë."

"Njohuri - Aftësi - Shprehje - Qëndrime - Vlera".

Për një temë të caktuar, brenda një njësie kohore të caktuar."

Kësisoj, konceptimi teorik për strategjinë dhe reflektimi ndaj mësimdhënies (individual i përgjithshëm) e ndihmon mësuesin që të kërkojë zgjidhje për të përmirësuar praktikën e tij të mësimdhënies.

2. Kërkohet përcaktimi i saktë nga ana e mësuesit i detyrave mësimorë-edukative të orës së mësimi. Për përcaktimin e këtyre detyrave mësuesi duhet të bazohet në disa kritere:

A. Të përcaktohen objektivat mësimore specifike

B. Të përcaktohen detyrat edukative

C. Të përcaktohen shkathësitë dhe shprehitë me të cialt do të punohet gjatë orës së mësimi.

3. Kërkohet aftësimi i nxënësve për punë të pavarur dhe pjesëmarrja e tyre aktive në orën e

mësimi. Për të arritur një gjë të tillë duhet të ndiqet një ecuri e caktuar metodike, që përfshin këto detyra:

A. Të zgjidhet drejt teksti alternativ i punës së pavarur, i cili edhe pa shpjegimin e mësuesit, të jetë i kuptueshëm për nxënësit.

B. Të formulohen qartë detyrat që do të realizojë nxënësi gjatë punës së pavarur.

C. Të bëhet diferencimi i detyrave të pavarura, sipas nivelit të formimit dhe aftësive të nxënësve.

D. Të vëzhgojë e të ndjekë ecurinë e punës që bëjnë vetë nxënësit.

E. Të konsultojë herë pas here nxënësit gjatë punës dhe të ndihmojë ata që janë pak më të aftë.

F. Të organizojë shqyrtimin kolektiv të detyrës.

G. Të kontrollojë dhe vlerësojë me notë punën e pavarur të kryer nga nxënës të veçantë.

4. Kërkohet që të zgjidhet drejt struktura e orës së mësimi, tipi i mësimi, materialet ndihmëse etj.

5. Duhet që mësuesi të punojë për nxitjen e interesit dhe motivimin e nxënësve për përmbytjen e temës e të krijojë klimë emocionale pedagogjike gjatë orës së mësimi.


Kjo relaizohet përmes disa faktorëve:

A. Fjalës së mësuesit.

B. Tekstit dhe materialit plotësues.

C. Kulturës së të folurit etj. ²

Roli i mësuesit në strategjinë e sotme të mësimdhënies



Lloje të ndryshme metodash dhe strategjish

Strategjia është proces, është një tërësi elementësh, që duhen kordinuar e që përcaktojnë rrugën për të shkuar te nxënësi. Strategjitë e të mësuarit përfshijnë në vetvete tërësinë e metodave, teknikave e veprimtarive, që do të përdoren për të arritur qëllime dhe objektivat, ato kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit dhe aktivizimit të nxënësve, të përpunimit të informacionit, për të ndërtuar dhënie-marrje materiali mësimor në mënyrë të kuptueshme e të

llogjikshme. Strategjitë e të mësuarit çojnë në kuptimin, përvetësimin, analizimin, argumentimin e dukurive natyrore e shoqërore duke formuar koncepte të sakta gjeografike.

Teknikat përvijojnë mënyrën e komunikimit me nxënësit, formulimin e fjalive, termave, demonstrimin, intonacionin e gjestikulacionet e mësuesit. Teknikat e mësimdhënies mund të caktojnë edhe kritere specifike të punës konkrete në klasë, p.sh: në ndërtimin e pyetjeve, hartimin e zhvillimin e testeve në gjeografi si dhe format e kontrollit dhe të vlerësimit në tërësi.

Metodat ndërtojnë rrugët, format, ecuritë, e procedimet didaktike, që përdoren gjatë orës së mësimi apo jashtë saj nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit për transmetimin e njohurive, dijeve e shprehive për formimin e vlerave njohëse, shkencore tek nxënësit.

Strategjitë, teknikat dhe metodat e mësimi të gjeografisë synojnë të realizojnë dy anët kryesore të procesit të të mësuarit:

a) mësimdhënien

b) dhe të nxënit³

1. BRAINSTORMING

Kjo fjalë në anglisht – shqip do të thotë “stuhi mendimesh” ose “arsyetim stuhi”

Qëllimi: Të përvetësohen parimet për organizimin e brainstorming-ut dhe të zbatohet në situata konkrete në klasë, duke njohur përparësitë dhe kufizimet e tij.

Brainstorming-u është një veprimtari që shërben si fillim i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera. Qëllimi i përdorimit të brainstorming-ut është **të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë.**

Ka shumë rëndësi:

• **Koha e shkurtër** e zhvillimit të tij, 5-10 minuta.

• **Sasia e zgjidhjeve.**

Këto dy elemente i japin edhe kuptimin emërtimit brainstorming. Detyra e mësuesit është të inkurajojë mendimin e lirë dhe krijues të nxënësve.

Brainstorming-u ka për qëllim që:

- Asnjë prej zgjidhjeve ose ideve të mos kritikohet. Të gjitha janë të pranueshme.
- Të nxiten nxënësit të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.
- Të aktivizohen edhe nxënës të drojtur, duke shfaqur edhe ata mendimet e tyre.
- Të nxjerrë nga gjendja e plogështisë të menduarit e nxënësve, si kusht i nevojshëm për veprimtari të tjera. Pra, shërben si një nxehje e trurit.

Brainstorming-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet e të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. Mësuesi zgjedh një temë, ua drejton nxënësve që ata të gjejnë maksimumin e ideve të reja dhe këto i shënon në dërrasën e zezë. Nëse idetë shterojnë, atëherë mësuesi i lë nxënësit në heshtje rreth dy minuta, derisa të krijojnë ide të reja, dhe fillon sërish

brainstorming. Në këtë mënyrë identifikohen të gjitha zgjidhjet e mundshme.⁴

Përdorimi i brainstorming-ut sjell një sërë përfitimesh:

- Zhvillon aftësitë pjesëmarrëse të nxënësve.
- Rrit pavarësinë e gjykimit të tyre.
- Inkurajon nxënësit të japin ide.
- Jepen zgjidhje të parashikuara.
- Zbulon preferencat e nxënësve.
- Sugjeron arsye për të vazhduar diskutimin në forma të tjera.
- Kërkon burime të pakta e të thjeshta.

Mënyra e zbatimit

Mësuesi zgjedh mjetin, formulon pyetje me shumë përgjigje të mundshme dhe ua drejton nxënësve për të vjelë maksimumin e ideve e këto i shënon në një organizues grafik të vizatuar në dërrasë të zezë. Në gjeografi ka shumë mënyra për të formuluar pyetje të ndryshme për një brainstorming.

1. Përdorimi i një pyetjeje që kërkon nga nxënësit të bëjnë një listë të ideve dhe fakteve që dinë për një dukuri gjeografike, natyrore apo shoqërore-ekonomike, si p.sh. për një objekt të veçantë e konkret gjeografik, për një komponent natyror, për një aspekt të caktuar të jetës sociale, ekonomike e kulturore, që studion gjeografia etj.

2. Vendosja para nxënësve e një harte apo mjeti tjetër grafik, përmbajtja e të cilëve është e lidhur me temën e mësimi. Nxënësve u kërkohet të shohin me kujdes hartën ose mjetin tjetër grafik dhe të paraqesin në listë idesh dhe faktesh, duke u bazuar në përmbajtjen e tyre.

3. Vënia në qendër të vëmendjes e një fjale kyç, që përgjithëson një çështje apo një temë dhe u kërkohet nxënësve të shprehin sa më shumë mendime të përmbledhura me një apo dy fjalë, të cilat zbulojnë thelbin ose karakteristikat e llojit të saj etj.

4. Pasi nxënësit të kenë lexuar tekstin ose copëza të tij, që mësuesi ua ka dhënë t'i lexojnë paraprakisht, brainstorming-u në këtë rast përmbledh idetë kryesore dhe faktet për çka dinë dhe lexuan nxënësit, por sidomos ide që atyre u lindin për shkak të nxitjes që u bëri materiali i lexuar.

5. Dalja në terren e nxënësve është rasti më i mirë për pjesëmarrjen masive të nxënësve në brainstorming. Përpara një mjedisi konkret, që karakterizohet nga një kompleksitet elementesh gjeografike, nxënësve u kërkohet që të listojnë të gjitha ndjenjat, idetë, mendimet, faktet, objektet dhe dukuritë gjeografike që ata vërojnë në horizont nga një kuotë dominuese.⁵

Pas një brainstorming-u të tillë impresionues, ku nxënësit reflektojnë ndaj njohurive të marra në klasë, mësuesi krijon një brainstorming, por tani duke kërkuar prej nxënësve të përshkruajnë kryesisht ato ide apo konstatime të vrojtues, që kanë të bëjnë vetëm me një objekt apo dukuri të caktuar, që lidhet me temën dhe qëllimin e ekskursionit mësimor.⁶

Një tjetër situatë brainstorming-u mund të synojë të sqarojë dhe të kompaktësojë disa njohuri të mëparshme ose qëndrime individuale të nxënësve lidhur me marrëdhëniet e njeriut me natyrën që e rrethon.

Brainstorming-u presupozon përdorimin e të gjitha formave dhe mjeteve didaktike, që zotëron lënda e gjeografisë.

Nxënësit përfshihen në brainstorming dhe reflektojnë në mënyrë aktive, kur mësuesi u drejtohet me pyetje, si p.sh.:

- Çfarë mendoni ju për...
- Çfarë shikoni tek ...
- Çfarë mendoni se ka ndodhur në ...
- Ç'ju bën të mendoni kështu për ...
- Për çfarë flet pjesa që lexuat për ...
- Ç'do të ndodhë sikur ...
- Ç'ndryshime shikoni midis ...
- Përse ju shërben ...
- Ç'gjëra interesante ka ...

Brainstorming-u nuk mund të zhvillohet:

- Kur nxënësit nuk kanë njohuri për çështjen që shtrohet.
- Kur çështja (pyetja) kyç që ju do të përdorni për brainstorming nuk është formuluar mirë (ka mangësi).
- Kur çështja (pyetja) kyç që ju do të përdorni, ka pak alternativa (ide) për zgjidhjen e problemit.⁷

2. INSERT

Insert është një metodë që i lejon nxënësit të kontrollojnë gjallërisht shkallën e tyre të të kuptuarit gjatë leximit. Nëpërmjet kësaj teknike sigurohet pjesëmarrja e qendrueshme e nxënësve në mësim.

Gjatë leximit nxënësit udhëzohen që të vendosin shenjat e mëposhtme:⁷

"√" Vendosni shenjën "√" (kontrollo), nëse diçka që lexoni pohon atë që dini ose mendoni se dini.

"+" Vendosni një "+" (plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni është i ri për ju.

"-" Vendosni një "-" (minus), nëse një pjesë ose disa prej informacionit që lexoni kundërshton ose është e ndryshme nga ajo që dini ose mendoni se dini.

"?" Vendosni një "?" (pikëpyetje), nëse ka informacion që është i paqartë për ju ose ka diçka

që ju duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni.

Informacioni i shenjëzuar, hidhet pastaj në tabelën **INSERT** sipas shenjave përkatëse.

"√"	"+"	"-"

Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit. Zbatimi i saj zgjat rreth 20-25 minuta.

Një formë e ngjashme e teknikës **INSERT** është teknika "**Di/ Dua të di/ Mësoj**", skema e të cilës është paraqitur më poshtë.

Di	Dua të di	Mësoj

Në kolonën e parë, "Di", nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi u duket si i njohur.

Në kolonën e dytë, "Dua të di", do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër.

Në kolonën e tretë, "Mësoj", nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti.

Ka më tepër efektivitet kur përdoret me nxënësit e klasës V, VI.⁸

3. HARTA E TË PYETURIT

- Teknika më bashkëkohore e të pyeturit në mësimin e gjeografisë është harta e të pyeturit. Ajo është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimin, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit.

Përdormi i kësaj teknike ka disa përparësi:

- Hap rrugën për diskutim.
- Ndhmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të menduarit.
- Tërheq nxënësit në punët e pavaruara.
- Rrit rolin e nxënësve në mësim.
- Nxit të menduarit logjik.
- Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.
- Harta e të pyeturit mund të përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit.
- Një hartë e të pyeturit mund të përdoret për të menduar rreth çdo lloj çështjeje ose teme. Ajo mund të përdoret, gjithashtu, gjatë një mësimi për të gjallëruar diskutimin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të përmbledhur informacionin e trajtuar.

Si të krijojmë një hartë të pyeturi

Për të përpiluar një hartë të pyeturi, mund të ndiqet kjo rregullsi:


-Shkruhet tema e mësimin që do të shpjegohet në qendër të tabelës.

Pas kësaj vizatohet harta e të pyeturit, në të cilën pas pyetjeve kyç, gjenden të lidhura edhe

pyetje të tjera që zgjerojnë hartën. Në këto nënpyetje mësuesi aktivizon nxënësit në një nivel më të ulët dhe më pas e gjithë klasa futet në punë.

Shembull 1:

- U kërkohet nxënësve të punojnë në dyshe dhe të shkruajnë në fletore përgjigjet e pyetjeve përkatëse.
- Ndihmohen nxënësit që t'i afrohen përgjigjeve që pret mësuesi.⁹



4. KLLASTERI

Kllasteri, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet "harta e mendimeve", është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizmin e kllasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t'u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).

- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.

- Kur idetë vijnë në mend të kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.

- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.


Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ai mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar; kllasteri paraqet një rrugë për të ndërtuar lidhje apo grafikë të rinj që paraqesin arsyetimin e ri.

Shembulli i mëposhtëm ilustron konceptin bazë të "**KLLASTERIT**", që fillon me një ide (koncept ose ngjarje) qendrore, në rastin tonë me klimën dhe që shtohet me elemente të tjera.

Një progresion i ideve, koncepteve, ngjerjeve të rreshtuara bëhet bazë për zgjerimin e të kuptuarit në nivelet më të larta dhe krijohet një "**HARTË E MENDIMEVE**".

Pyetjet ose thëniet shitesë mund të përdoren për të zhvillura interpretimet, për të udhëhequr diskutimet në klasë etj. "Kllasteri" gjithashtu

shërben për t'i mësuar nxënësve aftësitë bazë organizative.¹⁰



4. TABELA E KONCEPTEVE

Është një teknikë racionale për të organizuar informacionin gjeografik. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndhmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizimin e skemave të qarta, që sigurojnë qendrueshmërinë e dijeve.

Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit.

Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet e dukuritë, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasim.

Shembulli 1:

Shkruaj në tabelën e mëposhtme të koncepteve veçoritë dalluese të Amerikës Anglosaksone dhe Amerikës Latine dhe krahasojo ato.

<i>Rajonet</i>	<i>Veçoritë e natyrës</i>	<i>Popullsia</i>	<i>Ekonomia</i>
Amerika Anglosaksone			
Amerika Latine			

Shembull 2: Përshkruaj në kutizat bosh të tabelës së mëposhtme të koncepteve tiparet dalluese të klimës mesdhetare:¹¹




5. DIAGRAMI I "VENIT"

- Diagrami i Venit është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve, dukurive natyrore e shoqërore, peizazheve, rajoneve, shteteve, kontinenteve etj.
- Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve.

- Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimi, si dhe mbajnë qendrimë personale lidhur me to.
- Veprimtaria zgjat 10'-20', por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.¹²

Shembull :

Përcakto në Diagramin e Venit veçoritë e përbashkëta dhe tiparet dalluese mes Japonisë dhe Mbretërisë së Bashkuar



Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
1. _____ 2. _____ 3. _____ 4. _____ 5. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____ 4. _____ 5. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____ 4. _____ 5. _____

6. PESËVARGËSHI

Pesëvargëshi është një teknikë, e cila kërkon sintetizimin e burimeve të informacionit dhe një shprehje të saktë, që përshkruan apo reflekton idenë kryesore të një teme të caktuar.

Pesëvargëshi është një vjershë me pesë rreshta. Pesëvargëshi ka një strukturë të caktuar:¹³

• **Rreshti i parë** është përshkrimi me një fjalë i temës (*zakonisht emër*)

• **Rreshti i dytë** është përshkrimi në dy fjalë i temës (*dy mbiemra*)

• **Rreshti i tretë** përman tri fjalë që shprehin veprime të temës (*tri folje*)

• **Rreshti i katërt** është një fjali me katër fjalë që shprehin qëndrimin dhe ndjenjën për temën (*fjali*)

• **Rreshti i pestë** është një fjalë sinonime që ripërcakton thelbin e temës (*sinonim*).

Shembulli 1:

1	Pyjet e Amazonës
2	Të dendura, Të pakalueshme
3	Digjen, Priten, Gjenerohen
4	Janë "mushkëritë" më të mëdha të botës.
5	Selvas

Pesëvargëshi është një teknikë që përdoret zakonisht në fazën e reflektimit, meqë bën sintetizimin e informacionit të marrë. Gjen zbatim në çdo lëndë e në çdo klasë. Pesëvargëshi shërben shumë mirë si mjet për të bërë përmbledhjen e informacionit në tërësi; si një mënyrë e vlerësimit të gjykimit të nxënësve; si një mënyrë për shprehje krijuese.¹⁴

Tipet e orëve të mësimi në lëndën e gjeografisë

Orët e mësimi, pavarësisht nga tematikat e ndryshme, kanë të përbashkët:

- **Qëllimin arsimor**

- **Qëllimin edukativ**

Duke u nisur nga këto qëllime didaktike, orët e mësimi, sipas tipit, i klasifikojmë në:

A. Tipi i mësimi hyrës

B. Tipi i mësimi për studim material të ri mësimor

C. Tipi i mësimi për kontrollin e njohurive¹⁵

D. Tipi i mësimi përsëritës - përgjithësues

E. Tipi i mësimi të kombinuar

Disa kritere për

përzgjedhjen e tipit të mësimi

Për zgjedhjen e tipit të mësimi, mësuesi duhet të niset nga disa kritere:

1. Kriteri i parë për zgjedhjen e tipit të mësimi është qëllimi didaktik i orës së mësimi. Në qoftë se qëllimi kryesor do të jetë kontrolli i njohurive, atëherë do të përdoret tipi i mesmit për kontrollin e njohurive etj.

2. Për zgjedhjen e tipit të mësimi merret parasysh përmbajtja e materialit mësimor e nëse kjo ka karakteristika të veçanta e jep njohuri që nxënësit nuk i kanë marrë më parë, atëherë zgjidhet tipi i mësimi për dhënien e materialit të ri, ku vendin kryesor e zë shpjegimi.

3. Zgjedhja e tipit të mësimi ka të bëjë edhe me përgatitjen metodiko-shkencore të mësuesit. Në qoftë se mësuesit i mungon kjo përgatitje, ai mund të përdorë më lehtë tipin e mësimi të kombinuar, mjafton që t'u përmbahet sa më mirë parimeve të përgjithshme didaktike dhe kritereve për planifikimin e mësimi.¹⁶

4. Në zgjedhjen e tipit të mësimi merren parasysh interesat, dijet dhe aftësitë e nxënësve.

5. Në zgjedhjen e tipit të mësimi merret parasysh edhe mosha e nxënësve. Kjo bën të mundur sigurimin e vëmendjes dhe pjesëmarrje të nxënësve në mënyrë aktive në mësim.

Roli i mësuesit në vlerësim

Të gjitha vlerësimet bëhen nga mësuesi. Përpara mësuesit shtrohet pyetja: Kur vlerëson me gojë ose me shkrim një ose disa nxënës, ç'duhet të bëjnë të tjerët? Mund të dëgjojnë, dhe kjo përbën një përsëritje për ta; mund të kryejnë detyra të tjera individuale ose të punojnë me çifte a me grupe, duke bërë prova për kontroll. Roli i mësuesit në një kontroll të tillë tashmë ka ndryshuar. Vlerësimet e të gjitha llojeve bëhen në klasë si një pjesë normale e veprimtarisë mësimore. Të gjitha veprimtaritë e të mësuarit të sotëm përbëjnë forma vlerësimi në vetvete. Mësuesi të ketë parasysh nevojën e integritetit të vlerësimit me procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit.¹⁷ Mësuesi kur vlerëson rezultatet e punës së cdo nxënësi duhet të marrë parasysh dhe vecoritë individuale të tij (aftësitë, forcën e të menduarit dhe gjykuarit, shëndetin, kushtet e jetesës). Për cdo nxënës nota duhet të jetë e motivuar dhe e merituar. Motivimi i notës kërkon kujdes e takt nga ana e mësuesit.

PËRFUNDIME

- Metodika e gjeografisë ka si objekt studimi procesin e të mësuarit të temave të gjeografisë. Ajo jep format dhe metodat e mësimit dhe të edukimit që përdoren në lëndën e gjeografisë.
- Metodika e mësimit të gjeografisë tregon rrugët dhe format se si arrihet me sukses lidhja e përgjithshme gjatë procesit mësimor-edukativ, midis përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit mendor.
- Forma kryesore e organizimit të mësimit të gjeografisë në shkollë është ora e mësimit. Cilësia e orës së mësimit varet nga kombinimi i drejtë i mjeteve, metodave dhe shfrytëzimit në mënyrë maksimale të 45 minutave.
- Strategjitë e të mësuarit përfshijnë në vetvete tërësinë e metodave, teknikave dhe veprimtarive që do të përdoren për të arritur qëllimet dhe objektivat. Ato kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit dhe aktivizimit të nxënësve, të përpunimit të informacionit, për të ndërtuar dhënie e marrje materiali

mësimor në mënyrë të



kuptueshme e të logjikshme.

- Mësimdhënia është tërësia e atyre strategjive, procedurave, teknikave dhe mjeteve nëpërmjet të cilave do të arrihen synimet dhe objektivat mësimore ku elementi kyç i trekëndëshit pedagogjik është mësuesi.
- Mësuesi i gjeografisë duhet të zotërojë, njohuritë e lëndës, njohuritë pedagogjike dhe njohjen e programit.

SUGJERIME.

Duke patur parasysh se termi Metodologji e Mësimdhënies në gjeografi përkon me strategjitë e mësimdhënies, gjë që po anashkalohet si nga mësuesit e vjetër shtu edhe nga mësuesit e rinj është një arsye për të renditur këto sugjerime:

1. Nuk duhet që të bëhet mbivlerësimi i metodikës së gjeografisë, gjë që po ndodh tek mësuesit e vjetër, të cilët bazohen vetëm te njohuritë që ata disponojnë. Ata duhet që të punojnë për të përdorur teknikat dhe strategjitë bashkëkohore.
2. Nuk duhet që të ndodhë nënvlerësimi i materialit gjeografik, gjë që e bëjnë mësuesit e rinj, të cilët ndjekin mënyrën monotone të shpjegimit të mësimit, mjafton që të njohin lëndën, gjë që është e gabuar, çka bën që niveli i orës së mësimit të jetë shumë i ulët dhe nxënësit të përballen me mungesën e informacionit gjeografik.

Mendoj që mësuesit duhet ta njohin mirë lëndën e gjeografisë, normat bazë të saj dhe të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato sipas kushteve që u ofron shkolla ku ata mësojnë.

LITERATURA

1. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 30
2. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012 fq. 30-32
3. Fatlinda, Shkurti "Mësimdhënia e gjeografisë ne moshen e re shkollore", Triptik, Vlore 2009" fq. 43-48
4. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 36
5. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 37
6. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012- fq. 38
7. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012 - fq. 45
8. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 45
9. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, - fq. 47
10. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 48
11. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012- fq. 48
12. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 51
13. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 51
14. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 51-52
15. Trandafili, Genc "Libër Mësuesi", Gjeografia 8, Ideart, Tirane - 2012, fq. 88
16. Bardhyl, Musai, "Metodologjia e Mësimdhënies", B. Musai, Tirane 2003
17. F. Shkurti "Mësimdhënia e gjeografisë ne moshen e re shkollore", Triptik, Vlore 2009, fq.140-143